



## RAPORTI TEKNIK



### **OBJEKTI:**

### **PROJEKTI PER TRANSFORMIMIN E INFRASTRUKTURES AKOMODUESE NE KAMPUSIN RAJONAL TE ARSIMIT PROFESIONAL, BASHKIA ELBASAN**

POROSITES:

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

PROJEKTUES:

**BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k**

**2024**



## PERMBAJTJA

<b>1 INFORMACION I PERGJITHSHEM</b> .....	5
<b>1.1 Pershkrimi i per gjithshem</b> .....	5
<b>1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm</b> .....	6
<b>1.1.2 Objektiva Specifike</b> .....	7
<b>1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale</b> .....	8
<b>1.2.2 Strategjia e ndërhyrjes</b> .....	11
<b>1.2.3 Punimet civile</b> .....	11
<b>1.2.4 Gjendja Faktike</b> .....	12
<b>2 ARKITEKTURA</b> .....	14
<b>2.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	14
<b>2.2 Pershtatja</b> .....	14
<b>1.1 Organizimi funksional</b> .....	15
<b>2.3 Koncepti i design në fasadë dhe materialet</b> .....	17
<b>3 KONSTRUKSIONI</b> .....	20
<b>3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit</b> .....	20
<b>4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE</b> .....	21
<b>4.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	21
<b>4.2 Pershtatja</b> .....	21
<b>4.3 Rezerva ujore</b> .....	22
<b>4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitar</b> .....	22
<b>4.4.1 Grupi i presurizimit</b> .....	22
<b>4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar</b> .....	23
<b>4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitar</b> .....	23
<b>4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitar</b> .....	23
<b>4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijshem</b> .....	25



4.5	Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura .....	25
4.5.1	Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare .....	26
4.5.2	Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit .....	26
4.5.3	Kalimet horizontale, pusetat primare .....	26
4.5.4	Rrjeti i jashtëm i shkarkimit .....	27
4.5.5	Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujerave te ndotura .....	27
4.5.6	Tubacionet e shkarkimit te ujrate te ndotura .....	28
4.5.7	Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrate te ndotura .....	29
4.5.8	Tubat e ajrimit .....	29
4.6	Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut .....	30
4.6.1	Rrjeti i kullimit të ujrate te tarracave .....	30
4.6.2	Kolonat e shkarkimit të ujrate të shiut .....	31
4.6.3	Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrate sipërfaqësor .....	31
4.6.4	Sistemimi i ujrate te shiut .....	31
5	ELEKTRIKET .....	33
5.1	Gjendja Ekzistuese .....	33
5.2	Pershtatja .....	33
5.3	Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjisë dhe shfrytezimit: .....	34
5.4	Furnizimi me energji elektrike .....	35
5.5	Sistemi i shperndarjes .....	35
5.6	Fuqia .....	35
5.7	Ndricimi .....	36
5.8	Sistemi detektimit te zjarrit .....	37
5.9	Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit .....	38
5.10	Normat Ligjet dhe rregullat .....	39
6	KONDICIONIMI DHE VENTILIMI I AMBIENTIT .....	40
6.1	Gjendja Ekzistuese .....	40



6.2	Pershtatja e Ambjentit.....	40
6.3	Të Përgjithshme.....	40
6.4	Rregullat dhe normat e projektimit .....	40
6.5	Kriteret e Projektimit.....	41
6.6	Perllogaritjet e Sistemit.....	42
6.7	Perzgjedhja e sistemit dhe funksionimi i tij.....	44
7	<b>MBROJTJA KUNDER ZJARRIT .....</b>	52
7.1	Gjendja Aktuale .....	53
7.2	Pershtatja e Ambienteve .....	53
7.3	Kritere të përgjithshme projektuese.....	54
7.4	Klasifikimi i klasave të zjarrit .....	54
7.5	Sistemi i shuarjes me ujë – me hidrantë .....	55
7.6	Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative .....	55
7.7	Rezerva ujore.....	56
7.8	Grupi i presurizimit.....	56
7.9	Rrjeti shpërndarës .....	57
7.10	Hidrantët .....	57
7.11	Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot .....	58
7.12	Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave .....	59
7.13	Sinjalistika.....	59
8	<b>SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45 .....</b>	60
8.1	Gjendja Aktuale .....	60
8.2	Pershtatja e Ambjentit.....	60
8.3	Sistemi TV .....	60
8.4	Sistemi CCTV.....	60



## 1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

**Emertimi i Projektit:** "Projekti per Transformimin e Infrastruktures Akomoduese ne Kampusin Rajonal te Arsimit Profesional, Bashkia Elbasan".

**Vendodhja:** Rruga "11 Nentori", Elbasan

### 1.1 Pershkrimi i pergjithshem

Konviki i Shkollës së mesme së Bashkuar "Luigj Gurakuqi", Elbasan ndodhet në brendësi të qytetit midis Bashkisë Elbasan dhe Stadiumit përgjatë aksit "11 Nëntori" prej të cilit dhe aksesohet. Në afërsi të konviktit ndodhet ish-Shkolla e mesme pedagogjike, e cila tani mban në strukturën e saj të gjithë gjimnazet e profilizuara elektrike, mekanike etj. Rrjedhimisht dhe konviki u shërben nxënësve të të gjitha këtyre shkollave.





### 1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objekt i detyres sone te projektimit eshte projekti teknik per rikonstrukcionin e kesaj godine trekatëshe nepermjet vleresimit Tekniko- Ekonomik te objektit dhe evidentimin e nderhyrjeve te nevojshme per krijimin e ambjenteve me standarte bashkekohore akomoduese. Sipas planit te rikonstruksionit te godines, me financim nga buxheti i shtetit, eshte parashikuar nje rikonstruksion i ambienteve duke e kthyer ne ambjente te pershtatshme me nje funksionim normal dhe dinjitoz dhe me standardet me te mira nderkombetare per kete tip godine.

Shërbimet që përfshin ky projekt janë:

- Riorganizimi funksional i godinës ekzistuese me qëllim optimizimin e shfrytëzimit të hapësirave të brendshme
- Përmirësimi i infrastrukturës Akomoduese ne Kampisin Rajonal te Arsimit Profesional
- Rikonstruksion dhe rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen

Përzgjedhja e projekteve dhe e impianteve mekanike eshte bazuar në aplikimin dhe projektimin e sistemeve përkatëse me një efikasitet maksimal për të realizuar zgjidhje bashkohore teknike mbi bazë të normave dhe kushteve teknike europiane, me vlera minimale të kostove të investimit mbi bazë të fondeve në dispozicion, si dhe në respekt të kërkesave te parashtruara te termave te referencës ne detyrën e projektimit.



Në vijim, në mënyrë të përbledhur përshkruajmë kriteret të cilat janë marrë parasysh gjatë projekt idese si referencë esenciale për kualifikimin e zgjidhjeve impiantistike mekanike:

- Respektim i normave teknike
- Komfort sherbimi,
- Besueshmëri funksionale,
- Inspektueshmëri,
- Higjenë dhe siguri,
- Parcializim përdorimi,
- Kosto te ulet energjistik perdonimi,
- Kosto të ulët të investimit fillestar,
- Kosto të ulët të mirëmbajtjes,
- Standartizim të komponentëve impiantistikë,
- Respektim maksimal të kushteve ekologjike dhe mjedisore.

Në përgjithësi mund të themi që projektet mekanike janë mbështetur konform normave respektive europiane.

Ne hartimin e projekteve te impianteve mekanike, jemi mbështetur gjithashtu ne baze te Kategorizimit te këtij objekti, mbi baze te Strukturës te parashikuara ne Detyrën e Projektimit, mbi baze te Konstatimeve dhe vlerësimeve te gjendjes egzistuese te impianteve Mekanike dhe mbi baze te Propozimeve te zgjidhjeve Arkitektonike dhe Konstruktive.

### **1.1.2 Objektiva Specifike**

Objktivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi dhe rinovimi i godinës ekzistuese të konviktit Elbasan.

Me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e kushteve akomoduese, struktura ekzistuese do t'i nënshtrohet:

- rikonstruksionit total

Sa më sipër, do të bëhet studimi dhe vlerësimi i ndërtesës ekzistuese si dhe hartimi i projekteve arkitektonike dhe inxhinierike; përllogaritja e kostove; raportet teknike.



### 1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale

Me poshte po japim disa foto te gjendjes aktuale te cilat jane realizuar gjate verifikimeve ne objekt.







**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





### 1.2.2 Strategjia e ndërhyrjes

Bazuar në Detyrën e Projektimit ku sqarohen në vija të përgjithshme nevojat e konviktit, si dhe referuar Standardeve të Projektit të objekteve akomoduese, është hartuar një projekt i cili përbledh në vetvete gjithë elementët e nevojshëm që bëjnë të mundur përdorimin dhe menaxhimin sa më eficient të objektit.

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivave, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tèresor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinnovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin i kushteve akomoduese

### 1.2.3 Punimet civile

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tèresor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardë e projektimit dhe ndërtimit të janë konform standardeve bashkëkohore.



Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines nuk do te ndryshojne fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines, por thjesht një rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambienteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion i thellë i tarracës
- Përmirësimi i sistemimeve të jashtme
- System i ri elektrik, mekanik, hidraulik, etj

#### **1.2.4 Gjendja Faktike**

Gjendja e pergjithshme e objektit, shfaqet e amortizuar ne kohe. Vihet re presenza e vazhdueshme e lageshtise, mungon totalisht instalimet e sistemit MKZ, Instalimet e sistemeve te ngrohjes me kaldaje paraqiten te amortizuara dhe te vjeteruara me kohen po ashtu edhe instalimet elektrike dhe hidraulike etj.

#### **Ndërhyrje.**

Pas studimit që i është bërë detyrës së projektimit, kemi konkluduar se hapat kryesore që nevojiten të ndërmerren për ndërhyrje, në aspektin e përmirësimit dhe shfrytezimit të hapësirave janë:

- 1. Te permiresohen ndjeshem kushtet e sherbimit ne ambientet e Godines akomoduese;**
- 2. Te rinovohen te gjitha sistemet teknike te godines si Instalimet Elektrike, Instalimet Hidraulike, HVAC, MNZ, etj sipas standardeve europiane per ta**



kthyer ne nje objekt bashkekohor dhe te denje per funksionin qe ka;

3. Te gjitha funksionet qe kryhen ne kete godine do te mbulohen perseri ne te njejten gjurme;
4. Ndërhyrje në sistemimet e jashtme të objektit, etj



## 2 ARKITEKTURA

### 2.1 Gjendja Ekzistuese

Konviki i Shkollës së mesme së Bashkuar "Luigj Gurakuqi", Elbasan aktualisht ambientet shfrytezohen pjesërisht si konvikt për djemtë (majtas objektit) dhe pjesërisht si zyra provizore në funksion të Bashkisë dhe disa Njësive Administrative (djathtas objektit). Ai ka formë të rregullt drejtkëndëshe me sipërfaqe totale gjurmë prej rreth 1220 m<sup>2</sup>.

**Rifiniturat** Rifiniturat e brendshme dhe të jashtmë të godinës shfaqen në nivel të lartë amortizimi të ardhura këto jo vetëm për shkak të amortizimit fizik natyror që pësojnë strukturat dhe materialet por dhe për shkak të projektimeve të meparshme në nivele jo-optimale si në nivel projektues ashtu dhe zbatues në përdorimin e materialeve dhe instalimeve teknike dhe detajeve konstruktive. Sa më sipër, bazuar në inspektimin në vend problemet me evidente janë:

- Kushte jo të mira të mbështjellës së ndërtesës (fasadës). Përvec amortizimit evident ajo shfaq dhe nivel te lartë lagështie.
- Mungesë izolimi termik si në muret perimetral të cilat janë mure tulle që nuk janë pajisur me shtresa termike, ashtu dhe në vetrata të cilat nuk kanë veti termike dhe krijujnë që humbjet e energjisë te janë të larta.
- Gjithashtu përreth godinës terreni është i pasistemuar dhe nuk kanë një funksion të mirëfilltë me qëllim shfrytezimin e tyre si hapësira recreative.
- Shtrimet e dyshemeve janë bërë me pllaka gres porcelanat te cilat janë amortizuar me kalimin e kohes.
- Instalimet hidraulike, elektrike, mekanike paraqiten të amortizuara.
- Amortizim i suvasë në zona të caktuara; amortizimi I dyerje, dritareve etj.

### 2.2 Pershtatja

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivëve, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tërësor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e ambjenteve akomoduese

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tërësor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardë e projektimit dhe ndërtimit të janë konform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines



nuk do te ndryshojne fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines, por thjesht një rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambjenteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion i thellë i tarracës
- Përmirësimi i sistemimeve të jashtme
- System I ri elektrik, mekanik, hidraulik, HVAC etj


### 1.1 Organizimi funksional

Zgjidhja e organizimit funksional bazohet në Detyrën e Projektimit të përcaktuar si dhe në Standarde të ndryshme të projektimit. Është bërë një studim i gjërë i tyre me qëllim arritjen e plotësimit të nevojave si për nxenesit dhe stafin.


Me qëllim arritjen e objektivit për një funksionalitet të mirë si në ndarjet e hapësirave ashtu dhe në lidhjet mes tyre, ndërhyrja bazohet në elementin kryesore qe eshte ndërhyja minimale në muraturën ekzistuese dhe riorganizim i hapësirave.



Kati përdhe – Planimetria e propozuar




Kati I Pare – Planimetria e propozuar





Kati I DYTE – Planimetria e propozuar



### 2.3 Koncepti i design në fasadë dhe materialet

Në lidhje me konceptin e fasadës është propozuar një riprojektim i tyre duke ruajtur ritmin e dritareve ekzistuese, por duke ndryshuar raportin në lartësi të secilit kat. I gjithë perimetri i fasadave do të vishet me system kapotë me qëllim termoizolimin dhe rritjen e eficiencës së energjisë. Edhe dritaret dhe vetrata do të jenë prej duroalumini me veti të larta termike.


Ngjyrat e fasadave i propozojmë në tonalitetet të ndryshme të se verdhes.

Lidhur me materialet që do të përdoren, muret perimetrale do të jenë të sistemit 'kapot'. Mbulimi i objektit do të jete me soletë dhe shtresat përkatëse.



**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





### 3 KONSTRUKSIONI

#### 3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit

Objektit në fjalë përfshin një godinë civile ku tre kat mbi toke, në elementet strukturorë të së cilës nuk do të ketë ndërhyrje.

Struktura e objektit eshte e nderthurur me konstruksion b/a te tipit tra - kollon dhe mure mbajtes.

Themeli i strukturës është themel i vazhduar dhe plinta b/a.

Taraca e kësaj strukture është e pa shfrytëzueshme.

Ne te gjitha nderhyrjet (prishje dhe ndertim muresh, etj) qe parashikohen te behen ne kete objekt jane marre parasysh te gjitha kerkesat e kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit ne fuqi.

Pas verifikimit vizual, ne objekt nuk verehen demtime te struktures mbajtese te tij dhe per kete arsye nuk eshte pare e nevojshme te nderhyet apo te paraqiten plane/detaje te nderhyrjes.

Gjithsesi, gjate fazes se pergatitjes se projektit te zbatimit te objektit te behen investigime me te thelluara te struktures mbajtese te tij ne menyre qe te kihet nje panorama me e qarte ne lidhje me nevojen per marrjen e masave perfocuese te saj.



## 4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE

### 4.1 Gjendja Ekzistuese

Gjendja aktuale e sistemit te ujesellesit dhe te kanalizimeve paraqitet mjaft i amortizuar. Sipas verifikimit ne terren te gjendjes aktuale eshte vene re dukshem demtimi i tualeteve ne dysheme, amortizim i sistemit te furnizimit me uje dhe te shkarkimit te ujerave te ndotura duke ulur ne kete menyre per funksionalitetin e tyre.

Gjithashtu ka demtime te konsiderueshme ne rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujrale te shiut. Vlen per tu theksuar demtimi i ulluqeve i cili ka sjelle edhe demtimin e fasades nga depertimi i lageshtires ne periudhe dimri.

### 4.2 Pershtatja

Ne projektimin e rrjetit te ujesellesit dhe te kanalizimeve eshte marre ne konsiderate rrjeti ekzistues i godines. Projekti hidroteknik i eshte permbajtur kerkesave te autoritetit. Pas vizitave te vazhdueshme ne objekt nga ana e projektuesve jane pare opsione te ndryshme zgjidhjesh dhe me pas eshte arritur ne nje zgjidhje perfundimtare te sistemit hidroteknik.

Do te nderhyet ne rrjetin e ujesellesit dhe ate te shkarkimit te ujrale te ndotura ku eshte menduar te ndertohet me materiale bashkekohore dhe ne perputhje me standartet ne fuqi. Rikonstuksioni do te perfshi instalimet hidroteknike (sistemin e furnizimit me uje dhe shkarkimin e ujerave te ndotura) brenda godines. Per rrjetin e jashtem te kanalizimeve ne projekt do te perfshihet pjesa nga dalja e kolones kryesore te shkarkimeve deri te bashkimi te puseta me e afert. Lidhur me pusetat do te behet rikonstruksion I shkarkimeve dhe mbulimi i pusetave do te behet me kapake prej gize te gatshem.

Materialet qe do perdoren per rrjetin e ujesellesit jane perzgjedhur per te perballuar prurjet dhe presionet llogaritese.

Cdo pajisje do te kompletohet me rubineta filter ne hyrje te ujit ngrohte dhe atij te ftohte. Tubat e furnizimit me uje do te jene PP-R per presion 16Atm dhe PEX-AL. Ndersa tubat e shkarkimeve do te projektohen me material te cilesise se pare dhe me gomine ne zgjatim, po keshtu me gomine dhe te gjitha rakorderite. Eshte percaktuar pika e shkarkimit te ujerave te perdorura jashtë objektit dhe lidhjen me rrjetin ekzistues K.U.Z.

Impianti i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë dhe nevojat për ujë teknik për pajisjet mekanike të impianteve të ndryshme. Nevojat e përgjithshme për ujë pavarësisht përdorimit dhe përpunimit të tij, sigurohen nga centrali teknik i cili përbahet nga rezerva e ujit dhe nga impiantet përkatëse



të pompimit dhe të shpërndarjes. Përvec kësaj në rezervën e ujit për përdorim sanitari sigurohet edhe rezerva e ujit për nevojat e impiantit të mbrojtjes nga zjarri.

#### **4.3 Rezerva ujore**

**Furnizimi me ujë për nevojat hidrosanitare** parashikon nevojat e ujit të ftohtë dhe nevojat për ujë te ngrohtë. Rezerva e përgjithshme e ujit për nevojat hidrosanitare, sipas normave parashikohet te sigurohen per nevoja te konsumit 24 ore, pavaresisht furnizimit te vazhdueshëm me uje nga rrjeti i qytetit .

**Furnizimi me ujë për nevoja teknike** parashikon nevojat për furnizimin e të gjithë paisjeve sanitare me uje te ngrohte, gjithashtu për nevojat e impiantit të ngrohje/ftohje te kondicionimit.

**Në total rezerva e kërkuar e ujit për të tre përdorimet** e mësipërme është rezerva ujore per përdorim sanitari per 24 orë.

#### **4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitari**

**Sistemi i furnizimit me ujë hidrosanitar** përbëhet nga :

- a) grapi i presurizimit
- b) rrjeti i shpërndarjes

##### **4.4.1 Grupi i presurizimit**

**Grupi** është i përbërë nga pompat kryesore elektrike e ushqyer si nga rrjeti normal elektrik dhe nga rrjeti i emergjencës dhe aksesorët impiantistike përkatës, për të garantuar prurjen dhe presionin e rrjetit të konsumatorëve. Pompat janë të kontrolluara nga një kuadër elektrik te pavarur, me lexim të lehtë të instrumentave të sinjalizimit. Pompat janë pajisur më kolektorët e thithjes dhe dërgimit, që janë të galvanizuar me veshje shtrese epoxidi. Ato kanë në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvola ndërprerëse, valvol moskthimi, si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollolli, si presostatët e presionit etj. Grupi i presurizimit është konform normave të standartizuara europiane.



#### 4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar

Rrjeti i shpërndarjes është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i presurizimit deri në konsumatorë nëpërmjet një rrjeti të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit në dhomen teknike, nëpërmjet kalimit te tyre gjate koridorit dhe furnizon kollonat kryesore të shpërndarje në godinë, nga të cilat dalin degëzimet magjistrale për çdo kat. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi për një sektorë të caktuar të pajisura me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjera. Sistemi i tubave të ujit sanitari plotëson të gjitha kërkesat e normave dhe standardeve të përcaktuara, në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Furnizimi ne cdo tualet eshte parashikuar te behet me sistem shpërndarje me kolektorë. Kështu nepermjet këtij sistemi sigurojmë funksion me te mire te furnizimit me uje te paisjeve sanitare, si dhe lehtësi dhe shpejtësi ne riparimin e defekteve /ose mirëmbajtjen e tyre.

#### 4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitar

Sistemi i ujit te ngrohte do te behet me bolier 15 liter dhe 80 liter dhe perbehet nga prodhuesi i energjise termike, tubat e shperndarjes dhe pajisjet perkatese te dhenies se energjise termike.

Me kerkese te supervizorit mund te perdoren tuba PPR dhe PEX-AL qe jane konform standartave te mesiperme per cilesine dhe testimin e tyre per presionin dhe rezistencen ndaj temperaturave te larta.

Tubat per furnizimin me uje te ngrohte duhet te sigurojne rezistence termike ndaj temperaturave te larta, deri ne 100 grade celsius, korrozionit, agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

#### 4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitar

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit te ftohte/ngrohte sanitare ne objekt eshte realizuar duke marre ne konsiderate skemen e shperndarjes, prurjen nominale per çdo aparat hidrosanitar, prurjen totale nominale, njekohshmerine e perdorimit te pajisjeve hidrosanitare, presionin e punës, humbjet gjatesore dhe lokale te presionit si dhe shpejtesine maksimale te rekomanduar te qarkullimit te ujit.



Vete nevojat per uje sanitar jane llogaritur bazuar ne normen europiane EN-806-3 e cila merr ne konsiderate prurjen totale maksimale te kerkuar (Qta dhe Qtb) bazuar ne numrin e aparateve hidrosanitare dhe prurjen nominale per çdo aparat hidro/sanitar. Per aparatet ne te cilen parashikohet uji i ngrohte dhe i ftohte eshte konsideruar prurja e nevojshme e nje fluksi te vetem.

Prurja e projektit Gpr bazuar ne normen EN 806-3 eshte llogaritur e diferencuar bazuar ne tipologjine e objektit dhe pikerisht:

Gta (l/sec)	1.1	1.5	2	2.6	3.2	3.6	4.1	4.5	5.1	6.1	7.2	8.1	9	10.1	11.2	12.2	15.2
Gpr	0.5	0.7	0.8	0.9	1	1.1	1.2	1.2	1.3	1.4	1.5	1.6	1.7	1.8	1.9	2	2.2

Tubat qe do te perdoren per furnizimin me uje te ftohte do te jene PPR, PN 16bar dhe PEX-AL .

Diametrat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te pijshem dhe shpejtesise se levizjes. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret ne intervalt 0,8-1,4 m/sek. Gjatesia e tubave eshte 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem te tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj, duhet te jepen te stampuara ne çdo tub. Tubat e furnizimit me uje duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe kerkojne uje te pijshem. Ato instalohen brenda ne mur. Ne rast se gjatesia e shtrirjes se tyre eshte e madhe duhet te vendosen kompesatore te tipit me brryl te thjeshte ose tip omega. Bazuar ne prurjen e projektit, diametri i linjave te furnizimit me uje eshte llogaritur mbi bazen e formules:  $Qpr = 0,785 \times D^2 \times V$

ku  $V$  = eshte shpejtesia e lejuar e levizjes se ujit ne tubacione.

Kjo shpejtesi, per tubacionet e furnizimit me uje sanitari eshte pranuar:

Diametri tubacionit	DN 25	DN32	DN50	DN63
Shpejtesia max (m/sec)	1,1	1,3	1,9	2,1



#### 4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijsphem

Per sistemin e furnizimit me uje te ndertesës, meqenëse do të perdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderite perkatese duhet të jene PPR të cilat plotesojnë kërkesat e cilesise sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilesine dhe testimin). Rakorderite që perdoren në këto linja janë:

- Brrylat te thjeshte me 45 grade dhe 90 grade
- Brryla me fileto metalike te tipit femer dhe mashkull;
- Tridegeshat te thjeshte dhe me fileto;
- Katerdegesha (Kryqe)
- Bashkues te thjeshte
- Bashkues me fileto metalike tip femer dhe tip mashkull;
- Reduksionet e ndryshme;
- Rakorderi tip hollandez; etj

Rakorderite që do të perdoren për furnizimin me uje duhet të sigurojnë rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence të larte ndaj agjenteve kimike, peshe të lehte, mundesi të thjeshta riparimi e transporti, ngjiturje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

Diametri dhe spesori duhet t'i pershtaten tubave perkatese dhe të jene sipas te dhenave dhe kushteve teknike. Spesori i rakorderive duhet të jetë i tillë që të perballojë 1,5 here te presionit te punës se tubave.

#### 4.5 Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura

**Implanti i shkarkimit të ujërave të zeza** shërben përmblledhjen e shkarkimeve të godines. Ky rrjet është një rrjet i veçantë nga rrjetet e tjera të shkarkimeve si rrjeti i shkarkimeve te ujrave te shiut dhe te impiantit te kondicionimit.

Implanti i shkarkimit të ujërave të zeza do të jetë i përbërë nga :

- a) rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të ambienteve sanitare,
- b) kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit,
- c) kalimet horizontale, pusetat primare me pompat e ngritjes,
- d) rrjeti i jashtëm i ujrave të zeza



#### 4.5.1 Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare

**Rrjeti i brendshëm** i shkarkimit të nyjeve sanitare është i përbërë nga tubacione plastik horizontale të cilat mbledhin të gjitha shkarkimet e pajisjeve për tu shkarkuar ne kolonën vertikale të shkarkimit. Diametri dhe gjatësia e tubave është e tillë që të sigurojnë rrjedhjen normale të ujrave të zeza në kolonat e shkarkimit.

Për shkarkimet e ujërave të zeza janë përdorur tuba dhe rakorderi sipas normave dhe standardeve. Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave mekanike dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### 4.5.2 Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit

**Kolonat vertikale** të shkarkimit dhe balancimit gjithashtu shërbejnë për mbledhjen e shkarkimeve të nyjeve sanitare. Ato shoqërohen së bashku me kolonat e balancimit të cilat bëjnë të mundur balancimi e ajrit gjatë shkarkimit të ujrave në kolonat kryesore. Kolonat e shkarkimit kanë dalje në pjesën e sipërme të tyre në tarracë dhe/ose ne fasadat e godinës, ndërsa në fundin e tyre ato bashkohen në kolektorët deri në derdhjen në pusetat primare te rrjetit te jashtem.

Si kolonat e shkarkimit ashtu edhe magjistralet në të cilën janë parashikuar diametrat e tubacioneve dhe pjerrësitë e tyre rigorozisht sipas normave të projektimit. Lidhja e tyre bëhet me anë të bragave  $45^\circ$  në mënyre që shkarkimi të bëhet sa më i lehtësuar duke lejuar qarkullimin e ajrit nëpër tubin e shkarkimit të nyjës sanitare gjë e cila mund të minimizojë qarkullimin e ajrit dhe të rrisë nivelin e zhurmave gjate shkarkimit. Këto kolona të brendshme janë të gjitha të lidhura me kollonen për shfryrjen dhe ballancimin e presioneve të gjithe rrjetit, pasi mblidhen, dalin jashtë godinës arrijnë në rrjetin e pusetave.

Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### 4.5.3 Kalimet horizontale, pusetat primare.

**Kolektorët dhe kalimet horizontal** shkarkojnë në pusetat primare të rrjetit e jashtëm.



Meqenëse shkarkimet e godinës deri në katin nëntokë rezultojnë në kuotën e rrjetit të jashtëm të ujrave të zeza nuk është e nevojshme që të përdoren pusetat. Shkarkimet e tyre behen me gravitet me rrjedhje te lire.

**Pusetat primare** mbledhin ujrat ne rrjetin pranë godinave dhe me pas rrjeti i tyre lidhet dhe shkarkon ne rrjetin urban te zonës ose te qytetit.

#### 4.5.4 Rrjeti i jashtëm i shkarkimit

**Rrjeti i jashtëm** i grumbullimit te ujërave të zeza eshte parashikuar i përbërë nga pusetat primare të tipit mbledhëse me konstruksion betoni të papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize me permasë Ø60 si dhe tubacionet të dimensionuara sipas normave teknike të projektimit. Pusetat e ujërave të zeza janë në forme katrore me thellësi jo më pak se 90 cm. Përmasat janë duke filluar nga 60x60 cm dhe dimensionohen ne baze te kërkesave te projektit. Tubacionet e rrjetit të jashtëm të shkarkimeve rrjeti i jashtëm i shkarkimeve janë tuba polietilen i rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të zeza të vendosura në çdo pikë ndërprerjeje ose kontrolli të rrjetit të jashtëm të shkarkimit. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### 4.5.5 Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura

Sistemi i shkarkimeve te ujrave te ndotura behet me gravitet. Sistemi eshte dimensionuar ne menyre te tille qe ujrat e shkarkuara te mos okupojne te gjithe seksionin e tubacioneve te shkarkimit. Sasia e ujrave te shkarkuara (ne njesi shkarkimi US) eshte llogaritur duke konsideruar aparatet hidrosanitare te kategorise 3. Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve te sistemit te shkarkimit te ujrave te ndotura eshte bere duke marre ne konsiderate:

- skemen e shperndarjes dhe shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S;
- fluksion nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- shpejtesise se qarkullimit dhe pjerresise se tyre etj.

Per shkarkimet e ujrave do te perdoren tuba plastike PP3 qe plotesojne te gjitha kërkesat e cilesise sipas standardit ISO 4427 dhe prEN 12201. Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj ajenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitur te thjeshte dhe te shpejte. Permasat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, shpejtesise se levizjes dhe shkalles



se mbushjes se tyre. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes duhet te jete 0,5 - 0,8 e seksionit te tubit.

Per objektin tone per kanalizimin e ujerave te brendshme do te perdoren tubat PP3 me diametra DN50, DN75, DN110 dhe DN125.

Tubacionet e shkarkimit te ujerave te ndotura qe do te dalin nga godina do te perdoren te tipit HDPE i brinjezuar SN4 DN 125. Dalja e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura nga godina do te behet duke u lidhur me puseten me te afert.

#### **4.5.6 Tubacionet e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per shkarkimin te ujrave te ndotura jane perdorur tuba prej PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normativa UNI 7613.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Diametri i tubave eshte percaktuar ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosura.

Kollonat vertikale te shkarkimit do te pajiset me pika kontrolli. Instaluesi duhet te vendose nje numer te xhuntove ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit te tubacioneve.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyje qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh me ane te tubave te dergimit. Tubat e dergimit do te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Per te pakesuar numrin e kollonave duhet qe pajisjet sanitare te grupohen dhe te vendosen njeri mbi tjetrin nga katër ne nderkat te nderteses. Diametri i kollonave te shkarkimit merret i njejte per te gjithe lartesine e nderteses dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Nuk lejohet perdorimi i tubave te shkarkimit me diameter me te vogel se 50 mm. Bashkimet e tubave te shkarkimit duhet te behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Provat hidraulike behen me presion prove 25% me te larte se presioni i punes. Ato behen per te pare qendrueshmerine e rrjetit, si dhe rrjedhjet e mundshme qe mund te ndodhin ne tabacione.



#### **4.5.7 Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do te perdoren rakorderite perkatese me material PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normatives UNI 8452.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura që lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

Provati e shkarkimit do te realizohen ne perputhje me normen UNI 7615.

Permasat (diametri) e tyre do te jene ne funksion te sasisë llogaritese te ujit te ndotur, llojti te pajisjeve sanitare, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrave te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0,5-0,8 e sekzionit te tubit. Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dheneve. Te dhena mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi. Rakorderite e bashkimit te tubave duhet te montohen ne te gjithe vendet ku behet bashkimi me tubat e dergimit te ujrave te ndotura. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit, duhet te behet me tridegeshe te pjerreta ose brryla te thjeshte nen nje kend 45 ose 60 grade. Rakorderite e bashkimit duhet te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur. Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre. Bashkimet e rakorderive me tubat e shkarkimit, behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

#### **4.5.8 Tubat e ajrimit**

Tubat e ajrimit jane zgjatim ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit dhe duhet te nxirren 70 - 100 cm me lart se pjesa e siperme e çatise ose tarraces se nderteses. Ato duhet te sherbejne per ajrimin e rrjetit te brendshem dhe te jashtem te kanalizimeve. Ky ajrim eshte i domosdoshem sepse me ane te tij behet e mundur largimi i gazrave te krijuara ne kollonat e shkarkimit si dhe i avujve te ndryshem qe jane te demshem per jeten e banoreve.



Gjithashtu, Tubat e ajrimit do te sherbejne per te bashkuar kollonat e kanalizimeve me atmosferen per te menjanuar nderprerjen e punes se sifoneve ne pajisjet hidrosanitare. Tubat e ajrimit duhet te kene diametrin e brendshem njelloj me diamterin e kollones se shkarkimit. Diametri i tubit te ajrimit duhet te jete DN110 mm. Materialet qe perdoren per keto tuba duhet te jene rezistent ndaj korrozionit, agjenteve atmosferike, gazrave te ndryshem qe dalin nga kollonat e shkarkimit. Ne maje te tubave te ajrimit duhet te vendoset nje kapuç, i cili pengon hyrjen ne tub te ujrade te shiut dhe debores si dhe permireson ajrimin e kollones se shkarkimit. Nje grup aparatesh mund te kene dy tuba ajrimi. Tubat e ajrimit duhet te montohen me kujdes ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit ne menyre qe te mos shkeputen ose te demtohen nga ererat e forta qe mund te fryjne. Ato montohen ne pozicion vertikal. Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

#### **4.6 Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut**

**Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut** është ndërtuar i veçante nga rrjetet e tjera të shkarkimeve dhe shërbën për të mbledhur ujrat sipërfaqesor të shiut nga tarracat si dhe nga ujrat sipërfaqësor të sheshit.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të shiut do të përbëhet nga :

- a) rrjeti i kullimit të tarracave.
- b) kolonat vertikale të shiut (kolektorët e shkarkimit të shiut)
- c) rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrade sipërfaqësor .

##### **4.6.1 Rrjeti i kullimit të ujrade te tarracave**

Rrjeti i kullimit te ujërave të tarracës eshte parashikuar me pileta shiu, kollonat si dhe kolektorët që mbledhin ujrat e shiut nga tarracat dhe shkarkojnë drejt rrjetit të jashtëm të ujrade të shiut. Për shkak të konfigurimit të godinës në relacion me kuotën 0.00 të sheshit dhe rrjetit egzistues të jashtëm të mbledhjes së ujrade të shiut rezulton që të gjitha kollonat e godinës mbasi zbresin poshtë dyshemesë së katit përdhe mund të shkarkojnë lirshëm në rrjetin e jashtëm.



Te gjitha kollonat e shkarkimit plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas normave të projektimit, duke filluar nga piletat, kolonat, deri tek kalimet horizontale dhe kolektorët që përfundojnë në rrjetet respektive.

#### **4.6.2 Kolonat e shkarkimit të ujrave të shiut**

**Kolonat vertikale e shkarkimit të ujërave të shiut** shërbejnë për të shkarkuar ujin e shiut nga piletat ose ullukët deri në nivelin e kolektorëve të ujërave të shiut ose deri në rrjetin e jashtëm të shkarkimeve të ujërave të shiut. Dimensioni i tyre është bërë duke marrë parasysh kapacitetin e ujit në rastin e periudhave të shirave. Gjatë projektimit, janë marrë parasysh kushtet hidro-metrologjike dhe sasitë e reshjeve, në zonën ne studim. Mbi bazë të këtyre të dhënave, çdo kollonë mbledh ujrat e jo më shumë se 150 m<sup>2</sup> sipërfaqe tarrace dhe secila prej kollonave është parashikuar me diametër jo me të vogel se 110 mm. Kollonat janë parashikuar të ndërtohen me material metalike , me të gjitha lidhjet me bashkim nëpërmjet të cilave sigurohet funksionim normal i shkarkimeve, mosrrjedhje të ujrave, qëndrueshmëri në kohë të tyre, janë rezistent ndaj korrozionit, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, minimizimin e zhurmave gjatë shkarkimit si dhe eleminimin e kondensave sidomos në përiudhën e dimrit, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### **4.6.3 Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrave sipërfaqësor**

Rrjeti i jashtëm i shkarkimit të ujërave të shiut pasi mbledh të gjithë shkarkimet nga kolektorët e shkarkimit të ujërave të shiut shkarkon në rrjetin e qytetit. Për grumbullimin e ujërave të shiut janë parashikuar puseta të tipit mbledhëse me konstruksion betoni te papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize grile me përmasa 60x40 cm. Të çarat me kapakun prej grile janë nga 25 deri 35 mm për te ndaluar plehrat si dhe për te mundësuar kullimin e ujërave. Pusetat e ujërave të shiut janë në forme katrore me thellësi jo me pak se 90-100 cm me përmasa 40x40 cm. Tubacionet e rrjetit të jashtëm janë tuba polietilen të rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të shiut. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### **4.6.4 Sistemimi i ujerave te shiut**

Largimi i ujerave atmosferike (d.m.th. i ujerave te shiut e te debores se shkrire) eshte menduar te kryhet me ane te nje sistemi ujerash ne drejtim te kasetave te shkarkimit te



ujerave te shiut. Ne teresi sistemi i largimit te ujerave atmosferike perbehet nga: ulluqe qe mbledhin ujerat ne tarrace, prej hinkave ujembledhese, kolonave te shkarkimit dhe pusetave te kontrollit.

Ulluqet duhet te sigurojne largimin e plote e te shpejte te ujerave te shiut e te debores si dhe reren, pluhurin qe mund te bien mbi tarrace.

Lidhja e hinkave me muret e fasades duhet te behet e tille qe te mos lejoje ne asnje menyre lagien e mureve te objektit. Uji eshte menduar te mblidhet ne ulluk dhe nepermjet hinkave te lidhet me kolonat e shkarkimit. Nje hinke mund te mbledhe ujerat nga nje siperfaqe prej 250-350 m<sup>2</sup>.

Referuar kushteve te projektimit rezulton se per objektin, hinkat dhe kolonat e shkarkimit (kolonat vertikale) do te vendosen ne skajet e objektit dhe ne qender si dhe ne drejtimin gjatesor te tij.

Ne kete menyre behet nje largim i shpejte dhe i panderprere te ujerave te ulluqeve e te kunetave te mbuleses se objektit si dhe per te mbajtur papastertite e ndryshme qe mund te bllokojne tubat. Tubat duhet te kene diameter jo me te vogel se ai i vete hinkes. Kunetat do te jene te mbuluara me zgare metalike.

Ujerat e shiut mbidhen ne nje pike dhe me pas me nje pjerresi prej 2 % ato largozen ne drejtim te kunetes kryesore te drenazhimit.



## 5 ELEKTRIKET

I gjithe sistemi elektrik duhet te jete i tille qe te stakohet ne nje pike te vetme ne katin perkates, e cila mund te arrihet lehte dhe te kete shenjat dalluese perkatese. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqise duhet te jete e afishuar ne panelin e stakimit.

Ndriçimi i emergjences duhet te futet automatikisht ne pune dhe te kete nje kohe pune te pakten 1 ore ne rast se stakohet tensioni.

Tipologja impiantistike qe aplikohet eshte e tille qe siguron qendrueshmeri te sistemit, parametra normale te kushteve te punes si dhe eficence ne kursimin e energjise.

Projekti parashikon furnizimin me energji elektrike dhe instalimin e sistemeve per ambjentet e objektit per te 3 katet. Llogaritjet elektrike jane realizuar ne baze te fuqive te pajisjeve mekanike te dhena nga projektuesi i sistemeve mekanike, fuqite e makinerive dhe pajisjeve te dhena nga invizitor i pjesa perberese e procesit te prodhimit si dhe eshte parashikuar fuqia per ambientet teknike dhe te sherbimeveve.

### 5.1 Gjendja Ekzistuese

Objekti ka kabine Elektrike e cila vleresohej persa i perket kapacitetit te tij ne lidhje me kerkesat e fuqise se sistemit te ngrohjes dhe paisjeve te tjera qe vendosen. Dhe ne varesi te gjendjes se tyre (kapacitetit) dhe ne varesi te fuqise se instaluar te nevojshme te percaktuar, percaktohet dhe varianti me ekonomik per ushqimin e tyre me energji elektrike

### 5.2 Pershtatja

Ne keto ambiente mendohet te implementohet ngrohje qendrore dhe projektuesi duhet te marre ne konsiderate te gjitha kerkesat elektrike per nje funksionim normal.

Per sa i perket paisjeve te tjera, secila paisje , ka skemen elektrike perkatese ku percaktohet dhe fuqia e nevojshme. Ne varesi te skemes, fuqise dhe pozicionit ku do vendosen paisjet, jane percaktuar gjatesite, tipet dhe llojet e kabllove qe do te sherbejne per funksionim normal te ketyre paisjeve. Gjithashtu ne baze te vleresimit te sistemet elektrik ekzistues dhe ne baze te nevojave qe paraqesin keto aparatura, behet e mundur perzgjedha e variantit me ekonomik.

Gjithashtu ndricimi ekzistues ne keto ambiente nuk eshte i pershtatshemEshte bere vleresimi nga projektuesit per gjendjen ekzistuese dhe eshte peshtatur me ndricim me intensitet te mjaftueshem, ekonomik dhe cilesor (sugjerojme ndricimin Led).



### 5.3 Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjise dhe shfrytezimit:

Sistemi i Tokezimit:

- Sistemi TN-S

Tensioni nominal Punes ( $U_e$ ) :

- 400 V (F/F)
- 230 V (F/N)

Tensioni nominal Izolimit ( $U_i$ )

- $\geq 690$  V

Tensioni nominal i impulseve ( $U_{imp}$ ) qe durojne pajisjet e tensionit te ulet :

- 24 kV

Tensioni testues i pajisjeve te tensionit te ulet:

- 1 min. 50 Hz 3500 V

Frekuenca :

- 50 Hz

Sherbimi nominal :

- I panderprere

Renja e tensionit midis burimit dhe ngarkeses

- Maksimumi 4% ne AC (nga klemat e daljes se transformatorit te ngarkesa me e larget)

Madhesia e kabllit te neutrit :

- ne sekcion te njejtë me ate te fazes per seksione deri ne 16 mm<sup>2</sup>.
- Sa  $\frac{1}{2}$  e sekzionit te fazes per seksione me te medha se 16 mm<sup>2</sup>.
- ne sekcion te njejtë me ate te fazes ne rast furnizimi te pajisjeve qe shkaktoje harmonika (PC, servera, motora).

Kufizimet e Zhurmes:

- Ne perputhje me ligjet dhe normat lokale



#### 5.4 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do te realizohet nga kabina ekzistuese qe eshte afer objektit. Ne panelin kryesor do te kryhet edhe komutimi i furnizimit rrjet-gjenerator dhe nga ky panel ne panelin e kuadrit kryesor do te vi linja me gjenerator nga ku e gjithe godina do te jetë e furnizuar me gjenerator, pervec pajisjeve HVAC te cilat furnizohen direkt nga rrjeti..

#### 5.5 Sistemi i shperndarjes

Nderlidhja e kateve realizohet me ane te shaftit vertikal qe do te realizohet ne dhomen teknike. Furnizimi nga panelet ne ngarkesen fundore realizohet me tub fleksibel plastik te tipit dhe dimensioneve te ndryshme. Gjate fazes se zbatimit duhet pasur kujdes qe te behet nje kordinim i sakte per hapsirat e nevojshme per pozicionin perfundimtar te saj. Gjate instalimit duhen perdorur te gjithe materialet e duhura.

#### 5.6 Fuqia

Percjellesat dhe kabllot plotesojne kerkesa te larta per tipin e izolimit, mbeshtjelljes, dhe percjellesve te specifikuar. Kabllot e ushqimit te tensionit te ulet per sistemin e shperndarjes 400/230V duhet te jene konform me sistemet EN dhe TNC/S. Tipi izolimit duhet te jetë rezistent ndaj lageshtires dhe nxehesise, i pershtatshem per temperature pune maksimale deri ne 70 grade celcius. Kabllot duhet te jene nje cope pa lidhje mes tyre pervec rasteve kur distancat jane me te medha se gjatesia maksimale e kabllit.

Te gjithe percjellesit te perdorur ne instalimet elektrike jane prej bakri.

Percjellesat dhe Kabllot qe do te perdoren gjate instalimeve elektrike do te jene te GENERAL CAVI ne konforme te standardeve CEI, IEC, CEI UNEL.

Sekcionet minimale te percjellesve: te gjitha prizat 2.5mm<sup>2</sup>/ instalimet e brendshme te ndriçimit 1.5mm<sup>2</sup>, 400V/230V,

Kodi me ngjyra:

- Faze: E zeze,gri, kafe (kabllot)
- Faze: E zeze (telat)
- Neutri: Blu e lehte
- Tokezimi mbrojtës: Verdhe/jeshile (shirita)

Te gjithe kabllot do te etiketohen sipas skemave te paneleve te shperndarjes me numrin e qarqeve te tyre. Nese kabllot ose tubat jane instaluar per nje perdonim te mevonshem ose per te kursyer hapesiren kjo duhet treguar ne etiketim. I njejti informacion do te shenohet ne te dyja anet e kabllove dhe kutive.



Etikimi realizohetedhe tek kuadrat dhe tek panelet per cdo automat per te treguar se kujt destinacioni ose linje i perket ai. Kjo behet per te lehtesuar punen personelit te mirembajtjes ne manovrimin e tyre dhe per te pikasur lehte avarite e mundshme.

### 5.7 Ndricimi

Ndricimi i ambienteve eshte projektuar qe te plotesoje kerkesat fotometrike te ambienteve sipas funksionit te tyre. Ndricimi do te realizohet ne pjesen me te madhe te objektit me ndricues 60x60 LED 4000K te cilet plotesojne kushtet tekniko-ekonomike lm/W dhe me llojet e ndricueseve te propozuar ne projekt. Keto ndricues do te jene inkaso per montim ne tavan te varur me pllaka 60x60. Ne tualete do te jene spote rrrethor inkaso LED 23cm. Ne tualete e perbashketa komandimi i ndricimit do te realizohet me ane te detektoreve te levizjeve ne ambiente.

Ne instalimin e ndricimit te brendshem duhet pasur parasysh ruajtja e uniformitetit ne nivelin mbi 0.4.

#### Ndricues LED 60x60 Inkaso

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit : 3400lm,
- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Montimi : inkaso
- Shkalla e mbrojtjes : IP40, IK02
- Karkasa: metalike
- Mbulesa optike : pexiglas opal
- Temperatura pune: nga -10°C deri +40°C
- CRI : 80+
- Eficiencia: >90lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

#### Spot Inkaso 13W

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit 1100lm



- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Eficenca : >80lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

Ndricimi antipanik do te jete i shperndare ne korridore per te bere nje mbulim per ndricim te nevojshem gjate momenteve qe nuk ka energji ne objekt . Ndricuesit do te jene LED me nje autonomi minimale prej 3 oresh.

Ndricimi Exit eshte vendosur ne rruget e kalimit per te treguar rrujen me te shkurter te daljes dhe ne bashkveprim me sistemin e zjarrit qe ne rast evakuimi te tregoje daljet nga portat e emergjences. Keto ndricues do te kompozohen me etiketat perkatese qe tregojne rrujen e kalimit ne rast evakuimi si dhe tek dyert dalese do te jene mbi dyer me etiketen EXIT. Ndricuesit Exit duhet te jene LED me autonomi deri ne tre ore.

#### Ndricuesit e Emergjencave

- Ndricues LED
- Bateri NiCd
- Autonomi 3h
- Koha karikimit 12h
- Certifikimi : CE
- Shkalla mbrojtjes IP42
- Me tregues gjendje karikimi llamp LED jeshil-kuq

#### **5.8 Sistemi detektimit te zjarrit**

Sistemi i detektimit te zjarrit duhet te jete ne perputhje me kerkesat e standartit EN 54-13, standarte vendase ose standarte te tjera ekuivalente. Sistemi duhet te kryeje keto funksione: detektimin automatik te zjarrit, procesimin dhe ruajtjen e informacioneve te marra nga sensoret, sinjalizimin ne menyre efektive akustike dhe vizuale, mundesine e dhenies se alarmit ne menyre manuale nga pika te aksesueshme ne rrujen e evakuimit dhe detektim dhe sinjalizim i shpejte i defekteve te vete sistemit.

Sistemi i zjarrit do te jete i adresueshem dhe i ndare ne tre loop-e me sistem bus per marrjen e te dhenave dhe furnizimin nepermjet tij te sensoreve. Furnizimi i pajisjeve me rele eshte parashikuar te realizohet me vete me ane te ushqyeseve vetjak. Loop-et jane ndare ne tre zona ku cdo kat do te jete nje zone.



Sensoret e detektimit do te jene per detektim tysi per sensoret qe do te instalohen poshte tavanit te varur si dhe sensore nxehesie per ato qe do te instalohen brenda tavanit te varur. Per sensoret qe do jene brenda tavanit te varur duhet te vendosen sinjalizues LED ne drejtim te tyre poshte tavanit qe te tregojne ne menyre vizuale nqs kane vepruar ato sensore apo jo.

Butonat e dhenies se alarmit te zjarrit jane vendosur ne rruget e kalimit te evakuimit ne bashkeveprim me sinjalistiken e ndricimit exit, dhe duke respektuar largesite maksimale 45 m qe nje person duhet te kaloje qe te arrije nje pike thirrje te kerkuara nga normat.

Sirenat e brendshme me sinjalistike akustike dhe vizuale vendosen ne menyre te tille qe niveli i kerkuar i tingullit te jete me i madh se 65 dB dhe te pakten 5 dB mbi nivelin e tingullit te ambientit.

Paneli i detektimit i zjarrit do te jete i vendosur ne dhomen teknike ne katin 0 duhet te jete I pajsur me nje monitor LED ku te afishoje te gjithe eventet si dhe te lehtesoje sa me shume perdorimin e tij per personelin mirembajtes.

Per sistemin e detektimit te zjarrit te referohen vizatimet e projektit.

#### Centrali I kundrazjarrit

- I adresueshem
- Montim ne mur
- Kompletuar me display LED me ngjyra
- Me menu interaktive me mundesi perzgjedhje ne disa gjuhe (anglisht, italisht etj)
- Modular me mundesi zgjerimi modulesh minimumi me 3 module LSN per 3 LOOP-e
- I pajisur me modul kontrolli baterish per karikimin dhe per te kontrollu gjendjen e tyre
- Certifikimi VDS
- Database per regjistrimin deri ne 10000 evenete
- Port Ethernet per nderlidhje me kompjuter, BMS etj

#### 5.9 Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit

Sistemi i mbrojtjes ndaj shkarkimeve atmosferike do te realizohet me tokezim natyral duke shrytezuar zbritjet vertikale qe do te mbyllen me nje perimetral gjate gjithe objektit per te realizuar shkarkimin e rrimes si rezultat nga goditjet e rrufeve. Ndertohet nje sistem perimetral me percjelles te zhveshur bakri qe do jete ne nje thellesi minimale 0.5m me qellim



zvogelimin e tensioni te hapit. Ne impiantin e tokes duhet te lidhen armaturat metalike te nderteses, tubacionet metalike te hyrjes per ujin, gazin, etj... Duke qene se sistemi i furnizimit me energji elektrike eshte 10/ 20 kV, tokezimi i mbrojtjes do te jete i njejte me tokezimin e punes. Pra buloni i nulit te trafos do te lidhet me percjellesin e tokes . Nese nuk realizohet vlefta e rezistences se tokes  $R \leq 4 \Omega$ , me numrin e elektrodave te paraqitura ne projekt, atehere duhet te realizohet tokezim artificial, duke perpunuar vendin ku do te behet tokezimi. Sistemi i rrufepritesit ne tarrace do te ndertohet me shtiza rrufepritesit te projektuar per te mbuluar zonen e godines referuar vizatimit perkates. Shtizat e rrufepritesit do te ngrihen nga tarraca 1.5m ne menyre qe te kemi nje mbulim sa me te gjere. Duhet pasur parasysh qe te tokezohen te gjithe paisjet dhe elementet metalik qe ndodhen ne tarrace (paisjet HVAC) per ti mbrojtur nga goditjet direkte ose indirekte.

### **5.10    Normat Ligjet dhe rregullat**

Karakteristikat e pajisjeve, komponenteve dhe materialet e nevojshme për të përfunduar punimet, duhet te jenë në përputhje me karakteristikat e treguara ne kete dokument, duke respektuar ligjet, rregulloret dhe normativat (CEE, UNI, EN, ISO, INAIL, CEI).

Të gjitha pajisjet, komponentët, materialet duhet te jene te reja dhe me cilësine më të mirë në treg, te produara dhe përpunuara nga një profesionist i përshtatshem. Te jenë të destinuara per sherbim dhe karakteristikat e performancës se kerkuar të jene te larta.

Të gjitha materialet dhe furnizimet të jene te pajisura mundësisht me shenjën e cilësisë në përputhje me UNI EN ISO 9001 dhe / ose produkte të certifikuara nga organizata, dhe , ndonëse të dobishme, kanë CE shënuar sipas Direktivave te KE 392/89, të ndryshuar, dhe të jenë në përputhje me dispozitat e dekretit legjislativ Nr 81/2008 në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të vendosura nga Direktiva.



## 6 KONDICIONIMI DHE VENTILIMI I AMBIENTIT

Godina në praktikë përbën një ndërtesë që klasifikohet e tipit Ndërtesë Publike dhe është vlerësuar sipas disa faktorëve specifike që lidhen me funksionimin e saj.

Për sa i përket Klimatizimit (Ngrohjes dhe Ftohjes) së kësaj ndertese, elementët teknike të vlerësimit janë:

- (I) Çfarë ofron Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar
- (II) Vlerësimi i ngarkesave termike
- (III) Skema e zgjedhur

### 6.1 Gjendja Ekzistuese

Ne ambientet aktuale te godines nuk ka sistem qendoror ngrohje dhe ftohje por ambientet aktuale jane te paisura me kondicionere te cilet nuk kane rendimentin e duhur.

### 6.2 Pershtatja e Ambjentit

Ne keto ambjete te cilat do riorganizohen duhet te sigurohen kushtet e nevojshme per ngrohje ftohje te ambjentit. Pra projektuesi ka vleresuar gjendjen aktuale dhe ka percaktuar masat e nevojshme per te siguruar nje funksion normal te ketyre ambjenteve pershtatur me funksionin qe do kene. Eshte menduar sistem ngrohje ftohje qendrore per gjithe ambientet.

### 6.3 Të Përgjithshme

Sistemi i ajrit të kondicionuar përbehet nga:

- ❖ Pajisjet kryesore të sistemit; Njësit e jashtme të sistemit e përshtatshme për lidhje VRV, Njësite e brendshme kanalore/kasete VRF.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve te ajrit të freskët, rikuperatoret me gjithë komponentët, grilat dhe difuzoret, tubat fleksibel dhe aksesoret e montimit.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve të gazit ftohës/ngrohës me gjithë komponentët dhe aksesoret e montimit.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve të kondensave me gjithë komponentët dhe aksesoret e montimit.

### 6.4 Rregullat dhe normat e projektimit

Per projektimin jane ndjekur rregullat e normat e meposhtme:



- ❖ EN Standard , ISO standard .EN ISO 13790:2008 (Përllogaritja e ngarkesës ngrohëse dhe ftohëse për kondicionimin e ndërtesave)
- ❖ ASHRAE standard 55a-95 (Temperaturat dhe Lagështia relative për mjediset e populluara)
- ❖ EN Standard , ISO standard .EN ISO 15242:2007 (Kriteret e ventilimit ne godina, ndikimi ne llogaritjet termike)
- ❖ ASHRAE standard 62.1-2013 (Ventilimi ne lidhje me kualitetin e ajrit)
- ❖ ASTM C1071-12 (Term izolimi dhe izolimi akustik për kanalet e ajrit)

**a- KRITERET E PROJEKTIMIT**

**b- PERLLOGARITJET E SISTEMIT**

**c- PERZGJEDHJA E SISTEMIT DHE FUNKSIONIMI I TIJ**

## 6.5 Kriteret e Projektimit

Vendndodhja : ELBASAN

Objekti i projektimi është i vendosur në qytetin e Elbasanit, për të cilin kushte e joshmë projektuese janë përcaktuar si me poshtë:

- ❖ Temperatura e joshmë llogaritëse për stinën e ftohte  $-10^{\circ}\text{C}$  , lagështia relative 79%.
- ❖ Temperatura e joshmë llogaritëse për stinën e ngrohte  $+35^{\circ}\text{C}$ , lagështia relative 52%.

Nisur nga destinacioni i godinës, për kushtet e brendshme do të merret në konsiderate:

**1. Për stinën e ftohte**

Temperatura për ambiente e brendshme dhomat e vizitave, laboratorët e analizave dhe sallës së venetëve, do të jetë  $22^{\circ}\text{C}$ .

**2. Për stinën e ngrohte**

Për ambiente e brendshme dhomat e vizitave, laboratorët e analizave dhe sallës së venetëve, do të jetë  $24^{\circ}\text{C}$ .



Për të krijuar një ambient sa me komod, sipas kërkesave të investitorit për çdo ambientin është parashikuar sistemi i ventilimit me rikuperim të energjisë. Në përllogaritjen e volumeve për çdo ambient është marre në konsiderate kërcesa për ajër në baze të konsumatorëve. Për çdo person është parashikuar një sasi ajri e freskët sipas standardit përkatës.

## 6.6 Perllogaritjet e Sistemit

### 1- Ngarkesa Ngrohëse

Janë llogaritur humbjet me transmetim të godinës dhe ato për ventilimin.

Humbjet me transmetim:

$$Q_T = S * u * Dt$$

Q - humbjet e nxehësisë

S - sipërfaqe e joshmë e objektit (mure, dritare, solete, dysheme)

u - koeficienti i humbjeve të nxehësisë, varësi e materialeve të përdorura

Dt- diferenca e temperaturës jashtë -brenda

Temperaturat :

Temperatura e jashtme llogaritëse për Elbasanin është marre  $-10^{\circ}\text{C}$

Temperatura brenda objektit në varësi të ambienteve siç është treguar me lart.

Koeficientet e humbjeve janë marre:

- Mure të jashtëm të objektit të term izoluar sistemi kapote  $u = 0.6 \text{ W/m}^2\text{K}$
- Dritare duralumini me ndarje termike dopioxham  $u = 1.5 \text{ W/m}^2\text{K}$
- Dysheme / soleta beton i armuar  $u = 1.4 \text{ W/m}^2\text{K}$
- Llogaritje rriten me 10% për efekt të urave termike

Humbej në rrezatim :

Llogaritja e humbjeve ne rrezatim është marre  $300 \text{ W/m}^2 \text{ xham}$ .

Humbej ne ventilim :

$$Q_V = V * r * Dt$$



Q - humbjet e nxehësisë

V - Volumi i ajrit ventilues

r - koeficienti i nxehësisë specifike te arit  $0.34 \text{ W/m}^3\text{K}$

D<sub>t</sub> - diferenca e temperaturës jashtë - brenda

Ngarkesa e përgjithshme:

$$Q = Q_T + Q_V$$

Kësaj ngarkese i zbriten:

Nxehësia e gjëndëruar nga ndriçimi, punonjësit dhe aparaturat shtese të çdo ambienti.

Sasia e nxehësisë e gjenerura për efekt të ndriçimit është marre  $10 \text{ W/m}^2$

Sasia e nxehësisë e gjeneruar nga punonjësit është marre  $120 \text{ W/person}$

Sasia e nxehësisë e prodhuar nga aparurat është marre  $250 \text{ W / kompjuter}$

## 2- Ngarkesa ftohëse:

Ngarkesa ftohëse llogaritet ne transmetim, humbje ne ventilim dhe rrezatim .

Llogaritja e humbjeve me transmetim dhe ventilim behet njësoj si ngarkesa ngrohëse. Temperatura e jashtme llogaritëse është marre për Elbasan  $35^\circ\text{C}$  . Nxehësia e gjeneruar nga ndriçimi, punonjësit dhe aparaturat shtese të çdo ambienti do ti shtohen kësaj ngarkese.

Në humbjet me rrezatim janë marre në konsiderate sipërfaqet e xhamit:

$$Q = S * K$$

Q - humbjet e nxehësisë

S - sipërfaqja e hapësirës që rrezatohet

K - koeficienti i rrezatimit për orën e pikut që varet nga lloji i xhamit dhe mbulimin me grila e perde. Në këtë rast K është marre  $300 \text{ W/m}^2$

Sipërfaqet vertikale të mureve nuk merren në konsiderate për humbjet me rrezatim .

Sipërfaqet horizontale (soleta) llogariten me të njëjtën formule si humbjet me transmetim:



$$Q_T = S * u * D_t$$

Q - humbjet e nxehësisë

S - sipërfaqe e jashtme e objektit ( mure, dritare, solete, dysheme)

u - koeficienti i humbjeve të nxehësisë , varësi e materialeve të përdorura

Dt- diferenca e relative temperaturës jashtë - brenda

Diferenca e temperaturës është relative pasi ajo merret parasysh jo si temperature e ajrit të jashtëm por si temperature e sipërfaqes së rrezatuar në këtë rast Dt është marre  $26^{\circ}\text{C}$  Brenda  $24^{\circ}\text{ C}$  dhe sip. e soletës  $50^{\circ}\text{C}$

### 3- Ventilimi

Ventilimi i godinës është bere me njësi të ndare për çdo ambient me vete. Sasia e ajrit ventilues është përllogaritur me  $40 \text{ m}^3/\text{h}$  për person.

Dimensionet tubacion janë llogaritur me formulën :

$$S = Q / v$$

S – seksioni i tubacionit

Q – sasia e ajrit ventilues

v - shpejtësia e lëvizjes së ajrit në tubacione

Shpejtësia e lëvizjes së ajrit në tubacione është marre :

Në elementin fundor	1,5 m/s
Në degët e tubacionit	2,5 ÷ 4 m/s
Në magjistral brenda godinës	5 ÷ 6 m/s
Në magjistral jashtë godinës	8 m/s

### 6.7 Perzgjedhja e sistemit dhe funksionimi i tij

Për përballimin e humbjeve të gjeneruara projekt i është ndare në dy sisteme.



1. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes me njësi fundore për çdo ambient në varësi të tij , të tipi kasete/kanalore, i përshtatshëm për lidhje VRF e që do të përballojë humbjet me transmetim, dhe
2. Futja e ajrit të freskët të trajtuar që merr parasysh humbjet me ventilim.

Sistemi i pare parashikohet të punoje gjate stinës së ftohte për ngrohje, nga tetori deri në prill, dhe për ftohje nga qershori deri në shtator.

Në rekomandojmë një sistem VRF , për disa arsyen rendiment me të mire (kosto me e ulet shfrytëzimi), menaxhim me i thjeshtë në kontrollin e punës së njësive, parcializim me i madh në varësi të kërkesës së impiantit.

Sistemi i dyte do të punoje gjate gjithë vitit. Ai do të kompensoje me ajër të freskët ambientet e ventiliuara dhe do të rregullojë temperaturën e brendshme për periudhat e ndërmjetme dhe gjate gjithë vitit për ambientin e tjera.

Ambientet do të kenë kontroll të veçantë të temperaturës në baze të kërkesës së secilit ambient.

Njësite fundore të ngrohje-ftohje janë vendosur të tipit kanalore në përshtatje me arkitekturën për secilin ambient por duke ruajtur në mënyrë rigorozë kërkesat e ambienteve për nivelin e zhurmave, si dhe kriteret teknike të montimit dhe mirëmbajtjes.

Duhet të përmbajnë minimalisht, por jo të kufizuara deri këtu, sa me poshtë përshkruar:

- Kasa prej llamarine të galvanizuar e term izoluar në varësi të tipit edhe e myllura me mantelin prej material plastic në varësi të modelit të prodhuesit.
- Ventilator të tipit centrifugal me tre shpejtësi të rregullueshme + shpejtësinë automatike.
- Filtër ajri të tipi rrjete i zmontueshëm që mund të lahet me ujë të rrjedhshëm dhe të rivendoset.
- Skedën elektronike dhe pultin e kontrollit për përcaktimin dhe monitorimin e regjimit te punës. Regjimet e punës do të jene: ftohje, ngrohje , ventilim , heqje lagështie etj.
- Pompën për largimin e kondenses e komanduar nga një galexhant niveli për punim automatik .
- Lidhja me rrjetin me rakorde.



Suportet , varëset dhe gjithë elementet e tjera ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar. Ato duhet te garantojnë pajisjen nga vibrimet për të shhangur zhurmat në ambiente. Niveli i zhurmave i pranueshëm 40dB.

Njësitë e jashtme të kondicionimit duhet të përmbajnë minimalisht, por jo te kufizuara deri këtu , sa me poshtë pëershkuar:

Kompresori i tipit Digital Scroll Inverter bashke me rezistencën për ngrohje të vajit.

Bateria kondensuese/avulluese e tipit gaz-ajër të ndërtuar nga serpentine me tuba bakri dhe radiator me fletë te holla alumini.

Qarku i fluidit punues duhet të përmbajë valvol për mbushje me gaz, filtër gazi, tregues presioni në hyrje dhe dalje nga kompresori, ndërprerës së punës në rast mbi dhe nën presioni, tregues fluksi, valvol me katër rruge elektrike, valvol ekspansioni.

Ventilator aksial me grille mbrojtëse me shpejtësi të rregullueshme sipas kërkesës së fluidit punues. Motori i ventilatorit duhet të jetë i tipit të mbyllur pa nevoje për lubrififikim të mëvonshëm.

Skeda elektronike e cila do të rregulloje dhe monitoroje regjimin e punës, si dhe komunikimin me njësite e brendshme. Ajo duhet të rregulloje ngarkesën në baze të kerkeshes se brendshme. Njesite do te montohen mbi suporte antivibrant per te shhangur transmetimin e zhurmave në ambientet e godinës.

Kushtet e jashtme të punës për pajisjet:

Stina e ftohte - 5°C , Stina e ngrohte + 43°C

Rendimenti COP jo me i vogël se 3.4

Njësitë e ventilimit do të jene të tipit me rikuperim nxehësie. Rikuperimi do të behet në seksionin e rrymave të kundërtta ku ajri i trajtuar që del i jep/merr nxehësi ajrit të freskët që hyn. Minimumi i rendimentit të shkëmbyesit do të jetë 60%.

Kutia llamarine e zinkuar me veshje izoluese, me kapakë shërbimi min. ne dy krahë.

Ventilatori, i tipi centrifugal me motor direkt në turbine me tre shpejtësi të rregullueshme , i balancuar dhe kolauduar nga prodhuesi.



Elektromotori me klase mbrojtje IP54, me mbrojtje temperature të brendshme, për ruajtje nga mbinxehja deri ne 120°C.

Tubacione e ajrit ventilues tuba prej llamarine të galvanizuar të formës drejtkëndore, bashkim i tipt me fllanxha. Kthesat e tubacioneve për te minimizuar zhurmat do të jene me rreze jo me te vogël se 0.5D (ku D është dimension i brinjës me të madhe të tubacionit drejtkëndor). Suportet, varëset dhe gjithë elementet e tjerë ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar.

Spesori i llamarinës së tubacionit duhet të respektoje kushtin:

- për brinjën me të madhe deri 400 mm, sp.=0.6mm
- për brinjën me të madhe 400 deri 600 mm, sp.=0.8mm
- për brinjën me të madhe 600 deri 1000 mm, sp.=1.0mm

Tubacionet e ajrit do të termoizolohen me material arloflekt me ngjitje, dhe densitet të lartë me trashësi 8 mm.

Varjet e tubacionit do te behën në distance çdo 10 diametra.

#### ➤ Grilat

Do të jene prej materiali alumini të trajtuar kundër oksidimit, me flete të rregullueshme dhe regjistër të sasisë se ajrit. Konstruksioni i saj duhet të garantoje shtangësi dhe të mos krijoje zhurma dhe vibrimen gjate punës. Llojet e grilave të përdorura do të jene lineare, me 2-drejtime, 4-drejtime dhe grila te tipi "SLOT" me 2 kanale. Grilat do jene të pajisura dhe me damper volumor për regjistrimin e volumit të ajrit bazuar në shpejtësinë dhe presionin e ajrit në dalje nga grila.

#### ➤ Rrjeti i tubacioneve te bakrit.

Rrejti i tubacioneve do të realizohet me saldim, me elektroda argjendi pa praninë e ajrit në të gjate procesit të saldimit. Për largimin e ajrit nga tubat do të përdoret azot i thatë. Rrjeti do të jete i term izoluar me pësor term izoluese jo me te vogël se 9 mm. Para lidhjes se pajisjeve rrjetit do ti behet prova nën vakum për 48 ore. Suportet, varëset dhe gjithë elementet e tjerë ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar. Varëset do të vendosen jo me larg se 1.5 m nga njëra tjetra.

#### Modeli

Ndërtimi i kabinetit edhe kornizës



- Struktura e pajisjes është një kornize metalike e jashtme dhe pjesët e brendshme të strukturës të jene të bëra nga çelik i zinkuar.
- Njëshja duhet të jete e disenjuar me një fasade të dyte për presionin nën dysheme të rrjedhjes se ajërti, kur një panel i jashtëm është hequr për servis ose mirëmbajtje. Panelet e ndërmjetme duhet të jene të segmentuar për secilën pjese të njësisë (një panel sekondar për të aksesuar filtrat, seksionin e faneve spiralet etj). Gjithashtu edhe për të minimizuar rrjedhjen e ajrit kur paneli është i hapur.
- Paneli i jashtëm do të jete i lyer me boje epoxy-poliestër. Panelet përparrë duhet të jene të ngritur me kuadratin me ane të kapseve. Paneli nga jashtë do të jete me dopjo cope kurse nga brenda me material fiber-qelq izolues nxehtesie.

### **Filtrat e kthimit te ajrit**

- Filtrat e ajrit të jene me kase metalike edhe me fibra sintetike. Ndërrimi i filtrave të behet nga pjesa e perparme e njësisë.

### **Ventilatorët**

- Ventilatorët e ajrit të kenë hyrje të vetme edhe dinamik të balancuar.

### **Mikroprocesori Kontrollues**

1. Kontrolli duhet të përfshijë:
  - Bordi i kontrolli të mikroprocesorit të jete vendosur brenda panelit elektrikisht, i ndare nga njëshja e rrjedhjes se ajrit.
  - Të ketë ndërsa qe të thjesht për përdoruesit.
2. Bordi i kontrollit të mikroprocesorit duhet të përbajë të dhëna dhe program të të gjithë parametrave të ruajtur të cilat duhet të jene të dukshme në ndërsa qen e përdoruesit.
3. Ndërsa qja e Përdorueseve të jete i mbrojtur me password.
4. Ndërsa qja e Përdorueseve të lejoje modifikimin edhe rregullimin e parametrave.

### **Kontrolli i Funksionimit të Sistemit**

1. Temperatura edhe kontrollimi i lagështirës bazuar në rregullimin e të dhënave.
2. Sinjalizimin e alarmeve lokalish dhe remetë.



3. Regjistrimin e të gjitha alarmeve edhe mbajtjen e tyre për minimumin e 100 ngjarjeve të fundit.
4. Ri ndezje automatike pasi energjia rikthehet.
5. Komandim në distance të njësisë on/off
6. 2 nivele (të dhëna dhe servise)
7. Mundësia për të komunikuar me një sistem supervizimi me një kabell etherneti në BACNet IP, SNMP, Modbus IP dhe TCP/IP.
8. Funksionimi Ore/Date
9. Llogaritja e orëve vepruese dhe fillimin e ciklevë të komponentëve kryesore.
10. Mundësia për të pare statusin e të gjithë komponentëve.
11. Mundësia për të pare të gjitha vlerat e raportuara nga sensoret të lidhur me bordin e kontrollit.
12. Menaxhim lokal në rrjet deri ne 10 njësi.
13. Mundësi të vendosesh një ose 2 njësi në stand-by.
14. Mundësia për të vendosur një temperature mesatare.
15. Të ketë mundësinë e "Manual Override" funksion i cili lejon kontrollin manual të komponentëve kryesor pa përjashtuar kontrollin nga distanca.

### Ndërfaqja e përdoruesve

1. Ndërfaqja e përdoruesve duhet te ketë:
  - 1 backlit 132 × 64 pixel LCD ekran me zile
  - 6 backlit çelës të lëvizi ndërmjet edhe te ndryshoj parametrat
2. Bordi i mikroprocesorit të jete i lidhur me ndërfaqen e përdoruesit me një kabell RJ11

### Përzgjedhja e gjuhës

1. (IT = Italian, En = English, DE = German, FR = French, SP = Spanish, RU = Russian)
2. Njësia duhet të jete e afte të shfaqe vlera në sistemin metric edhe ne imperial.

### Program Identifikues

1. Firmware rishikimi numrit, data e rishikimit dhe e familjes së produktit është në dispozicion për përdoruesit

### Ekrani

1. Statusi i ekranit. Ndërfaqja e përdoruesit të parazgjedhur duhet të shfaqe:



- Kohen, datën dhe numrin e njësive LAN
  - Temperaturën e dhomës dhe lagështirën relative
  - Statusin e njësisë
  - Simbol fleshimi kur tregon që njëshja është në progres
2. Switch On Unit/Switch Off ekranin e njësisë.
  3. Input/Output screen : të verifikoi gjendjen e hyrjes dhe daljes të bordit.
  4. Setpoints screen: të kontrolloi setpoint dhe parametrat e tjera kalibrimit për funksionimin e duhur te njësisë.
  5. Alarms History screen: të shfaq në sekuenca historike 100 alarmet me të fundit.
  6. Software Info screen: të shfaq versionin e softerit. Bios boot dhe numrin serial. EEV
  7. Valve status: shfaqin formacion nga bordi elektronik i valvules zgjeruese

## Të dhëna

1. Sleep Mode
  - Një funksion i kursimit i energjisë të mund të aktivizohet ose çaktivizohet duke përdorur panelin e kontrollit ose sistemin e monitorimit të përberë nga një start-up automatik i njësisë stand-by një nga kufijtë e mëposhtëm tejkalohet për të paktën 30 sekonda.
  - Temperaturën minimale
  - Temperaturën maksimale
  - Minimumin e lagështirës relative (vetëm me sensor lagështire sipas kërkesës)
  - Maksimumin e lageshtires relative (vetëm me sensor lagështire sipas kërkesës)
2. Kohëmatësi
  - Ky program mundëson vendosjen e intervaleve të mirëmbajtjes për komponentët kryesore të njësisë duke krijuar një prag për orët operacionale. Kur pajisja e monitoruar arrin limitet, mikroprocesorët sinjalizojnë kërkesën e mirëmbajtjes.
3. Selektimi i alarmeve reale
  - Statuset e sinjaleve të alarmit duhet të jene të afte për tu vendosur të normalisht të hapur ose normalisht të mbyllur.
  - Mikroprosesori duhet të jete i afte për të menaxhuar automatikisht një rrjet lokal të lidhur me maksimumin 10 njësi, të paktën deri në 2 njësi mund të qëndrojnë në Stand-by.
4. Të dhënat e orës



- Mikroprocesori i njësisë duhet të përfshij një karte për orën që do të mirëmbajë edhe shfaq datën, orën dhe ditët e javës.

## Kontrolli manual

1. Për të ndihmuar mirëmbajtjen dhe kontrolllet ose në raste emergjence, përbërësit e mëposhtëm individual mund të aktivizohen me dore dhe në mënyrë të pavarur nga proceset e kontrollit.
  - Njësia faneve (Unit start-Up)
  - Kompresorët 1/2/3/4 (e aplikueshme)
  - Funksioni i dehumifikimit (e aplikueshme)
  - Aktivizimi 0/1 I daljeve analoge ne DX (Y0/Y1Ramp)

## Alarmet

1. Historiku i alarmeve

Mikroprocesori duhet të mbaj të paktën deri në 100 alarme në memorien e tij.

## KOMPONENTE SHTESE

### 1. Lagështuesi

- Duhet të përbehet nga të paktën 3 elektroda dhe të këtë një konsum deri në 8 l/h

### 2. Adaptor serjal RS485

- Lejon kartën të instalohet duke lejuar komunikimin nëpërmjet një lidhje RS485 mes mikroprocesorit dhe sistemit të mbikëqyrjes së klientit duke përdorur RTU modus ose protokollin Johnson Controls Metasys.

### 3. Clock card

Për regjistrimin e kohës edhe datës për çdo alarm të dhëne.



## 7 MBROJTJA KUNDER ZJARRIT

Ky sistem, eshte shume i rendesishem per ndertesen ne teresi dhe duhet te jete i nderlidhur me permasimet strukturale / arkitektonike, me sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit dhe evakuimin e personave.

Ata do te perzgjidhen ne funksion te zgjidhjes arkitektonike, duke siguruar zbatimin e normave per mbrojtjen kundra zjarrit, ne te dy rastet, ne aspektin pasiv te sistemit kundra zjarrit ( i lidhur me karakteristikat e nderteses) dhe ne aspektin aktiv te sistemit kundra zjarrit (i lidhur me instalimet elektriqe dhe mekanike te mbrojtjes kundra zjarrit) i cili eshte objekt i instalimeve mekanike.

Qëllimi i këtij impianti është të mbrojë personelin dhe nxenesit duke siguruar nëpërmjet **masave pasive dhe aktive** evakuimin dhe shpëtimin e tyre.

**Masat pasive** perbejne tërësinë e masave arkitektonike dhe konstruktive duke zgjidhur dhe përcaktuar drejt rrugët e shpëtimit në korridore, shkallë, daljet e emergjences, shkallë të brendshme të mbrojtura, si për personelin dhe nxenesit, evakuimin e tyre, sigurimin e kompartimenteve të mbrojtura nga zjarri dhe tymrat nëpërmjet strukturave ndërtimore si mure, tavane, dysheme dyer etj, me rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj zjarrit (REI), sipas normave etj. Rrugët e evakumit dhe shpëtimit janë të plotësuara me sinjalistikën përkatëse sipas normave.

**Masat aktive** përbëjnë qëllimin e projekteve mekanike dhe konsiston në ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit me qëllim mbrojtjen e personave te akomoduar, personelit si dhe mbrojtjen e strukturave dhe vetë godinës.

Për këtë qëllim janë projektuar sistemet e shuarjes së zjarrit me uje nëpërmjet sistemeve me hidrantë, me sistemet e shuarjes me gaz ose pluhur me pajisje dhe bombula portative në përputhje me kategoritë e zjarrit si dhe masa të tjera që kompletojnë impiantet e tjera elektromekanike, të cilat shërbejnë për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe të tymrave si dhe evakuimin e këtyre të fundit. Kështu në projektet mekanike janë parashikuar masa specifike si vendosja e damperave të zjarrit dhe të tymit në kanalet e ajrit të kondicionimit në kalimet vertikale dhe horizontale të tyre etj.



Implanti i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në përputhje me standarde dhe normat lokale, si dhe normave italiane CNVVF/CPAI UNI 9485, etj, si dhe "Prevenzione Incendi Ospedali" D.M 18 Septembre 2002.

## 7.1 Gjendja Aktuale

Ne ambientet e kesaj godine nuk ka sistem hidrantesh te mbrojtjes kundra zjarrit por vetem portative me pluhur.

## 7.2 Pershtatja e Ambienteve

Projektuesi ka vleresuar sistemin aktual te mbrojtjes kundra zjarrit dhe ka percaktuar me ane te projektit te gjitha masat e nevojshme qe duhen marre ne menyre qe ky sistem te jetet funksional.

Per kete qellim, per sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit ( me uje), para se gjithash duhet te sigurohet: depozitim i ujit ( sasia e ujit e cila llogaritet per te gjithe ndertesen) dhe ambienti mekanik i ndertesen, sigurohet rrjeti i kolonave per mbrojtjen kundra zjarrit me hidrante, per te siguruar funksionimin e perkohshem te hidrantave me pak te favorshem ne varesi te gjykimit te projektuesit, me 120 l / per ore, me presion shkarkimi 2 bar, bazuar ne skemen dalese te sigurise per evakuimin, shkallevet e hidrantet e jashtme.

Pompat projektohen ne menyre te atille te fillojne punen ne menyre automatike, per te siguruar ne rastin e nje zjarri rrjedhen e presionin e ujit.

Rrjeti i brendshem dhe i jashtem i tubave per furnizimin me uje realizohet nga materiale te pershtatshem, te perzgjedhura me gjykin e projektuesit sipas normave dhe standardeve teknike.

Sigurohet mundesa e lidhjes ndermjet sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit me autopompe per lidhjen me Zjarrefikeset.

Projekti permban elementet e meposhtem:

- **Skema ku tregohen :**

Sistemet dhe pajisjet e diktim -sinjalizimit te zjarreve

Mjetet dhe paisjet e shuarjes se zjarrit

Skemen e evakuimit te detyruar te punonjesve ne rast zjarri



### 7.3 Kriteri të përgjithshme projektuese

**Implanti i mbrojtjes nga zjarri** është konceptuar që të ndërtohet në përputhje me kërkesat dhe normat për përdorimin e teknikave dhe pajisjeve shuarëse që do të aplikohen mbi bazë të specifikave dhe klasave të zjarreve të mundshme ne objekt.

**Në analizë të zjarreve** të mundshme rezulton se sistemi i shuarjes me ujë nëpërmjet hidrantëve zënë pjesën më të madhe në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, por gjithashtu e shoqëruar me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lëndë shuarëse të gaztë dhe pluhur, mbi bazë të klasave të zjarrit.

**Për sistemin e shuarjes me ujë**(hidrantët), efikasiteti i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit varet në një shkallë të lartë nga mjaftueshmëria e kapacititetit të ujit dhe presionit të tij, të cilët duhet të janë të mjaftueshëm për të mbrojtur sipërfaqet specifike mbi bazë të sasisë së nevojshme të ujit, kohës së veprimit etj. Ndërsa për sistemin e shuarjes me mjete portative efikasiteti i tyre konsiston në vatra zjarri të lokalizuara.

Faktorët përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë :

- Natyra dhe përmasa e zjarrit;
- Madhësia e zonës që do të mbrohet;
- Mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit;
- Kërkesat dhe normat sipas CNVVF/CPAI UNI 9485 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

Për të siguruar funksionet dhe autonominë e sipërpermendur impianti aktiv i mbrojtjes kundër zjarrit është i përbërë nga :

- a) centrali teknik i përbërë nga rezerva ujore dhe grapi i presurizimit,
- b) rrjeti i shpërndarjes dhe hidrantët,
- c) pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),
- d) pajisjet e kontrollit të zjarrit dhe mospërhapjes së tymit.

### 7.4 Klasifikimi i klasave të zjarrit

Për të përdorur agjente shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit.



Në bazë të normave/standardeve bashkëkohore, pajisjet shuarëse të zjarrit janë klasifikuar në pesë klasa. Standarti europian për këta shuarsa dallon klasat e mëposhtme:

**Klaza A** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të ngurtë sikurse dërrasë, letër, plastik, tekstile,etj.

**Klaza B** - vlerëson zjarrë që e kanë origjinën prej materialeve të längshëm sikurse benzenë, benzole, naftë, alkol, vajra etj.

**Klaza C** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të gazta sikurse metan, propan , butan GPL etj.

**Klaza D** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve metalike si alumin, magnez, natrium, etc.

**Klaza E** - vlerëson zjarre nga pajisje elektrike që janë nën tension .

### **7.5 Sistemi i shuarjes me ujë - me hidrantë**

**Sistemi ishuarjes me uje** eshte sistemi kryesor i impiantit te shuarjes nga zjarri i përdorur ne objektin e konviktit. Kjo zgjedhje eshte ne përputhje te plote me vetitë shuarës te ujit per **zjarre te klasës A** .

Sistemi i shuarjes me ujë është i përbërë nga centrali teknik dhe rrjeti i shpërndarjes.

**Centrali teknik** përbërëhet nga:

- rezerva ujore
- grapi i presurizimit,

**Rrjeti i shpërndarjes** përbëhet nga :

- rrjeti i shpërndarjes dhe kollonat

**Pajisjet fikëse** përbehen nga:

- hidrantët

### **7.6 Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative**

- pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),



## 7.7 Rezerva ujore

**Sasia e ujit** të depozituar për mbrojtjen kundër zjarrit është përcaktuar duke marrë në konsideratë llogaritjet e konsumit të ujit nga numri i njëkohshëm i hidrantëve në punë në përputhje me numrin e kollonave të rrjetit shpërndarës, numrit te hidrantëve njëkohësisht ne pune per cdo kollone pra, nga numuri total i hidrantëve njëkohësisht ne pune.

**Konsumi i ujit** të çdo hidranti **UNI 45** është **120 l/min** dhe per te gjithë hidrantët njëkohësisht ne pune parashikohet prurja që duhet të sigurojë grupi i presurizimit, ndersa koha në të cilën duhet të garantohet kjo prurje per funksionimin e te gjithe hidrantëve është parashikuar **60 min**. Nëpërmjet këtyre dy parametrave baze përcaktohet **Sasia e rezerves ujore** per mirëfunksionimin e sistemit te mbrojtës nga zjarri me hidrantë.

**Rezerva ujore** ne kete rast eshte menduar te perbehet nga depo uji e cila do te pozicionohet ne katin nentoke ne ambientin teknik ku kapaciteti eshte perllogaritur ne baze te kerkesave te nevojshme te sistemit sipas normave ne fuqi.

**Dhomat e depos** së ujit do të kompozohen si më poshtë:

- Tubacionet e furnizimit me ujë, në të cilat do të vendosen valvola ndërprerëse që lidhen me galexhantët mekanik që kontrollojnë nivelin e mbushjes;
- Tubacione e terheqjes(thithjes) se ujit nga depozitat ku do të instalohen valvola ndërprerëse me të gjithë aksesorët që kërkojnë centralet e pompave përkatëse;
- Tubi i shkarkimit (tropo pieno);
- Tubi i boshatisje që do të instalohen në pjesën e poshtme të rezervuarit. Ai duhet të jetë i pajisur me një valvul kontrolli;
- Tregues niveli, etj.

## 7.8 Grupi i presurizimit

**Grupi i presurizimit** është kompozuar në perputhje me kérkesat e projektit per te siguruar prurjen e nevojshme per furnizimin e te gjithë hidrantëve njëkohësisht ne pune. Pompa është me parametra dhe karakteristika teknike e destinuar përrjetin e hidrantëve. Pompa është e kompozuar nga një elektropompë, e ushqyer nga rrjeti normal elektrik, një motopompe e cila do te jete back-up ne rastet e renies se zjarrit dhe ne munges te furnizimit me energji elektrike te pompes kryesore dhe nga pompa Jockey. Grupi i presurizimit i pajisur me panel kontrolli i cili komandon secilën pompë dhe pajisjet e tyre komandojnë në mënyrë të percaktur, nisjen, ndalimin e pompës duke realizuar njëkohësisht monitorimin dhe



sinjalizimet e nevojshëm duke përcaktuar kështu statusin dhe kushtet e stacionit të pompimit.

**Parametrat teknik** të grupit të presurizimit llogaritur mbi bazë të prurjes së kërkuar per cdo hidrant të barabartë me **120 l/min**, presionit në dalje në hidrantin në pozicionin hidraulik më të disfavorshëm të rrjetit të barabartë me **2 bar** dhe humbjeve të rrjetit mbi bazë të formulës Hazen -Williams.

Pompa e mësipërme është zgjedhur mbi bazë të produkteve të certifikuara të normave europiane dhe **Standardit EN 12845**.

## 7.9 Rrjeti shpërndarës

**Rrjeti i shpërndarjes** është i ndërtuar me tuba dhe rekorderi të cilat respektojnë normat dhe kushtet teknike për impiantin e mbrojtjen kundër zjarrit. Rrjeti i shpërndarjes është furnizuar nga një linjë kryesore që vjen nga grapi i presurizimit në zonen teknike, dhe shpërndahet vertikalisht në kollonat e hidraneve. Në godinë do të ngrihen kollonat që do të furnizojne me ujë hidrantët të pozicionuar nëpër kate, ne pozicione te përcaktuara per te mbuluar te gjithë sipërfaqen nga zjarri. Gjatë projektit është marrë parasysh që rrjeti i tubacioneve të ketë minimumin e numrit të përkuljeve dhe të kthesave të detyrueshme. Gjithashtu janë marrë parasysh zgjidhjet konstruktive të godinës. Tubat janë të pozicionuar dhe të siguruar për të minimizuar dëmtimet dhe vibrimet.

**Linjat e rrjetit** të shpërndarjes janë ndërtuar me tub çeliku të zi pa tegel (Manessman) me bashkim me saldim(ose fileto), me rakorderi (kurba, tee,) gjithashtu me bashkim me saldim (ose fileto), të trajtuar në sipërfaqe me pastrimin e ndryshkut dhe vajrave, të lyera me bojë antindryshk dhe bojë të kuqe RAL 3000 sipas normave. Fiksimi i tyre bëhet me fasheta sipas normave në distanca të përcaktuara, ne kalimet horizontale çdo 10D, në kalimet vertikale çdo 15D.

## 7.10 Hidrantët

**Hidrantët e zjarrit të tipit kasetë me ujë** janë përgjedhur si pajisje fikëse në sistemin e shuarjes së zjarrit për **klasën A**. Ata janë llogaritur të kenë në dispozicion të tërë sasinë e ujit të nevojshëm në rastin e shfaqjes së zjarrit. Kjo është bërë e mundur gjatë hartimit të projektit të instalimit të hidraneve në brendësi dhe jashtë godinës. Ata janë instaluar në çdo kat në brendësi të godinës dhe janë lehtësish të evidentueshme, praktikë për tu përdorur në rastet e shfaqjes së zjarrit.



**Hidrantet DN 45** janë të përbërë prej saraçineskës ndërprerëse, tubit të gomuar për kalimim e ujit me një gjatësi prej 30 m si dhe hundëza. Të gjitha këto pajisje janë të vendosura në boksin prej llamarine çeliku, të lyer me bojë të kuqe RAL 3000 të pjekur, i cili vendoset në brendësi të murit ose jashtë tij (sipas zgjidhjes në projekt) dhe në një lartësi 110 cm nga dyshemeja sipas normave. Ata janë të shoqëruar me kartelat e sinjalistikës përkatëse, me butonin e alarmit.

### 7.11 Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot

Pajisjet e lëvizshme të shuarjes së zjarrit

- Bombola portative me gaz CO<sub>2</sub>, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, E**.
- Bombola karrelato me pluhur, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, C, E**.

**Fikëse me CO<sub>2</sub>** përdoren për mbrojtjen në rast zjarri pikërisht për karakteristikat mbytëse të këtij gazi dhe variojnë nga 2 deri në 5 kg. Mbi flakën ky lloj shuarësi ushtron një efekt freskues dhe mbytës. Ky tip shuarësi përmbanë CO<sub>2</sub> në formë likuide dhe jo të gaztë të presurizuar. Në momentin e funksionimit një valvol lëshon CO<sub>2</sub> që ndodhet në fikës i cili arrin në një difuzor i cili e shpërndan në temperaturë -70 °C nën formën e një reje karbonike ose akulli të thatë. Cilësia kryesore e fikësve me CO<sub>2</sub> është se ky gaz nuk shkakton asnje veprim korroziv dhe nuk lë pasoja pas përdorimit, nuk ndot dhe në përgjithësi ruan objektet nga dëmtimi. Këto bombula me gaz CO<sub>2</sub> janë aplikuar në ambientet e brendshme të godinës së konviktit, të pozicionuara sipas projektit.

**Fikset me pluhur** janë pajisje që përdoren në rast zjarri, të cilët zakonisht janë të adoptuar për të gjitha tipet e zjarrit - kjo shpjegon edhe arsyen se përsë keto pajisje i gjemë pothuajse në çdo ambient. Pluhuri është një material solid i ngjashëm me pudrën. Për ta bërë sa më funksionale kapacitetin e tyre fikës supozohet që mesatarisht një fikë prej 6 kg pluhur është në gjëndje që të shuajë rreth 200 litra substancë likuide të djegshme, e cila mund të jetë benzinë ose alkol dhe është e aftë të fikë edhe zjarre me origjinë gazi. E meta e tyre e vetme që kufizon përdorimin e tyre është në efektet anësore të pas shuarjes së zjarrit. Përdorimi i fikësve me pluhur për të shuar zjarrin mbi një kompjuter apo kuadër elektrik apo cfarëdolloj aparature tjeter elektrike mund të shkaktojë dëme të pariprueshme të pajisjes elektrike. Këto bombula me pluhur janë aplikuar në ambientet teknike në kapacitete 6 kg dhe 50 kg karrelato për përdorim portativ, të pozicionuara sipas projektit.



## 7.12 Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave

Kanalet e ventilimit dhe të kondicionimit, grilat dhe materiali i kanaleve të ajrit, tubat hidraulik, kanalinat elektrike të cilat përshkojnë muret horizontalisht nga njëri ambient në tjetrin, ose përshkojnë soletat apo dyshemetë vertikalish ngjëri kat në tjetrin duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mbrojtjes kundra zjarrit. Per kete qellim nëpërmjet masave të mos përhapjes së zjarrit dhe tymrave, kontrollin dhe evakuimit të këtyre të fundit, jane vendosur dampera kundra zjarrit, dampera tymi, qafore vetshuarese, jastek vetshuares, stuko dhe materiale të tjera vetë shuarëse të cilat janë përcaktuar saktësisht në projektet e impianteve përkatëse.

## 7.13 Sinjalistika

Një element shumë i rëndësishëm është shoqërimi i të gjitha pajisjeve shuarëse, rrugëve të kalimit e të shpëtimit, me sinjalistikat përkatëse sipas normave me ndriçim normal dhe me ndriçim emergjencë. Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit janë parashikuar një numer tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si :

- Tabela paralajmëruese - janë tabelat që tregojnë ndalimin e ndezjes së zjarreve, ndalimit të përdorimit të ujit për shuarje etj.
- **Tabela treguese** - sic janë drejtimet e daljes nëpër korridore, nëpër shkalle, vendosja e hidranave dhe të bombolave etj.
- **Tabelat vepruese-sinjalizimi** nëpërmjet butonit të alarmit, ndërprerja e energjisë elektrike etj.



## 8 SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45

### 8.1 Gjendja Aktuale

Ne ambjentet e godines sistemi i monitorimit me kamera mungon. Duke qene se do te riorganizohen hapesirat e ambjenteve egzistuese, infrastruktura e re e rrjetit te internetit duhet te jete e pershtatshme konform ketyre ndryshimeve.

### 8.2 Pershtatja e Ambjentit

Per nje rritje te cilesise se sherbimeve eshte kerkuar te implementohet rrjeti kompjuterik sipas funksionit te percaktuar te ambienteve.

Gjithashtu eshte parashikuar vendosja e sistemit te monitorimit te kamerave ne te gjithe ambjentet qe shihet e nevojshme.

### 8.3 Sistemi TV

Ne kete sistem eshte parashikuar qe te kete TV ne cdo dhome shtrimi si dhe tek hollet dhe recepcioni. Sistemi TV do te jete vetem UHF me nje antene qendrore ne tarrace dhe me amplifikator qendror qe do te jete ne dhomen teknike. Shprendarja do te kryhet me ane te shperndaresave kalimtar dhe fundor me 4,6,8 dalje ku daljet qe nuk do te perdoren do te mbyllen me rezistenca fundore. Kablli I perdonur per sinjalin TV duhet te jete kabell koaksial 75ohm.

### 8.4 Sistemi CCTV

Sistemi CCTV do te kete funksion monitorimin dhe ruajtjen e pamjeve filmike per arsyte sigurie. Sistemi CCTV do te jete IP me kamera IP POE (Power Over Ethernet) te vendosura ne pikat e konsideruara te nevojshme te monitorohen si korridore, hyrje godine, hyrje ne ambjente kati, recepcion, holl etj. Gjithmone pa cenuar privatesine e personelit, nxenesve ose personave te tjere. Ne keto ambjente duhen vendosur tabela paralajmeruese qe i behet e ditur qe keto ambjente survejohen me kamera.

Per te gjithe objektin do te vendoset nje NVR qe do te jete ne Rack ne katin 0 ku do te mblidhen te gjithe kabllot qe do te lidhen ne nje switch me 24 porta PoE 10/100 si dhe me 2 porta Uplink. Ne perzgjdhjen e switchit duhet pasur kujdes qe fuqia e portave individuale



te mbaj cdo kamer si dhe ne fuqi totale. Duhet pasur kujdes gjate instalimit qe linjat te mos i kalojne 100m sepse ka problem me PoE si dhe me transmetimin e te dhenave. Me NVR do te lidhet nje monitor qe ti ofroj mundesine personelit te autorizuar te menaxhoj dhe te kontrolloj kamerat ne cdo moment qe do i nevojite. Ne NVR do te instalohen harddisqe HDD per te ruajtur regjistrimet qe do te realizojne keto kamera.

Jane parashikuar per tu perdorur dy tipe kameresh ku per ambientet e brendshme do te jene kamera Dome per tu instaluar ne tavanin e varur ndersa per ne ambientet e jashtme kamera Bullet te cilet do te vendosen ne fasaden e objektit ne lartesi per te monitoruar ambientet hyrese ne objekt. Kamerat duhet te jene me minimumi 5Mpx me lente varifocale nga 2.4 - 12 mm, me regjistrim deri ne 25fps si dhe me infrared IR per te regjistruar naten ose kur ne ambjente eshte erresire.

#### Minimumi I kerkesave te NVR

- Furnizimi 100-240Vac
- Montimi rackmounted per tu montuar ne Rack
- Regjistrimi deri ne 12MP
- Kompresimi I regjistrimit H265+
- Mundesi lidhje deri 4 SATA konektor per HDD deri ne 8TB
- Kontroll regjistrimi smart me filtra sipas eventeve
- Dalje Video : 2 porta HDMI, VGA
- Dalje Audio : RCA
- Temperaturë pune : -10°C deri ne +55°C
- Kontakte te pastra si hyrje ose si dalje te konfigurueshem
- Mundesi lidhje me tastiere dhe maus per komandimin e saj
- Port USB per eksportimin e regjistimeve ne rast evenetes

#### Minimumi I kerkesave per te dy tipet e kamerave:

- Furnizimi : PoE
- Lente: 2.8 - 12mm
- Rezelucion : 720, 1080, HD, Full HD
- Tipi I Lentes : varifocale
- Te kene : IR LED deri ne 30m
- Regjistrimi ne ndricim te ulet : 0.03lux me ngjyra
- Detektim levizje dhe alarmi



- Temperature pune : -20°C deri ne +60°C
- Kompresimin e videos : H265, H265+, MJPEG
- Numri I fps : deri ne 25fps
- Te jene : OnVif
- Te supertoje : microSD
- Shkalla mbrojtjes : IP66, IK10
- Certifikimi CE

*PERGATIUR NGA:*

**BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k**



## RAPORTI TEKNIK



### ***OBJEKTI:***

### ***PROJEKTI PER TRANSFORMIMIN E INFRASTRUKTURES AKOMODUESE NE KAMPUSIN RAJONAL TE ARSIMIT PROFESIONAL, BASHKIA VLORE***

POROSITES:

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

PROJEKTUES:

**BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k**

**2024**



## PERMBAJTJA

<b>1 INFORMACION I PERGJITHSHEM</b> .....	5
<b>1.1 Pershkrimi i pergjithshem</b> .....	5
<b>1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm</b> .....	6
<b>1.1.2 Objektiva Specifike</b> .....	7
<b>1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale</b> .....	8
<b>1.2.2 Strategja e ndërhyrjes</b> .....	16
<b>1.2.3 Punimet civile</b> .....	16
<b>1.2.4 Gjendja Faktike</b> .....	17
<b>2 ARKITEKTURA</b> .....	18
<b>2.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	18
<b>2.2 Pershtatja</b> .....	18
<b>2.3 Organizimi funksional</b> .....	19
<b>2.4 Koncepti i design në fasadë dhe materialet</b> .....	21
<b>3 KONSTRUKSIONI</b> .....	24
<b>3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit</b> .....	24
<b>4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE</b> .....	25
<b>4.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	25
<b>4.2 Pershtatja</b> .....	25
<b>4.3 Rezerva ujore</b> .....	26
<b>4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitair</b> .....	26
<b>4.4.1 Grupi i presurizimit</b> .....	26
<b>4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitair</b> .....	27
<b>4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitair</b> .....	27
<b>4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitair</b> .....	27
<b>4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijshem</b> .....	29
<b>4.5 Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura</b> .....	29



4.5.1	Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare .....	30
4.5.2	Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit .....	30
4.5.3	Kalimet horizontale, pusetat primare.....	30
4.5.4	Rrjeti i jashtëm i shkarkimit .....	31
4.5.5	Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujerave te ndotura .....	31
4.5.6	Tubacionet e shkarkimit te ujrave te ndotura.....	32
4.5.7	Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrave te ndotura .....	33
4.5.8	Tubat e ajrimit .....	33
4.6	Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut .....	34
4.6.1	Rrjeti i kullimit të ujrave te tarracave.....	34
4.6.2	Kolonat e shkarkimit të ujrave të shiut.....	35
4.6.3	Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrave sipërfaqësor .....	35
4.6.4	Sistemimi i ujerave te shiut .....	35
5	ELEKTRIKET .....	37
5.1	Gjendja Ekzistuese .....	37
5.2	Pershtatja.....	37
5.3	Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjise dhe shfrytezimit: .....	38
5.4	Furnizimi me energji elektrike .....	39
5.5	Sistemi i shperndarjes .....	39
5.6	Fuqia .....	39
5.7	Ndricimi .....	40
5.8	Sistemi detektimit te zjarrit .....	41
5.9	Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit .....	42
5.10	Normat Ligjet dhe rregullat .....	43
6	KONDICIONIMI DHE VENTILIMI I AMBIENTIT .....	44
6.1	Gjendja Ekzistuese .....	44
6.2	Pershtatja e Ambjentit.....	44



6.3	Të Përgjithshme .....	44
6.4	Rregullat dhe normat e projektimit .....	45
6.5	Kriteret e Projektimit .....	45
6.6	Perllogaritjet e Sistemit .....	46
6.7	Perzgjedhja e sistemit dhe funksionimi i tij .....	49
7	<b>MBROJTJA KUNDER ZJARRIT .....</b>	56
7.1	Gjendja Aktuale .....	57
7.2	Pershtatja e Ambienteve .....	57
7.3	Kritere të përgjithshme projektuese .....	58
7.4	Klasifikimi i klasave të zjarrit .....	58
7.5	Sistemi i shuarjes me ujë – me hidrantë .....	59
7.6	Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative .....	59
7.7	Rezerva ujore .....	60
7.8	Grupi i presurizimit .....	60
7.9	Rrjeti shpërndarës .....	61
7.10	Hidrantët .....	61
7.11	Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot .....	62
7.12	Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave .....	63
7.13	Sinjalistika .....	63
8	<b>SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45 .....</b>	64
8.1	Gjendja Aktuale .....	64
8.2	Pershtatja e Ambjentit .....	64
8.3	Sistemi TV .....	64
8.4	Sistemi CCTV .....	64



## 1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

**Emertimi i Projektit:** "Projekti per Transformimin e Infrastruktures Akomoduese ne Kampusin Rajonal te Arsimit Profesional, Bashkia Vlore".

**Vendodhja:** Bulevardi Ismail Qemali -perballe Kendit te lojerave "Aulona Park", Vlore

### 1.1 Pershkrimi i pergjithshem

Konviki eshte ndertim i viteve 1970 me nje njolle ndertimi ne forme drejtekendore prej 600 m<sup>2</sup> e organizuar ne 3 kate dhe mbulimi i saj me cati me tjequll.

Godina e konviktit ndodhet e pozicionuar ne territorin e Shkolles se Mesme Industriale e pozicionuar ne oborrin e pasem te saj.

Dhomat e studenteve jane kryesisht me dimensione (300x450) me 2 krevate kryesisht dhe nuk kane tualete brenda tyre. Ne godine ushtrojne aktivitetin e tyre dhe 2 Rajone te Bashkise Vlore ( Rajoni 2 dhe Rajoni 3) qe ndermjet nje shkalle metalike te vendosur ne pjesen e pasme te godines ne anen e majte kane akses per te hyre ne ambjentet qe perdonin per zyra brenda ketij konvikti.

Ky konvikt ka salla per te sherbyer per nxenesit si sall studimi / tv etj por qe aktualisht jane jashte funksionit te tyre.

Gjendja e tij paraqitet shume e amortizuar, ka prezence lageshtire jashte dhe brenda tij si dhe ne ambjentet e perbashketa si dhe ne dhomat e studenteve. Tualetet qe jane ne godine jane te amortizuara, pajisje hidrosanitare te thyera, rubineta te demtuar apo dushe jane jashte funksionit. Pllakat jane bere me disa lloje dhe nga vetnxenesit e shkolles.



### 1.1.1 Objktivi i Përgjithshëm

Objekt i detyres sone te projektimit eshte projekti teknik per rikonstruksionin e kesaj godine trekatëshe nepermjet vleresimit Tekniko- Ekonomik te objektit dhe evidentimin e nderhyrjeve te nevojshme per krijimin e ambienteve me standarte bashkekohore akomoduese. Sipas planit te rikonstruksionit te godines, me financim nga buxheti i shtetit, eshte parashikuar nje rikonstruksion i ambienteve duke e kthyer ne ambiente te pershtatshme me nje funksionim normal dhe dinjitoz dhe me standardet me te mira nderkombetare per kete tip godine.

Shërbimet që përfshin ky projekt janë:

- Riorganizimi funksional i godinës ekzistuese me qëllim optimizimin e shfrytëzimit të hapësirave të brendshme
- Përmirësimi i infrastrukturës Akomoduese ne Kampisin Rajonal te Arsimit Profesional
- Rikonstruksion dhe rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen



Përzgjedhja e projekteve dhe e impianteve mekanike eshte bazuar në aplikimin dhe projektimin e sistemeve përkatëse me një efikasitet maksimal për të realizuar zgjidhje bashkohore teknike mbi bazë të normave dhe kushteve teknike europiane, me vlera minimale të kostove të investimit mbi bazë të fondeve në dispozicion, si dhe në respekt të kërkesave te parashtruara te termave te referencës ne detyrën e projektimit.

Në vijim, në mënyrë të përbledhur përshkruajmë kriteret të cilat janë marrë parasysh gjatë projekt idese si referencë esenciale për kualifikimin e zgjidhjeve impiantistike mekanike:

- Respektim i normave teknike
- Komfort sherbimi,
- Besueshmëri funksionale,
- Inspektueshmëri,
- Higjenë dhe siguri,
- Parcializim përdorimi,
- Kosto te ulet energjistik perdonimi,
- Kosto të ulët të investimit fillestar,
- Kosto të ulët të mirëmbajtjes,
- Standartizim të komponentëve impiantistikë,
- Respektim maksimal të kushteve ekologjike dhe mjedisore.

Në përgjithësi mund të themi që projektet mekanike janë mbështetur konform normave respektive europiane.

Ne hartimin e projekteve te impianteve mekanike, jemi mbështetur gjithashtu ne baze te Kategorizimit te këtij objekti, mbi baze te Strukturës te parashikuara ne Detyrën e Projektimit, mbi baze te Konstatimeve dhe vlerësimeve te gjendjes egzistuese te impianteve Mekanike dhe mbi baze te Propozimeve te zgjidhjeve Arkitektonike dhe Konstruktive.

### **1.1.2 Objektiva Specifike**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi dhe rinovimi i godinës ekzistuese të konviktit Vlore.

Me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e kushteve akomoduese, struktura ekzistuese do t'i nënshistrohet:

- rikonstrukcionit total



Sa më sipër, do të bëhet studimi dhe vlerësimi i ndërtesës ekzistuese si dhe hartimi i projekteve arkitektonike dhe inxhinierike; përllogaritja e kostove; raportet teknike.

### **1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale**

Me poshte po japim disa foto te gjendjes aktuale te cilat jane realizuar gjate verifikimeve ne objekt.





**F&M**  
ingegneria


**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE






**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE







**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE







**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





### 1.2.2 Strategjia e ndërhyrjes

Bazuar në Detyrën e Projektimit ku sqarohen në vija të përgjithshme nevojat e konviktit, si dhe referuar Standardeve të Projektimit të objekteve akomoduese, është hartuar një projekt i cili përbledh në vetvete gjithë elementët e nevojshëm që bëjnë të mundur përdorimin dhe menaxhimin sa më eficient të objektit.

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivave, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tërësor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin i kushteve akomoduese

### 1.2.3 Punimet civile

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tërësor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardë e projektimit dhe ndërtimit të jenë konform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines nuk do te ndryshojne fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines,



por thjesht nje rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambjenteve të brendshme dhe të fasadës
- Heqja totale e catise dhe rikonstruksion i thellë i tarracës
- System i ri elektrik, mekanik, hidraulik, etj

#### **1.2.4 Gjendja Faktike**

Gjendja e pergjithshme e objektit, shfaqet e amortizuar ne kohe. Vihet re presencia e vazhdueshme e lageshtise, mungon totalisht instalimet e sistemit MKZ, Instalimet e sistemeve te ngrohjes me kaldaje paraqiten te amortizuara dhe te vjeteruara me kohen po ashtu edhe instalimet elektrike dhe hidraulike etj.

#### **Ndërhyrje.**

Pas studimit që i është bërë detyrës së projektimit, kemi konkluduar se hapat kryesore që nevojiten të ndërmerren për ndërhyrje, në aspektin e përmirësimit dhe shfrytezimit të hapësirave janë:

1. Te permiresohen ndjeshem kushtet e sherbimit ne ambjentet e Godines akomoduese;
2. Te rinvohen te gjitha sistemet teknike te godines si Instalimet Elektrike, Instalimet Hidraulike, HVAC, MNZ, etj sipas standardeve europiane per taktyer ne nje objekt bashkekohor dhe te denje per funksionin qe ka;
3. Te gjitha funksionet qe kryhen ne kete godine do te mbulohen perseri ne te njeften gjurme;
4. Ndërhyrje në sistemimet e jashtme të objektit, etj



## 2 ARKITEKTURA

### 2.1 Gjendja Ekzistuese

Konviki i Shkolles se mesme industriale “Pavarsia” Vlore (Vajza -Djem) , Vlore, aktualisht ambientet shfrytezohen pjesërisht si konvikt për djemtë dhe vajzat dhe pjesërisht si zyra provizore në funksion të Bashkisë dhe disa Njësive Administrative (kati i pare teknik) aksesimi i te cileve behet nepermjet shkalleve te jashtme provizore metalike. Ai ka formë të rregullt drejtkëndëshe me sipërfaqe totale gjurmë prej rrith 600 m<sup>2</sup>.

**Rifiniturat**\_Rifiniturat e brendshme dhe të jashtmë të godinës shfaqen në nivel të lartë amortizimi të ardhura këto jo vetëm për shkak të amortizimit fizik natyror që pësojnë strukturat dhe materialet por dhe për shkak të projekteve të meparshme në nivele jo-optimale si në nivel projektues ashtu dhe zbatues në përdorimin e materialeve dhe instalimeve teknike dhe detajeve konstruktive. Sa më sipër, bazuar në inspektimin në vend problemet me evidente janë:

- Kushte jo të mira të mbështjellës së ndërtesës (fasadës). Përvec amortizimit evident ajo shfaq dhe nivel te lartë lagështie.
- Mungesë izolimi termik si në muret perimetral të cilat janë mure tulle që nuk janë pajisur me shtresa termike, ashtu dhe në vetrata të cilat nuk kanë veti termike dhe krijujnë që humbjet e energjise te janë të larta.
- Gjithashtu përreth godinës terreni është i pasistemuar dhe nuk kanë një funksion të mirëfilltë me qëllim shfrytezimin e tyre si hapësira recreative.
- Shtrimet e dyshemeve janë bërë me pllaka gres porcelanat te cilat janë amortizuar me kalimin e kohes.
- Instalimet hidraulike, elektrike, mekanike paraqiten të amortizuara.
- Amortizim i suvasë në zona të caktuara; amortizimi I dyerive, dritareve etj.

### 2.2 Pershtatja

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivëve, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tërësor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e ambjenteve akomoduese

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tërësor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardizuar e projektimit dhe ndërtimit të janë konform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines nuk do te ndryshojnë fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines,



por thjesht një rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambjenteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion i thellë i tarracës
- Përmirësimi i sistemimeve të jashtme
- System I ri elektrik, mekanik, hidraulik, HVAC etj


### 2.3 Organizimi funksional

Zgjidhja e organizimit funksional bazohet në Detyrën e Projektimit të përcaktuar si dhe në Standarde të ndryshme të projektimit. Është bërë një studim i gjërë i tyre me qëllim arrijen e plotësimit të nevojave si për nxenesit dhe stafin.


Me qëllim arrijen e objektivit për një funksionalitet të mirë si në ndarjet e hapësirave ashtu dhe në lidhjet mes tyre, ndërhyrja bazohet në elementin kryesore qe eshte ndërhyja minimale në muraturën ekzistuese dhe riorganizim i hapësirave.



Kati përdhe – Planimetria e propozuar




Kati I Pare – Planimetria e propozuar





Kati I Dyte – Planimetria e propozuar



## 2.4 Koncepti i design në fasadë dhe materialet

Në lidhje me konceptin e fasadës është propozuar një rikonceptim duke ruajtur ritmin e dritareve ekzistuese dhe realizimin e kornizave dekorative ne disa prej dritareve te objektit. I gjithë perimetri I fasadave do të vishet me system kapotë me qëllim termoizolimin dhe rritjen e eficiencës së energjisë. Edhe dritaret dhe vetrata do të jenë prej duroalumini me veti të larta termike.

Me qëllim evitimin e një monotonie të vazhduar nga fillimi e deri në fund i fasades, janë propozuar korniza dekorative ne disa prej dritareve te objektit, por me dendësi dhe shpeshtësi të ndryshme nga njëri segment në tjetrin.

Ngjyrat e fasadave i propozojmë neutrale, në tonalitetet të ndryshme të bezhes ndërkokë që kornizat e dritareve do te kene ngyre kafe te erret ndersa hyrjet ne objekt ne tonalitetet e ngjyres se kuqe duke krijuar ne kete menyre një design qe bën që të përftojmë një fasadë dinamike dhe njëkohësisht bëjmë të mundur që fasada, sikurse dhe pjesa e brendshme, të vijnë në nivelet e arkitekturës bashkëkohore.

Lidhur me materialet që do të përdoren, muret perimetrale do të jenë të sistemit ‘kapot’. Mbulimi i objektit do të jetë me soletë dhe shtresat përkatëse.



**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





### 3 KONSTRUKSIONI

#### 3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit

Objektit në fjalë përfshin një godinë civile ku tre kat mbi toke, në elementet strukturorë të së cilës nuk do të ketë ndërhyrje.

Struktura e objektit eshte e nderthurur me konstruksion b/a te tipit tra - kollon dhe mure mbajtes.

Themeli i strukturës është themel i vazhduar dhe plinta b/a.

Ne te gjitha nderhyrjet (prishje dhe ndertim muresh, etj) qe parashikohen te behen ne kete objekt jane marre parasysh te gjitha kerkesat e kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit ne fuqi.

Pas verifikimit vizual, ne objekt nuk verehen demtime te struktires mbajtese te tij dhe per kete arsyе nuk eshte pare e nevojshme te nderhyet apo te paraqiten plane/detaje te nderhyrjes..

Gjithsesi, gjate fazes se pergatitjes se projektit te zbatimit te objektit te behen investigime me te thelluara te struktires mbajtese te tij ne menyre qe te kihet nje panorama me e qarte ne lidhje me nevojen per marrjen e masave perfocuese te saj.



## 4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE

### 4.1 Gjendja Ekzistuese

Gjendja aktuale e sistemit te ujesellesit dhe te kanalizimeve paraqitet mjaft i amortizuar. Sipas verifikimit ne terren te gjendjes aktuale eshte vene re dukshem demtimi i tualeteve ne dysheme, amortizim i sistemit te furnizimit me uje dhe te shkarkimit te ujerave te ndotura duke ulur ne kete menyre per funksionalitetin e tyre.

Gjithashtu ka demtime te konsiderueshme ne rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujrale te shiut. Vlen per tu theksuar demtimi i ulluqeve i cili ka sjelle edhe demtimin e fasades nga depertimi i lageshtires ne periudhe dimri.

### 4.2 Pershtatja

Ne projektimin e rrjetit te ujesellesit dhe te kanalizimeve eshte marre ne konsiderate rrjeti ekzistues i godines. Projekti hidroteknik i eshte permbajtur kerkesave te autoritetit. Pas vizitave te vazhdueshme ne objekt nga ana e projektuesve jane pare opsione te ndryshme zgjidhjesh dhe me pas eshte arritur ne nje zgjidhje perfundimtare te sistemit hidroteknik.

Do te nderhyet ne rrjetin e ujesellesit dhe ate te shkarkimit te ujrale te ndotura ku eshte menduar te ndertohet me materiale bashkekohore dhe ne perputhje me standartet ne fuqi. Rikonstuksioni do te perfshije instalimet hidroteknike (sistemin e furnizimit me uje dhe shkarkimin e ujerave te ndotura) brenda godines. Per rrjetin e jashtem te kanalizimeve ne projekt do te perfshihet pjesa nga dalja e kolones kryesore te shkarkimeve deri te bashkimi te puseta me e afert. Lidhur me pusetat do te behet rikonstruksion I shkarkimeve dhe mbulimi i pusetave do te behet me kapake prej gize te gatshem.

Materialet qe do perdoren per rrjetin e ujesellesit jane perzgjedhur per te perballuar prurjet dhe presionet llogaritese.

Cdo pajisje do te kompletobet me rubineta filter ne hyrje te ujit ngrohte dhe atij te ftohte. Tubat e furnizimit me uje do te jene PP-R per presion 16Atm dhe PEX-AL. Ndersa tubat e shkarkimeve do te projektohen me material te cilesise se pare dhe me gomine ne zgjatim, po keshtu me gomine dhe te gjitha rakorderite. Eshte percaktuar pika e shkarkimit te ujerave te perdorura jashtë objektit dhe lidhjen me rrjetin ekzistues K.U.Z.

Implanti i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë dhe nevojat për ujë teknik për pajisjet mekanike të impianteve të ndryshme. Nevojat e përgjithshme për ujë pavarësisht përdorimit dhe përpunimit të tij, sigurohen nga centrali teknik i cili përbahet nga rezerva e ujit dhe nga impiantet përkatëse



të pompimit dhe të shpërndarjes. Përvec kësaj në rezervën e ujit për përdorim sanitari sigurohet edhe rezerva e ujit për nevojat e impiantit të mbrojtjes nga zjarri.

#### **4.3 Rezerva ujore**

**Furnizimi me ujë për nevojat hidrosanitare** parashikon nevojat e ujit të ftohtë dhe nevojat për ujë te ngrohtë. Rezerva e përgjithshme e ujit për nevojat hidrosanitare, sipas normave parashikohet te sigurohen per nevoja te konsumit 24 ore, pavaresisht furnizimit te vazhdueshëm me uje nga rrjeti i qytetit .

**Furnizimi me ujë për nevoja teknike** parashikon nevojat për furnizimin e të gjithë paisjeve sanitare me uje te ngrohte, gjithashtu për nevojat e impiantit të ngrohje/ftohje te kondicionimit.

**Në total rezerva e kërkuar e ujit për të tre përdorimet** e mësipërme është rezerva ujore per përdorim sanitari per 24 orë.

#### **4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitari**

**Sistemi i furnizimit me ujë hidrosanitar** përbëhet nga :

- a) grapi i presurizimit
- b) rrjeti i shpërndarjes

##### **4.4.1 Grupi i presurizimit**

**Grupi** është i përbërë nga pompat kryesore elektrike e ushqyer si nga rrjeti normal elektrik dhe nga rrjeti i emergjencës dhe aksesorët impiantistike përkatës, për të garantuar prurjen dhe presionin e rrjetit të konsumatorëve. Pompat janë të kontrolluara nga një kuadër elektrik te pavarur, me lexim të lehtë të instrumentave të sinjalizimit. Pompat janë pajisur më kolektorët e thithjes dhe dërgimit, që janë të galvanizuar me veshje shtrese epoxidi. Ato kanë në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvola ndërprerëse, valvol moskthimi, si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollolli, si presostatët e presionit etj. Grupi i presurizimit është konform normave të standartizuara europiane.



#### 4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar

Rrjeti i shpërndarjes është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i presurizimit deri në konsumatorë nëpërmjet një rrjeti të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit në dhomen teknike, nëpërmjet kalimit te tyre gjate koridorit dhe furnizon kollonat kryesore të shpërndarje në godinë, nga të cilat dalin degëzimet magjistrale për çdo kat. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi për një sektorë të caktuar të pajisura me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjera. Sistemi i tubave të ujit sanitari plotëson të gjitha kërkesat e normave dhe standardeve të përcaktuara, në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Furnizimi ne cdo tualet eshte parashikuar te behet me sistem shpërndarje me kolektorë. Kështu nepermjet këtij sistemi sigurojmë funksion me te mire te furnizimit me uje te paisjeve sanitare, si dhe lehtësi dhe shpejtësi ne riparimin e defekteve /ose mirëmbajtjen e tyre.

#### 4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitar

Sistemi i ujit te ngrohte do te behet me bolier 15 liter dhe 80 liter dhe perbehet nga prodhuesi i energjise termike, tubat e shperndarjes dhe pajisjet perkatese te dhenies se energjise termike.

Me kerkese te supervizorit mund te perdoren tuba PPR dhe PEX-AL qe jane konform standartave te mesiperme per cilesine dhe testimin e tyre per presionin dhe rezistencen ndaj temperaturave te larta.

Tubat per furnizimin me uje te ngrohte duhet te sigurojne rezistence termike ndaj temperaturave te larta, deri ne 100 grade celsius, korrozionit, agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

#### 4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitar

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit te ftohte/ngrohte sanitare ne objekt eshte realizuar duke marre ne konsiderate skemen e shperndarjes, prurjen nominale per çdo aparat hidrosanitar, prurjen totale nominale, njekohshmerine e perdorimit te pajisjeve hidrosanitare, presionin e punës, humbjet gjatesore dhe lokale te presionit si dhe shpejtesine maksimale te rekomanduar te qarkullimit te ujit.



Vete nevojat per uje sanitar jane llogaritur bazuar ne normen europiane EN-806-3 e cila merr ne konsiderate prurjen totale maksimale te kerkuar (Qta dhe Qtb) bazuar ne numrin e aparateve hidrosanitare dhe prurjen nominale per çdo aparat hidro/sanitar. Per aparatet ne te cilen parashikohet uji i ngrohte dhe i ftohte eshte konsideruar prurja e nevojshme e nje fluksi te vetem.

Prurja e projektit Gpr bazuar ne normen EN 806-3 eshte llogaritur e diferencuar bazuar ne tipologjine e objektit dhe pikerisht:

Gta (l/sec)	1.1	1.5	2	2.6	3.2	3.6	4.1	4.5	5.1	6.1	7.2	8.1	9	10.1	11.2	12.2	15.2
Gpr	0.5	0.7	0.8	0.9	1	1.1	1.2	1.2	1.3	1.4	1.5	1.6	1.7	1.8	1.9	2	2.2

Tubat qe do te perdoren per furnizimin me uje te ftohte do te jene PPR, PN 16bar dhe PEX-AL .

Diametrat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te pijshem dhe shpejtesise se levizjes. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret ne intervalt 0,8-1,4 m/sek. Gjatesia e tubave eshte 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem te tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj, duhet te jepen te stampuara ne çdo tub. Tubat e furnizimit me uje duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe kerkojne uje te pijshem. Ato instalohen brenda ne mur. Ne rast se gjatesia e shtrirjes se tyre eshte e madhe duhet te vendosen kompesatore te tipit me brryl te thjeshte ose tip omega. Bazuar ne prurjen e projektit, diametri i linjave te furnizimit me uje eshte llogaritur mbi bazen e formules:  $Qpr = 0,785 \times D^2 \times V$

ku  $V$  = eshte shpejtesia e lejuar e levizjes se ujit ne tubacione.

Kjo shpejtesi, per tubacionet e furnizimit me uje sanitari eshte pranuar:

Diametri tubacionit	DN 25	DN32	DN50	DN63
Shpejtesia max (m/sec)	1,1	1,3	1,9	2,1



#### 4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijsphem

Per sistemin e furnizimit me uje te ndertesës, meqenëse do të perdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderite perkatese duhet të jene PPR të cilat plotesojnë kërkesat e cilesise sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilesine dhe testimin). Rakorderite që perdoren në këto linja janë:

- Brrylat te thjeshte me 45 grade dhe 90 grade
- Brryla me fileto metalike te tipit femer dhe mashkull;
- Tridegeshat te thjeshte dhe me fileto;
- Katerdegesha (Kryqe)
- Bashkues te thjeshte
- Bashkues me fileto metalike tip femer dhe tip mashkull;
- Reduksionet e ndryshme;
- Rakorderi tip hollandez; etj

Rakorderite që do të perdoren për furnizimin me uje duhet të sigurojnë rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence të larte ndaj agjenteve kimike, peshe të lehte, mundesi të thjeshta riparimi e transporti, ngjiturje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

Diametri dhe spesori duhet t'i pershtaten tubave perkatese dhe të jene sipas te dhenave dhe kushteve teknike. Spesori i rakorderive duhet të jetë i tillë që të perballojë 1,5 here te presionit te punës se tubave.

#### 4.5 Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura

**Implanti i shkarkimit të ujërave të zeza** shërben përmblledhjen e shkarkimeve të godines. Ky rrjet është një rrjet i veçantë nga rrjetet e tjera të shkarkimeve si rrjeti i shkarkimeve te ujrave te shiut dhe te impiantit te kondicionimit.

Implanti i shkarkimit të ujërave të zeza do të jetë i përbërë nga :

- a) rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të ambienteve sanitare,
- b) kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit,
- c) kalimet horizontale, pusetat primare me pompat e ngritjes,
- d) rrjeti i jashtëm i ujrave të zeza



#### 4.5.1 Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare

**Rrjeti i brendshëm** i shkarkimit të nyjeve sanitare është i përbërë nga tubacione plastik horizontale të cilat mbledhin të gjitha shkarkimet e pajisjeve për tu shkarkuar ne kolonën vertikale të shkarkimit. Diametri dhe gjatësia e tubave është e tillë që të sigurojnë rrjedhjen normale të ujrale të zeza në kolonat e shkarkimit.

Për shkarkimet e ujërave të zeza janë përdorur tuba dhe rakorderi sipas normave dhe standardeve. Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave mekanike dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### 4.5.2 Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit

**Kolonat vertikale** të shkarkimit dhe balancimit gjithashtu shërbejnë për mbledhjen e shkarkimeve të nyjeve sanitare. Ato shoqërohen së bashku me kolonat e balancimit të cilat bëjnë të mundur balancimi e ajrit gjatë shkarkimit të ujrale në kolonat kryesore. Kolonat e shkarkimit kanë dalje në pjesën e sipërme të tyre në tarracë dhe/ose ne fasadat e godinës, ndërsa në fundin e tyre ato bashkohen në kolektorët deri në derdhjen në pusetat primare te rrjetit te jashtem.

Si kolonat e shkarkimit ashtu edhe magjistralet në të cilën janë parashikuar diametrat e tubacioneve dhe pjerrësitë e tyre rigorozisht sipas normave të projektimit. Lidhja e tyre bëhet me anë të bragave  $45^\circ$  në mënyre që shkarkimi të bëhet sa më i lehtësuar duke lejuar qarkullimin e ajrit nëpër tubin e shkarkimit të nyjës sanitare gjë e cila mund të minimizojë qarkullimin e ajrit dhe të rrisë nivelin e zhurmave gjate shkarkimit. Këto kolona të brendshme janë të gjitha të lidhura me kollonen për shfryrjen dhe ballancimin e presioneve të gjithe rrjetit, pasi mblidhen, dalin jashtë godinës arrijnë në rrjetin e pusetave.

Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### 4.5.3 Kalimet horizontale, pusetat primare.

**Kolektorët dhe kalimet horizontal** shkarkojnë në pusetat primare të rrjetit e jashtëm.



Meqenëse shkarkimet e godinës deri në katin nëntokë rezultojnë në kuotën e rrjetit të jashtëm të ujrave të zeza nuk është e nevojshme që të përdoren pusetat. Shkarkimet e tyre behen me gravitet me rrjedhje te lire.

**Pusetat primare** mbledhin ujrat ne rrjetin pranë godinave dhe me pas rrjeti i tyre lidhet dhe shkarkon ne rrjetin urban te zonës ose te qytetit.

#### 4.5.4 Rrjeti i jashtëm i shkarkimit

**Rrjeti i jashtëm** i grumbullimit te ujërave të zeza eshte parashikuar i përbërë nga pusetat primare të tipit mbledhëse me konstruksion betoni të papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize me permasë Ø60 si dhe tubacionet të dimensionuara sipas normave teknike të projektimit. Pusetat e ujërave të zeza janë në forme katrore me thellësi jo më pak se 90 cm. Përmasat janë duke filluar nga 60x60 cm dhe dimensionohen ne baze te kërkesave te projektit. Tubacionet e rrjetit të jashtëm të shkarkimeve rrjeti i jashtëm i shkarkimeve janë tuba polietilen i rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të zeza të vendosura në çdo pikë ndërprerjeje ose kontrolli të rrjetit të jashtëm të shkarkimit. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### 4.5.5 Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura

Sistemi i shkarkimeve te ujrave te ndotura behet me gravitet. Sistemi eshte dimensionuar ne menyre te tille qe ujrat e shkarkuara te mos okupojne te gjithe seksionin e tubacioneve te shkarkimit. Sasia e ujrave te shkarkuara (ne njesi shkarkimi US) eshte llogaritur duke konsideruar aparatet hidrosanitare te kategorise 3. Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve te sistemit te shkarkimit te ujrave te ndotura eshte bere duke marre ne konsiderate:

- skemen e shperndarjes dhe shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S;
- fluksion nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- shpejtesise se qarkullimit dhe pjerresise se tyre etj.

Per shkarkimet e ujrave do te perdoren tuba plastike PP3 qe plotesojne te gjitha kërkesat e cilesise sipas standardit ISO 4427 dhe prEN 12201. Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj ajenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitur te thjeshte dhe te shpejte. Permasat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, shpejtesise se levizjes dhe shkalles



se mbushjes se tyre. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes duhet te jete 0,5 - 0,8 e seksionit te tubit.

Per objektin tone per kanalizimin e ujerave te brendshme do te perdoren tubat PP3 me diametra DN50, DN75, DN110 dhe DN125.

Tubacionet e shkarkimit te ujerave te ndotura qe do te dalin nga godina do te perdoren te tipit HDPE i brinjezuar SN4 DN 125. Dalja e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura nga godina do te behet duke u lidhur me puseten me te afert.

#### **4.5.6 Tubacionet e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per shkarkimin te ujrave te ndotura jane perdorur tuba prej PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normativa UNI 7613.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Diametri i tubave eshte percaktuar ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosura.

Kollonat vertikale te shkarkimit do te pajiset me pika kontrolli. Instaluesi duhet te vendose nje numer te xhuntove ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit te tubacioneve.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh me ane te tubave te dergimit. Tubat e dergimit do te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Per te pakesuar numrin e kollonave duhet qe pajisjet sanitare te grupohen dhe te vendosen njeri mbi tjetrin nga katër ne nderkat te nderteses. Diametri i kollonave te shkarkimit merret i njejtë per te gjithe lartesine e nderteses dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madhi i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Nuk lejohet perdorimi i tubave te shkarkimit me diameter me te vogel se 50 mm. Bashkimet e tubave te shkarkimit duhet te behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Provat hidraulike behen me presion prove 25% me te larte se presioni i punes. Ato behen per te pare qendrueshmerine e rrjetit, si dhe rrjedhjet e mundshme qe mund te ndodhin ne tabacione.



#### **4.5.7 Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do te perdoren rakorderite perkatese me material PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normatives UNI 8452.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

Provati i shkarkimit do te realizohen ne perputhje me normen UNI 7615.

Permasat (diametri) e tyre do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, llojut te pajisjeve sanitare, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrate te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0,5-0,8 e sekcionit te tubit. Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dheneve. Te dhena mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi. Rakorderite e bashkimit te tubave duhet te montohen ne te gjithe vendet ku behet bashkimi me tubat e dergimit te ujrave te ndotura. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit, duhet te behet me tridegeshe te pjerreta ose brryla te thjeshte nen nje kend 45 ose 60 grade. Rakorderite e bashkimit duhet te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur. Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre. Bashkimet e rakorderive me tubat e shkarkimit, behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

#### **4.5.8 Tubat e ajrimit**

Tubat e ajrimit jane zgjatim ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit dhe duhet te nxirren 70 - 100 cm me lart se pjesa e siperme e çatise ose tarraces se nderteses. Ato duhet te sherbejne per ajrimin e rrjetit te brendshem dhe te jashtem te kanalizimeve. Ky ajrim eshte i domosdoshem sepse me ane te tij behet e mundur largimi i gazrave te krijuara ne kollonat e shkarkimit si dhe i avujve te ndryshem qe jane te demshem per jeten e banoreve.



Gjithashtu, Tubat e ajrimit do te sherbejne per te bashkuar kollonat e kanalizimeve me atmosferen per te menjanuar nderprerjen e punes se sifoneve ne pajisjet hidrosanitare. Tubat e ajrimit duhet te kene diametrin e brendshem njelloj me diamterin e kollones se shkarkimit. Diametri i tubit te ajrimit duhet te jete DN110 mm. Materialet qe perdoren per keto tuba duhet te jene rezistent ndaj korrozionit, agjenteve atmosferike, gazrave te ndryshem qe dalin nga kollonat e shkarkimit. Ne maje te tubave te ajrimit duhet te vendoset nje kapuç, i cili pengon hyrjen ne tub te ujrade te shiut dhe debores si dhe permireson ajrimin e kollones se shkarkimit. Nje grup aparatesh mund te kene dy tuba ajrimi. Tubat e ajrimit duhet te montohen me kujdes ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit ne menyre qe te mos shkeputen ose te demtohen nga ererat e forta qe mund te fryjne. Ato montohen ne pozicion vertikal. Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

#### **4.6 Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut**

**Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut** është ndërtuar i veçante nga rrjetet e tjera të shkarkimeve dhe shërbën për të mbledhur ujrat sipërfaqesor të shiut nga tarracat si dhe nga ujrat sipërfaqësor të sheshit.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të shiut do të përbëhet nga :

- a) rrjeti i kullimit të tarracave.
- b) kolonat vertikale të shiut (kolektorët e shkarkimit të shiut)
- c) rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrade sipërfaqësor .

##### **4.6.1 Rrjeti i kullimit të ujrade te tarracave**

Rrjeti i kullimit te ujërave të tarracës eshte parashikuar me pileta shiu, kollonat si dhe kolektorët që mbledhin ujrat e shiut nga tarracat dhe shkarkojnë drejt rrjetit të jashtëm të ujrade të shiut. Për shkak të konfigurimit të godinës në relacion me kuotën 0.00 të sheshit dhe rrjetit egzistues të jashtëm të mbledhjes së ujrade të shiut rezulton që të gjitha kollonat e godinës mbasi zbresin poshtë dyshemesë së katit përdhe mund të shkarkojnë lirshëm në rrjetin e jashtëm.



Te gjitha kollonat e shkarkimit plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas normave të projektimit, duke filluar nga piletat, kolonat, deri tek kalimet horizontale dhe kolektorët që përfundojnë në rrjetet respektive.

#### **4.6.2 Kolonat e shkarkimit të ujrave të shiut**

**Kolonat vertikale e shkarkimit të ujërave të shiut** shërbejnë për të shkarkuar ujin e shiut nga piletat ose ullukët deri në nivelin e kolektorëve të ujërave të shiut ose deri në rrjetin e jashtëm të shkarkimeve të ujërave të shiut. Dimensioni i tyre është bërë duke marrë parasysh kapacitetin e ujit në rastin e periudhave të shirave. Gjatë projektimit, janë marrë parasysh kushtet hidro-metrologjike dhe sasitë e reshjeve, në zonën ne studim. Mbi bazë të këtyre të dhënave, çdo kollonë mbledh ujrat e jo më shumë se 150 m<sup>2</sup> sipërfaqe tarrace dhe secila prej kollonave është parashikuar me diametër jo me të vogel se 110 mm. Kollonat janë parashikuar të ndërtohen me material metalike , me të gjitha lidhjet me bashkim nëpërmjet të cilave sigurohet funksionim normal i shkarkimeve, mosrrjedhje të ujrave, qëndrueshmëri në kohë të tyre, janë rezistent ndaj korrozionit, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, minimizimin e zhurmave gjatë shkarkimit si dhe eleminimin e kondensave sidomos në përiudhën e dimrit, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### **4.6.3 Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrave sipërfaqësor**

Rrjeti i jashtëm i shkarkimit të ujërave të shiut pasi mbledh të gjithë shkarkimet nga kolektorët e shkarkimit të ujërave të shiut shkarkon në rrjetin e qytetit. Për grumbullimin e ujërave të shiut janë parashikuar puseta të tipit mbledhëse me konstruksion betoni te papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize grile me përmasa 60x40 cm. Të çarat me kapakun prej grile janë nga 25 deri 35 mm për te ndaluar plehrat si dhe për te mundësuar kullimin e ujërave. Pusetat e ujërave të shiut janë në forme katrore me thellësi jo me pak se 90-100 cm me përmasa 40x40 cm. Tubacionet e rrjetit të jashtëm janë tuba polietilen të rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të shiut. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### **4.6.4 Sistemimi i ujerave te shiut**

Largimi i ujerave atmosferike (d.m.th. i ujerave te shiut e te debores se shkrire) eshte menduar te kryhet me ane te nje sistemi ujerash ne drejtim te kasetave te shkarkimit te



ujerave te shiut. Ne teresi sistemi i largimit te ujerave atmosferike perbehet nga: ulluqe qe mbledhin ujerat ne tarrace, prej hinkave ujembledhese, kolonave te shkarkimit dhe pusetave te kontrollit.

Ulluqet duhet te sigurojne largimin e plote e te shpejte te ujerave te shiut e te debores si dhe reren, pluhurin qe mund te bien mbi tarrace.

Lidhja e hinkave me muret e fasades duhet te behet e tille qe te mos lejoje ne asnje menyre lagien e mureve te objektit. Uji eshte menduar te mblidhet ne ulluk dhe nepermjet hinkave te lidhet me kolonat e shkarkimit. Nje hinke mund te mbledhe ujerat nga nje siperfaqe prej 250-350 m<sup>2</sup>.

Referuar kushteve te projektimit rezulton se per objektin, hinkat dhe kolonat e shkarkimit (kolonat vertikale) do te vendosen ne skajet e objektit dhe ne qender si dhe ne drejtimin gjatesor te tij.

Ne kete menyre behet nje largim i shpejte dhe i panderprere te ujerave te ulluqeve e te kunetave te mbuleses se objektit si dhe per te mbajtur papastertite e ndryshme qe mund te bllokojne tubat. Tubat duhet te kene diameter jo me te vogel se ai i vete hinkes. Kunetat do te jene te mbuluara me zgare metalike.

Ujerat e shiut mbidhen ne nje pike dhe me pas me nje pjerresi prej 2 % ato largozen ne drejtim te kunetes kryesore te drenazhimit.



## 5 ELEKTRIKET

I gjithe sistemi elektrik duhet te jete i tille qe te stakohet ne nje pike te vetme ne katin perkates, e cila mund te arrihet lehte dhe te kete shenjat dalluese perkatese. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqise duhet te jete e afishuar ne panelin e stakimit.

Ndriçimi i emergjences duhet te futet automatikisht ne pune dhe te kete nje kohe pune te pakten 1 ore ne rast se stakohet tensioni.

Tipologja impiantistike qe aplikohet eshte e tille qe siguron qendrueshmeri te sistemit, parametra normale te kushteve te punes si dhe eficence ne kursimin e energjise.

Projekti parashikon furnizimin me energji elektrike dhe instalimin e sistemeve per ambjentet e objektit per te 3 katet. Llogaritjet elektrike jane realizuar ne baze te fuqive te pajisjeve mekanike te dhena nga projektuesi i sistemeve mekanike, fuqite e makinerive dhe pajisjeve te dhena nga invizitor i pjesa perberese e procesit te prodhimit si dhe eshte parashikuar fuqia per ambientet teknike dhe te sherbimeveve.

### 5.1 Gjendja Ekzistuese

Objekti ka kabine Elektrike e cila vleresohej persa i perket kapacitetit te tij ne lidhje me kerkesat e fuqise se sistemit te ngrohjes dhe paisjeve te tjera qe vendosen. Dhe ne varesi te gjendjes se tyre (kapacitetit) dhe ne varesi te fuqise se instaluar te nevojshme te percaktuar, percaktohet dhe varianti me ekonomik per ushqimin e tyre me energji elektrike

### 5.2 Pershtatja

Ne keto ambiente mendohet te implementohet ngrohje qendrore dhe projektuesi duhet te marre ne konsiderate te gjitha kerkesat elektrike per nje funksionim normal.

Per sa i perket paisjeve te tjera, secila paisje , ka skemen elektrike perkatese ku percaktohet dhe fuqia e nevojshme. Ne varesi te skemes, fuqise dhe pozicionit ku do vendosen paisjet, jane percaktuar gjatesite, tipet dhe llojet e kabllove qe do te sherbejne per funksionim normal te ketyre paisjeve. Gjithashtu ne baze te vleresimit te sistemet elektrik ekzistues dhe ne baze te nevojave qe paraqesin keto aparatura, behet e mundur perzgjedha e variantit me ekonomik.

Gjithashtu ndricimi ekzistues ne keto ambiente nuk eshte i pershtatshemEshte bere vleresimi nga projektuesit per gjendjen ekzistuese dhe eshte peshtatur me ndricim me intensitet te mjaftueshem, ekonomik dhe cilesor (sugjerojme ndricimin Led).



### 5.3 Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjise dhe shfrytezimit:

Sistemi i Tokezimit:

- Sistemi TN-S

Tensioni nominal Punes ( $U_e$ ) :

- 400 V (F/F)
- 230 V (F/N)

Tensioni nominal Izolimit ( $U_i$ )

- $\geq 690$  V

Tensioni nominal i impulseve ( $U_{imp}$ ) qe durojne pajisjet e tensionit te ulet :

- 24 kV

Tensioni testues i pajisjeve te tensionit te ulet:

- 1 min. 50 Hz 3500 V

Frekuenca :

- 50 Hz

Sherbimi nominal :

- I panderprere

Renja e tensionit midis burimit dhe ngarkeses

- Maksimumi 4% ne AC (nga klemat e daljes se transformatorit te ngarkesa me e larget)

Madhesia e kabllit te neutrit :

- ne sekcion te njejtë me ate te fazes per seksione deri ne 16 mm<sup>2</sup>.
- Sa  $\frac{1}{2}$  e sekzionit te fazes per seksione me te medha se 16 mm<sup>2</sup>.
- ne sekcion te njejtë me ate te fazes ne rast furnizimi te pajisjeve qe shkaktoje harmonika (PC, servera, motora).

Kufizimet e Zhurmes:

- Ne perputhje me ligjet dhe normat lokale



#### 5.4 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do te realizohet nga kabina ekzistuese qe eshte afer objektit. Ne panelin kryesor do te kryhet edhe komutimi i furnizimit rrjet-gjenerator dhe nga ky panel ne panelin e kuadrit kryesor do te vi linja me gjenerator nga ku e gjithe godina do te jete e furnizuar me gjenerator, pervec pajisjeve HVAC te cilat furnizohen direkt nga rrjeti..

#### 5.5 Sistemi i shperndarjes

Nderlidhja e kateve realizohet me ane te shaftit vertikal qe do te realizohet ne dhomen teknike. Furnizimi nga panelet ne ngarkesen fundore realizohet me tub fleksibel plastik te tipit dhe dimensioneve te ndryshme. Gjate fazes se zbatimit duhet pasur kujdes qe te behet nje kordinim i sakte per hapsirat e nevojshme per pozicionin perfundimtar te saj. Gjate instalimit duhen perdorur te gjithe materialet e duhura.

#### 5.6 Fuqia

Percjellesat dhe kabllot plotesojne kerkesa te larta per tipin e izolimit, mbeshtjelljes, dhe percjellesve te specifikuar. Kabllot e ushqimit te tensionit te ulet per sistemin e shperndarjes 400/230V duhet te jene konform me sistemet EN dhe TNC/S. Tipi izolimit duhet te jete rezistent ndaj lageshtires dhe nxehesise, i pershtatshem per temperature pune maksimale deri ne 70 grade celcius. Kabllot duhet te jene nje cope pa lidhje mes tyre pervec rasteve kur distancat jane me te medha se gjatesia maksimale e kabllit.

Te gjithe percjellesit te perdorur ne instalimet elektrike jane prej bakri.

Percjellesat dhe Kabllot qe do te perdoren gjate instalimeve elektrike do te jene te GENERAL CAVI ne konforme te standardeve CEI, IEC, CEI UNEL.

Sekcionet minimale te percjellesve: te gjitha prizat 2.5mm<sup>2</sup>/ instalimet e brendshme te ndriçimit 1.5mm<sup>2</sup>, 400V/230V,

Kodi me ngjyra:

- Faze: E zeze,gri, kafe (kabllot)
- Faze: E zeze (telat)
- Neutri: Blu e lehte
- Tokezimi mbrojtës: Verdhe/jeshile (shirita)

Te gjithe kabllot do te etiketohen sipas skemave te paneleve te shperndarjes me numrin e qarqeve te tyre. Nese kabllot ose tubat jane instaluar per nje perdonim te mevonshem ose per te kursyer hapesiren kjo duhet treguar ne etiketim. I njejti informacion do te shenohet ne te dyja anet e kabllove dhe kutive.



Etikimi realizohetedhe tek kuadrat dhe tek panelet per cdo automat per te treguar se kujt destinacioni ose linje i perket ai. Kjo behet per te lehtesuar punen personelit te mirembajtjes ne manovrimin e tyre dhe per te pikasur lehte avarite e mundshme.

### 5.7 Ndricimi

Ndricimi i ambienteve eshte projektuar qe te plotesoje kerkesat fotometrike te ambienteve sipas funksionit te tyre. Ndricimi do te realizohet ne pjesen me te madhe te objektit me ndricues 60x60 LED 4000K te cilet plotesojne kushtet tekniko-ekonomike lm/W dhe me llojet e ndricueseve te propozuar ne projekt. Keto ndricues do te jene inkaso per montim ne tavan te varur me pllaka 60x60. Ne tualete do te jene spote rrethor inkaso LED 23cm. Ne tualete e perbashketa komandimi i ndricimit do te realizohet me ane te detektoreve te levizjeve ne ambiente.

Ne instalimin e ndricimit te brendshem duhet pasur parasysh ruajtja e uniformitetit ne nivelin mbi 0.4.

#### Ndricues LED 60x60 Inkaso

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit : 3400lm,
- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Montimi : inkaso
- Shkalla e mbrojtjes : IP40, IK02
- Karkasa: metalike
- Mbulesa optike : pexiglas opal
- Temperatura pune: nga -10°C deri +40°C
- CRI : 80+
- Eficiencia: >90lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

#### Spot Inkaso 13W

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit 1100lm



- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Eficencia : >80lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

Ndricimi antipanik do te jete i shperndare ne korridore per te bere nje mbulim per ndricim te nevojshem gjate momenteve qe nuk ka energji ne objekt . Ndricuesit do te jene LED me nje autonomi minimale prej 3 oresh.

Ndricimi Exit eshte vendosur ne rruget e kalimit per te treguar rrujen me te shkurter te daljes dhe ne bashkveprim me sistemin e zjarrit qe ne rast evakuimi te tregoje daljet nga portat e emergjences. Keto ndricues do te kompozohen me etiketat perkatese qe tregojne rrujen e kalimit ne rast evakuimi si dhe tek dyert dalese do te jene mbi dyer me etiketen EXIT. Ndricuesit Exit duhet te jene LED me autonomi deri ne tre ore.

#### Ndricuesit e Emergjencave

- Ndricues LED
- Bateri NiCd
- Autonomi 3h
- Koha karikimit 12h
- Certifikimi : CE
- Shkalla mbrojtjes IP42
- Me tregues gjendje karikimi llamp LED jeshil-kuq

#### **5.8 Sistemi detektimit te zjarrit**

Sistemi i detektimit te zjarrit duhet te jete ne perputhje me kerkesat e standartit EN 54-13, standarte vendase ose standarte te tjera ekuivalente. Sistemi duhet te kryeje keto funksione: detektimin automatik te zjarrit, procesimin dhe ruajtjen e informacioneve te marra nga sensoret, sinjalizimin ne menyre efektive akustike dhe vizuale, mundesine e dhenies se alarmit ne menyre manuale nga pika te aksesueshme ne rrujen e evakuimit dhe detektim dhe sinjalizim i shpejte i defekteve te vete sistemit.

Sistemi i zjarrit do te jete i adresueshem dhe i ndare ne tre loop-e me sistem bus per marrjen e te dhenave dhe furnizimin nepermjet tij te sensoreve. Furnizimi i pajisjeve me rele eshte parashikuar te realizohet me vete me ane te ushqyesave vetjak. Loop-et jane ndare ne tre zona ku cdo kat do te jete nje zone.



Sensoret e detektimit do te jene per detektim tysi per sensoret qe do te instalohen poshte tavanit te varur si dhe sensore nxehesie per ato qe do te instalohen brenda tavanit te varur. Per sensoret qe do jene brenda tavanit te varur duhet te vendosen sinjalizues LED ne drejtim te tyre poshte tavanit qe te tregojne ne menyre vizuale nqs kane vepruar ato sensore apo jo.

Butonat e dhenies se alarmit te zjarrit jane vendosur ne rruget e kalimit te evakuimit ne bashkeveprim me sinjalistiken e ndricimit exit, dhe duke respektuar largesite maksimale 45 m qe nje person duhet te kaloje qe te arrije nje pike thirrje te kerkuara nga normat.

Sirenat e brendshme me sinjalistike akustike dhe vizuale vendosen ne menyre te tille qe niveli i kerkuar i tingullit te jete me i madh se 65 dB dhe te pakten 5 dB mbi nivelin e tingullit te ambientit.

Paneli i detektimit i zjarrit do te jete i vendosur ne dhomen teknike ne katin 0 duhet te jete I pajsur me nje monitor LED ku te afishoje te gjithe eventet si dhe te lehtesoje sa me shume perdorimin e tij per personelin mirembajtes.

Per sistemin e detektimit te zjarrit te referohen vizatimet e projektit.

#### Centrali I kundrazjarrit

- I adresueshem
- Montim ne mur
- Kompletuar me display LED me ngjyra
- Me menu interaktive me mundesi perzgjedhje ne disa gjuhe (anglisht, italisht etj)
- Modular me mundesi zgjerimi modulesh minimumi me 3 module LSN per 3 LOOP-e
- I pajisur me modul kontrolli baterish per karikimin dhe per te kontrollu gjendjen e tyre
- Certifikimi VDS
- Database per regjistrimin deri ne 10000 evenete
- Port Ethernet per nderlidhje me kompjuter, BMS etj

#### 5.9 Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit

Sistemi i mbrojtjes ndaj shkarkimeve atmosferike do te realizohet me tokezim natyral duke shrytezuar zbritjet vertikale qe do te mbyllen me nje perimetral gjate gjithe objektit per te realizuar shkarkimin e rrimes si rezultat nga goditjet e rrufeve. Ndertohet nje sistem perimetral me percjelles te zhveshur bakri qe do jete ne nje thellesi minimale 0.5m me qellim



zvogelimin e tensioni te hapit. Ne impiantin e tokes duhet te lidhen armaturat metalike te nderteses, tubacionet metalike te hyrjes per ujin, gazin, etj... Duke qene se sistemi i furnizimit me energji elektrike eshte 10/ 20 kV, tokezimi i mbrojtjes do te jete i njejte me tokezimin e punes. Pra buloni i nulit te trafos do te lidhet me percjellesin e tokes . Nese nuk realizohet vlefta e rezistences se tokes  $R \leq 4 \Omega$ , me numrin e elektrodave te paraqitura ne projekt, atehere duhet te realizohet tokezim artificial, duke perpunuar vendin ku do te behet tokezimi. Sistemi i rrufepritesit ne tarrace do te ndertohet me shtiza rrufepritesit te projektuar per te mbuluar zonen e godines referuar vizatimit perkates. Shtizat e rrufepritesit do te ngrihen nga tarraca 1.5m ne menyre qe te kemi nje mbulim sa me te gjere. Duhet pasur parasysh qe te tokezohen te gjithe paisjet dhe elementet metalik qe ndodhen ne tarrace (paisjet HVAC) per ti mbrojtur nga goditjet direkte ose indirekte.

### **5.10    Normat Ligjet dhe rregullat**

Karakteristikat e pajisjeve, komponenteve dhe materialet e nevojshme për të përfunduar punimet, duhet te jenë në përputhje me karakteristikat e treguara ne kete dokument, duke respektuar ligjet, rregulloret dhe normativat (CEE, UNI, EN, ISO, INAIL, CEI).

Të gjitha pajisjet, komponentët, materialet duhet te jene te reja dhe me cilësine më të mirë në treg, te produara dhe përpunuara nga një profesionist i përshtatshem. Te jenë të destinuara per sherbim dhe karakteristikat e performancës se kerkuar të jene te larta.

Të gjitha materialet dhe furnizimet të jene te pajisura mundësisht me shenjën e cilësisë në përputhje me UNI EN ISO 9001 dhe / ose produkte të certifikuara nga organizata, dhe , ndonëse të dobishme, kanë CE shënuar sipas Direktivave te KE 392/89, të ndryshuar, dhe të jenë në përputhje me dispozitat e dekretit legjislativ Nr 81/2008 në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të vendosura nga Direktiva.



## 6 KONDICIONIMI DHE VENTILIMI I AMBIENTIT

Godina në praktikë përbën një ndërtesë që klasifikohet e tipit Ndërtesë Publike dhe është vlerësuar sipas disa faktorëve specifike që lidhen me funksionimin e saj.

Për sa i përket Klimatizimit (Ngrohjes dhe Ftohjes) së kësaj ndertese, elementët teknike të vlerësimit janë:

- (I) Çfarë ofron Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar
- (II) Vlerësimi i ngarkesave termike
- (III) Skema e zgjedhur

### 6.1 Gjendja Ekzistuese

Ne ambientet aktuale te godines nuk ka sistem qendoror ngrohje dhe ftohje por ambientet aktuale jane te paisura me kondicionere te cilet nuk kane rendimentin e duhur.

### 6.2 Pershtatja e Ambjentit

Ne keto ambjete te cilat do riorganizohen duhet te sigurohen kushtet e nevojshme per ngrohje ftohje te ambjentit. Pra projektuesi ka vleresuar gjendjen aktuale dhe ka percaktuar masat e nevojshme per te siguruar nje funksion normal te ketyre ambjenteve pershtatur me funksionin qe do kene. Eshte menduar sistem ngrohje ftohje qendrore per gjithe ambientet.

### 6.3 Të Përgjithshme

Sistemi i ajrit të kondicionuar përbehet nga:

- ❖ Pajisjet kryesore të sistemit; Njësit e jashtme të sistemit e përshtatshme për lidhje VRV, Njësite e brendshme kanalore/kasete VRF.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve te ajrit të freskët, rikuperatoret me gjithë komponentët, grilat dhe difuzoret, tubat fleksibel dhe aksesoret e montimit.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve të gazit ftohës/ngrohës me gjithë komponentët dhe aksesoret e montimit.
- ❖ Rrjeti i tubacioneve të kondensave me gjithë komponentët dhe aksesoret e montimit.



#### 6.4 Rregullat dhe normat e projektimit

Per projektimin jane ndjekur rregullat e normat e me poshtme:

- ❖ EN Standard , ISO standard .EN ISO 13790:2008 (Përllogaritja e ngarkesës ngrohëse dhe ftohëse për kondicionimin e ndërtesave)
- ❖ ASHRAE standard 55a-95 (Temperaturat dhe Lagështia relative për mjediset e populluara)
- ❖ EN Standard , ISO standard .EN ISO 15242:2007 (Kriteret e ventilimit ne godina, ndikimi ne llogaritjet termike)
- ❖ ASHRAE standard 62.1-2013 (Ventilimi ne lidhje me kualitetin e ajrit)
- ❖ ASTM C1071-12 (Term izolimi dhe izolimi akustik për kanalet e ajrit)

**a- KRITERET E PROJEKTIMIT**

**b- PERLLOGARITJET E SISTEMIT**

**c- PERZGJEDHJA E SISTEMIT DHE FUNKSIONIMI I TIJ**

#### 6.5 Kriteret e Projektimit

Vendndodhja : Vlore

Objekti i projektimi është i vendosur në qytetin e Vlores, për të cilin kushte e joshmë projektuese janë përcaktuar si me poshtë:

- ❖ Temperatura e joshmë llogaritëse për stinën e ftohte  $-5^{\circ}\text{C}$  , lagështia relative 79%.
- ❖ Temperatura e joshmë llogaritëse për stinën e ngrohte  $+38^{\circ}\text{C}$ , lagështia relative 52%.

Nisur nga destinacioni i godinës, për kushtet e brendshme do të merret në konsiderate:

**1. Për stinën e ftohte**

Temperatura për ambiente e brendshme dhomat e vizitave, laboratorët e analizave dhe sallës së venetëve, do të jetë  $22^{\circ}\text{C}$ .



## 2. Për stinën e ngrohte

Për ambiente e brendshme dhomat e vizitave, laboratorët e analizave dhe sallës së venetëve, do të jetë  $24^{\circ}\text{C}$ .

Për të krijuar një ambient sa me komod, sipas kërkesave të investitorit për çdo ambientin është parashikuar sistemi i ventilimit me rikuperim të energjisë. Në përllogaritjen e volumeve për çdo ambient është marre në konsiderate kërkesa për ajër në baze të konsumatorëve. Për çdo person është parashikuar një sasi ajri e freskët sipas standardit përkatës.

### 6.6 Perllogaritjet e Sistemit

#### 1- Ngarkesa Ngrohëse

Janë llogaritur humbjet me transmetim të godinës dhe ato për ventilimin.

Humbjet me transmetim:

$$Q_T = S * u * D_t$$

$Q$  - humbjet e nxehësisë

$S$  - sipërfaqe e joshmë e objektit (mure, dritare, solete, dysheme)

$u$  - koeficienti i humbjeve të nxehësisë, varësi e materialeve të përdorura

$D_t$ - diferenca e temperaturës jashtë -brenda

Temperaturat :

Temperatura e jashtme llogaritëse për Vloren është marre  $-5^{\circ}\text{C}$

Temperatura brenda objektit në varësi të ambienteve siç është treguar me lart.

Koeficientet e humbjeve janë marre:

- |  |                                 |
|--|---------------------------------|
| - Mure të jashtëm të objektit të term izoluar sistemi kapote | $u = 0.6 \text{ w/m}^2\text{K}$ |
| - Dritare duralumini me ndarje termike dopioxham             | $u = 1.5 \text{ w/m}^2\text{K}$ |
| - Dysheme / soleta beton i armuar                            | $u = 1.4 \text{ w/m}^2\text{K}$ |
| - Llogaritje rriten me 10% për efekt të urave termike        |                                 |

Humbjet në rrezatim :



Llogaritja e humbjeve ne rrezatim është marre 300 W / m<sup>2</sup> xham.

Humbej ne ventilim :

$$Q_V = V * r * D_t$$

Q - humbjet e nxehësisë

V - Volumi i ajrit ventilues

r - koeficienti i nxehësisë specifike te arit 0.34 w / m<sup>3</sup>°K

D<sub>t</sub>- diferenca e temperaturës jashtë - brenda

Ngarkesa e përgjithshme:

$$Q = Q_T + Q_V$$

Kësaj ngarkese i zbriten:

Nxehësia e gjëndëruar nga ndriçimi, punonjësit dhe aparaturat shtese të çdo ambienti.

Sasia e nxehësisë e gjenerura për efekt të ndriçimit është marre 10w / m<sup>2</sup>

Sasia e nxehësisë e gjeneruar nga punonjësit është marre 120 w / person

Sasia e nxehësisë e prodhuar nga aparurat është marre 250 w / kompjuter

## 2- Ngarkesa ftohëse:

Ngarkesa ftohëse llogaritet ne transmetim, humbje ne ventilim dhe rrezatim .

Llogaritja e humbjeve me transmetim dhe ventilim behet njësoj si ngarkesa ngrohëse. Temperatura e jashtme llogaritëse është marre për Vlore 38°C . Nxehësia e gjeneruar nga ndriçimi, punonjësit dhe aparaturat shtese të çdo ambienti do ti shtohen kësaj ngarkese.

Në humbjet me rrezatim janë marre në konsiderate sipërfaqet e xhamit:

$$Q = S * K$$

Q - humbjet e nxehësisë

S - sipërfaqja e hapësirës që rrezatohet



K - koeficienti i rrezatimit për orën e pikut që varet nga lloji i xhamit dhe mbulimin me grila e perde. Në këtë rast K është marre  $300\text{W/m}^2$

Sipërfaqet vertikale të mureve nuk merren në konsiderate për humbjet me rrezatim .

Sipërfaqet horizontale (soleta) llogariten me të njëjtën formule si humbjet me transmetim:

$$Q_T = S * u * Dt$$

Q - humbjet e nxehësisë

S - sipërfaqe e jashtme e objektit ( mure, dritare, solete, dysheme)

u - koeficienti i humbjeve të nxehësisë , varësi e materialeve të përdorura

Dt- diferenca e relative temperaturës jashtë - brenda

Diferenca e temperaturës është relative pasi ajo merret parasysh jo si temperature e ajrit të jashtëm por si temperature e sipërfaqes së rrezatuar në këtë rast Dt është marre  $26^\circ\text{C}$  Brenda  $24^\circ\text{C}$  dhe sip. e soletës  $50^\circ\text{C}$

### 3- Ventilimi

Ventilimi i godinës është bere me njësi të ndare për çdo ambient me vete. Sasia e ajrit ventilues është përllogaritur me  $40 \text{ m}^3/\text{h}$  për person.

Dimensionet tubacion janë llogaritur me formulën :

$$S = Q / v$$

S - seksioni i tubacionit

Q - sasia e ajrit ventilues

v - shpejtësia e lëvizjes së ajrit në tubacione

Shpejtësia e lëvizjes së ajrit në tubacione është marre :

Në elementin fundor  $1,5 \text{ m/s}$

Në degët e tubacionit  $2,5 \div 4 \text{ m/s}$

Në magjistral brenda godinës  $5 \div 6 \text{ m/s}$



Në magjistral jashtë godinës

8 m/s

## 6.7 Perzgjedhja e sistemit dhe funksionimi i tij

Për përballimin e humbjeve të gjeneruara projekt i është ndare në dy sisteme.

1. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes me njësi fundore për çdo ambient në varësi të tij , të tipi kasete/kanalore, i përshtatshëm për lidhje VRF e që do të përballojë humbjet me transmetim, dhe
2. Futja e ajrit të freskët të trajtuar që merr parasysh humbjet me ventilim.

Sistemi i pare parashikohet të punoje gjate stinës së ftohte për ngrohje, nga tetori deri në prill, dhe për ftohje nga qershori deri në shtator.

Në rekomandojmë një sistem VRF , për disa arsyet: rendiment me të mire (kosto me e ulet shfrytëzimi), menaxhim me i thjeshtë në kontrollin e punës së njësive, parcializim me i madh në varësi të kërkesës së impiantit.

Sistemi i dyte do të punoje gjate gjithë vitit. Ai do të kompensoje me ajër të freskët ambientet e ventiliuara dhe do të rregullojë temperaturën e brendshme për periudhat e ndërmjetme dhe gjate gjithë vitit për ambientin e tjera.

Ambientet do të kenë kontroll të veçantë të temperaturës në baze të kërkesës së secilit ambient.

Njësite fundore të ngrohje-ftohje janë vendosur të tipit kanalore në përshtatje me arkitekturën për seclin ambient por duke ruajtur në mënyrë rigorozë kërkesat e ambienteve për nivelin e zhurmave, si dhe kriteret teknike të montimit dhe mirëmbajtjes.

Duhet të përmbajnë minimalisht, por jo të kufizuara deri këtu, sa me poshtë përshkruar:

- Kasa prej llamarine të galvanizuar e term izoluar në varësi të tipit edhe e myllura me mantelin prej material plastic në varësi të modelit të prodhuesit.
- Ventilator të tipit centrifugal me tre shpejtësi të rregullueshme + shpejtësinë automatike.
- Filtër ajri të tipi rrjete i zmontueshëm që mund të lahet me ujë të rrjedhshëm dhe të rivendoset.



- Skedën elektronike dhe pultin e kontrollit për përcaktimin dhe monitorimin e regjimit te punës. Regjimet e punës do të jene: ftohje, ngrohje, ventilim, heqje lagështie etj.
- Pompën për largimin e kondenses e komanduar nga një galexhant niveli për punim automatik .
- Lidhja me rrjetin me rakorde.

Suportet, varëset dhe gjithë elementet e tjera ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar. Ato duhet te garantojnë pajisjen nga vibrimet për të shmangur zhurmat në ambiente. Niveli i zhurmave i pranueshëm 40dB.

Njësitë e jashtme të kondicionimit duhet të përmbajnë minimalisht, por jo te kufizuara deri këtu , sa me poshtë përshkruar:

Kompresori i tipit Digital Scroll Inverter bashke me rezistencën për ngrohje të vajit.

Bateria kondensuese/avulluese e tipit gaz-ajër të ndërtuar nga serpentine me tuba bakri dhe radiator me flete te holla alumini.

Qarku i fluidit punues duhet të përmbajë valvol për mbushje me gaz, filtër gazi, tregues presioni në hyrje dhe dalje nga kompresori, ndërprerës së punës në rast mbi dhe nën presioni, tregues fluksi, valvol me katër rrule elektrike, valvol ekspansioni.

Ventilator aksial me grille mbrojtëse me shpejtësi të rregullueshme sipas kërkesës së fluidit punues. Motori i ventilatorit duhet të jete i tipit të mbyllur pa nevoje për lubrififikim të mëvonshëm.

Skeda elektronike e cila do të rregulloje dhe monitoroje regjimin e punës, si dhe komunikimin me njësite e brendshme. Ajo duhet të rregulloje ngarkesën në baze të kerkeshes se brendshme. Njesite do te montohen mbi suporte antivibrant per te shmangur transmetimin e zhurmave në ambientet e godinës.

Kushtet e jashtme të punës për pajisjet:

Stina e ftohte - 5°C , Stina e ngrohje + 43°C

Rendimenti COP jo me i vogël se 3.4

Njësitë e ventilimit do të jene të tipit me rikuperim nxehësie. Rikuperimi do të behet në seksionin e rrymave të kundërtta ku ajri i trajtuar që del i jep/ merr nxehësi ajrit të freskët që hyn. Minimumi i rendimentit të shkëmbyesit do të jete 60%.



Kutia llamarine e zinkuar me veshje izoluese, me kapakë shërbimi min. ne dy krahë.

Ventilatori, i tipi centrifugal me motor direkt në turbine me tre shpejtësi të rregullueshme , i balancuar dhe kolauduar nga prodhuesi.

Elektromotori me klase mbrojtje IP54, me mbrojtje temperature të brendshme, për ruajtje nga mbinxehja deri ne 120°C.

Tubacione e ajrit ventilues tuba prej llamarine të galvanizuar të formës drejtkëndore, bashkim i tipt me fllanxha. Kthesat e tubacioneve për te minimizuar zhurmat do të jene me rreze jo me te vogël se 0.5D (ku D është dimension i brinjës me të madhe të tubacionit drejtkëndor). Suportet , varëset dhe gjithë elementet e tjerë ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar .

Spesori i llamarinës së tubacionit duhet të respektoje kushtin:

- për brinjën me të madhe deri 400 mm, sp.=0.6mm
- për brinjën me të madhe 400 deri 600 mm, sp.=0.8mm
- për brinjën me të madhe 600 deri 1000 mm, sp.=1.0mm

Tubacionet e ajrit do të termoizolohen me material arloflekt me ngjiturje, dhe densitet të lartë me trashësi 8 mm.

Varjet e tubacionit do te behën në distance çdo 10 diametra.

#### ➤ Grilat

Do të jene prej materiali alumini të trajtuar kundër oksidimit, me flete të rregullueshme dhe regjistër të sasisë se ajrit. Konstruksioni i saj duhet të garantoje shtangësi dhe të mos krijoje zhurma dhe vibrimes gjate punës. Llojet e grilave të përdorura do të jene lineare, me 2-drejtime, 4-drejtime dhe grila te tipi "SLOT" me 2 kanale. Grilat do jene të pajisura dhe me damper volumor për regjistrimin e volumit të ajrit bazuar në shpejtësinë dhe presionin e ajrit në dalje nga grila.

#### ➤ Rrjeti i tubacioneve te bakrit.

Rrejti i tubacioneve do të realizohet me saldim, me elektroda argjendi pa praninë e ajrit në të gjate procesit të saldimit . Për largimin e ajrit nga tubat do të përdoret azot i thatë. Rrjeti do të jete i term izoluar me pësor term izoluese jo me te vogël se 9 mm. Para lidhjes se pajisjeve rrjetit do ti behet prova nën vakum për 48 ore. Suportet, varëset dhe gjithë



elementet e tjerë ndihmës për mbërthimin e tubacioneve do të jene prej çeliku të galvanizuar. Varëset do të vendosen jo me larg se 1.5 m nga njëra tjetra.

## Modeli

Ndërtimi i kabinetit edhe kornizës

- Struktura e pajisjes është një kornize metalike e jashtme dhe pjesët e brendshme të strukturës të jene të bëra nga çelik i zinkuar.
- Njëshja duhet të jete e disenjuar me një fasade të dyte për presionin nën dysheme të rrjedhjes se ajërti, kur një panel i jashtëm është hequr për servis ose mirëmbajtje. Panelet e ndërmjetme duhet të jene të segmentuar për secilën pjese të njësisë (një panel sekondar për të aksesuar filtrat, seksionin e faneve spiralet etj). Gjithashtu edhe për të minimizuar rrjedhjen e ajrit kur paneli është i hapur.
- Paneli i jashtëm do të jete i lyer me boje epoxy-poliestër. Panelet përpëra duhet të jene të ngritur me kuadratin me ane të kapseve. Paneli nga jashtë do të jete me dopjo cope kurse nga brenda me material fiber-qelq izolues nxehthesie.

## Filtrat e kthimit te ajrit

- Filtrat e ajrit të jene me kase metalike edhe me fibra sintetike. Ndërrimi i filtrave të behet nga pjesa e perparme e njësisë.

## Ventilatorët

- Ventilatorët e ajrit të kenë hyrje të vetme edhe dinamik të balancuar.

## Mikroprocesori Kontrollues

1. Kontrolli duhet të përfshijë:
  - Bordi i kontrolli të mikroprocesorit të jete vendosur brenda panelit elektrikisht, i ndare nga njëshja e rrjedhjes se ajrit.
  - Të ketë ndërsa qe të thjesht për përdoruesit.
2. Bordi i kontrollit të mikroprocesorit duhet të përbajë të dhëna dhe program të të gjithë parametrave të ruajtur të cilat duhet të jene të dukshme në ndërsa qen e përdoruesit.
3. Ndërsa qja e Përdorueseve të jete i mbrojtur me password.
4. Ndërsa qja e Përdorueseve të lejoje modifikimin edhe rregullimin e parametrave.

## Kontrolli i Funksionimit të Sistemit



1. Temperatura edhe kontrollimi i lagështirës bazuar në rregullimin e të dhënave.
2. Sinjalizimin e alarmeve lokalishët dhe remetë.
3. Regjistrimin e të gjitha alarmeve edhe mbajtjen e tyre për minimumin e 100 ngjarjeve të fundit.
4. Ri ndezje automatike pasi energjia rikthehet.
5. Komandim në distance të njësisë on/off
6. 2 nivele (të dhëna dhe servise)
7. Mundësia për të komunikuar me një sistem supervizimi me një kabell etherneti në BACNet IP, SNMP, Modbus IP dhe TCP/IP.
8. Funksionimi Ore/Date
9. Llogaritja e orëve vepruese dhe fillimin e ciklevë të komponentëve kryesore.
10. Mundësia për të pare statusin e të gjithë komponentëve.
11. Mundësia për të pare të gjitha vlerat e raportuara nga sensoret të lidhur me bordin e kontrollit.
12. Menaxhim lokal në rrjet deri ne 10 njësi.
13. Mundësi të vendosesh një ose 2 njësi në stand-by.
14. Mundësia për të vendosur një temperature mesatare.
15. Të ketë mundësinë e "Manual Override" funksion i cili lejon kontrollin manual të komponentëve kryesor pa përjashtuar kontrollin nga distanca.

### Ndërfaqja e përdoruesve

1. Ndërfaqja e përdoruesve duhet te ketë:
  - 1 backlit 132 × 64 pixel LCD ekran me zile
  - 6 backlit çelës të lëvizi ndërmjet edhe te ndryshoj parametrat
2. Bordi i mikroprocesorit të jete i lidhur me ndërfaqen e përdoruesit me një kabell RJ11

### Përzgjedhja e gjuhës

1. (IT = Italian, En = English, DE = German, FR = French, SP = Spanish, RU = Russian)
2. Njësia duhet të jete e afte të shfaqe vlera në sistemin metric edhe ne imperial.

### Program Identifikues

1. Firmware rishikimi numrit, data e rishikimit dhe e familjes së produktit është në dispozicion për përdoruesit

### Ekrani



1. Statusi i ekranit. Ndërfaqja e përdoruesit të parazgjedhur duhet të shfaqe:
  - Kohen, datën dhe numrin e njësive LAN
  - Temperaturën e dhomës dhe lagështirën relative
  - Statusin e njësisë
  - Simbol fleshimi kur tregon që njëshja është në progres
2. Switch On Unit/Switch Off ekranin e njësisë.
3. Input/Output screen : të verifikoi gjendjen e hyrjes dhe daljes të bordit.
4. Setpoints screen: të kontrolloi setpointin dhe parametrat e tjera kalibrimit përfunksionimin e duhur te njësisë.
5. Alarms History screen: të shfaq në sekuenca historike 100 alarmet me të fundit.
6. Software Info screen: të shfaq versionin e softerit. Bios boot dhe numrin serial. EEV
7. Valve status: shfaqin formacion nga bordi elektronik i valvules zgjeruese

## Të dhëna

1. Sleep Mode
  - Një funksion i kursimit i energjisë të mund të aktivizohet ose çaktivizohet duke përdorur panelin e kontrollit ose sistemin e monitorimit të përberë nga një start-up automatik i njësisë stand-by një nga kufijtë e mëposhtëm tejkalohet përfundit paktën 30 sekonda.
  - Temperaturën minimale
  - Temperaturën maksimale
  - Minimumin e lagështirës relative (vetëm me sensor lagështire sipas kërkesës)
  - Maksimumin e lageshtires relative (vetëm me sensor lagështire sipas kërkesës)
2. Kohëmatësi
  - Ky program mundëson vendosjen e intervaleve të mirëmbajtjes përkomponentët kryesore të njësisë duke krijuar një prag përorët operacionale. Kur pajisja e monitoruar arrin limitet, mikroprocesorët sinjalizojnë kërkesën e mirëmbajtjes.
3. Selektimi i alarmeve reale
  - Statuset e sinjaleve të alarmit duhet të jene të afte përtu vendosur të normalisht të hapur ose normalisht të mbyllur.
  - Mikroprocesori duhet të jetë i afte përtë menaxhuar automatikisht një rrjet lokal të lidhur me maksimumin 10 njësi, të paktën deri në 2 njësi mund të qëndrojnë në Stand-by.
4. Të dhënat e orës



- Mikroprocesori i njësisë duhet të përfshij një karte për orën që do të mirëmbajë edhe shfaq datën, orën dhe ditët e javës.

## Kontrolli manual

1. Për të ndihmuar mirëmbajtjen dhe kontrolllet ose në raste emergjence, përbërësit e mëposhtëm individual mund të aktivizohen me dore dhe në mënyrë të pavarur nga proceset e kontrollit.
  - Njësia faneve (Unit start-Up)
  - Kompresorët 1/2/3/4 (e aplikueshme)
  - Funksioni i dehumifikimit (e aplikueshme)
  - Aktivizimi 0/1 I daljeve analoge ne DX (Y0/Y1Ramp)

## Alarmet

1. Historiku i alarmeve

Mikroprocesori duhet të mbaj të paktën deri në 100 alarme në memorien e tij.

## KOMPONENTE SHTESE

### 1. Lagështuesi

- Duhet të përbehet nga të paktën 3 elektroda dhe të këtë një konsum deri në 8 l/h

### 2. Adaptor serjal RS485

- Lejon kartën të instalohet duke lejuar komunikimin nëpërmjet një lidhje RS485 mes mikroprocesorit dhe sistemit të mbikëqyrjes së klientit duke përdorur RTU modus ose protokollin Johnson Controls Metasys.

### 3. Clock card

Për regjistrimin e kohës edhe datës për çdo alarm të dhëne.



## 7 MBROJTJA KUNDER ZJARRIT

Ky sistem, eshte shume i rendesishem per ndertesen ne teresi dhe duhet te jete i nderlidhur me permasimet strukturale / arkitektonike, me sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit dhe evakuimin e personave.

Ata do te perzgjidhen ne funksion te zgjidhjes arkitektonike, duke siguruar zbatimin e normave per mbrojtjen kundra zjarrit, ne te dy rastet, ne aspektin pasiv te sistemit kundra zjarrit ( i lidhur me karakteristikat e nderteses) dhe ne aspektin aktiv te sistemit kundra zjarrit (i lidhur me instalimet elektrike dhe mekanike te mbrojtjes kundra zjarrit) i cili eshte objekt i instalimeve mekanike.

Qëllimi i këtij impianti është të mbrojë personelin dhe nxenesit duke siguruar nëpërmjet **masave pasive dhe aktive** evakuimin dhe shpëtimin e tyre.

**Masat pasive** perbejne tërësinë e masave arkitektonike dhe konstruktive duke zgjidhur dhe përcaktuar drejt rrugët e shpëtimit në korridore, shkallë, daljet e emergences, shkallë të brendshme të mbrojtura, si për personelin dhe nxenesit, evakuimin e tyre, sigurimin e kompartimenteve të mbrojtura nga zjarri dhe tymrat nëpërmjet strukturave ndërtimore si mure, tavane, dysheme dyer etj, me rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj zjarrit (REI), sipas normave etj. Rrugët e evakumit dhe shpëtimit janë të plotësuara me sinjalistikën përkatëse sipas normave.

**Masat aktive** përbëjnë qëllimin e projekteve mekanike dhe konsiston në ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit me qëllim mbrojtjen e personave te akomoduar, personelit si dhe mbrojtjen e strukturave dhe vetë godinës.

Për këtë qëllim janë projektuar sistemet e shuarjes së zjarrit me uje nëpërmjet sistemeve me hidrantë, me sistemet e shuarjes me gaz ose pluhur me pajisje dhe bombula portative në përputhje me kategoritë e zjarrit si dhe masa të tjera që kompletojnë impiantet e tjera elektromekanike, të cilat shërbejnë për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe të tymrave si dhe evakuimin e këtyre të fundit. Kështu në projektet mekanike janë parashikuar masa specifike si vendosja e damperave të zjarrit dhe të tymit në kanalet e ajrit të kondicionimit në kalimet vertikale dhe horizontale të tyre etj.



Implanti i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në përputhje me standarde dhe normat lokale, si dhe normave italiane CNVVF/CPAI UNI 9485, etj, si dhe "Prevenzione Incendi Ospedali" D.M 18 Septembre 2002.

## 7.1 Gjendja Aktuale

Ne ambientet e kesaj godine nuk ka sistem hidrantesh te mbrojtjes kundra zjarrit por vetem portative me pluhur.

## 7.2 Pershtatja e Ambienteve

Projektuesi ka vleresuar sistemin aktual te mbrojtjes kundra zjarrit dhe ka percaktuar me ane te projektit te gjitha masat e nevojshme qe duhen marre ne menyre qe ky sistem te jetet funksional.

Per kete qellim, per sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit ( me uje), para se gjithash duhet te sigurohet: depozitim i ujit ( sasia e ujit e cila llogaritet per te gjithe ndertesen) dhe ambienti mekanik i ndertesen, sigurohet rrjeti i kolonave per mbrojtjen kundra zjarrit me hidrante, per te siguruar funksionimin e perkohshem te hidrantave me pak te favorshem ne varesi te gjykimit te projektuesit, me 120 l / per ore, me presion shkarkimi 2 bar, bazuar ne skemen dalese te sigurise per evakuimin, shkallevet e hidrantet e jashtme.

Pompat projektohen ne menyre te atille te fillojne punen ne menyre automatike, per te siguruar ne rastin e nje zjarri rrjedhen e presionin e ujit.

Rrjeti i brendshem dhe i jashtem i tubave per furnizimin me uje realizohet nga materiale te pershtatshem, te perzgjedhura me gjykin e projektuesit sipas normave dhe standardeve teknike.

Sigurohet mundesa e lidhjes ndermjet sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit me autopompe per lidhjen me Zjarrefikeset.

Projekti permban elementet e meposhtem:

- **Skema ku tregohen :**

Sistemet dhe pajisjet e diktim -sinjalizimit te zjarreve

Mjetet dhe paisjet e shuarjes se zjarrit

Skemen e evakuimit te detyruar te punonjesve ne rast zjarri



### 7.3 Kriteri të përgjithshme projektuese

**Implanti i mbrojtjes nga zjarri** është konceptuar që të ndërtohet në përputhje me kërkesat dhe normat për përdorimin e teknikave dhe pajisjeve shuarëse që do të aplikohen mbi bazë të specifikave dhe klasave të zjarreve të mundshme ne objekt.

**Në analizë të zjarreve** të mundshme rezulton se sistemi i shuarjes me ujë nëpërmjet hidrantëve zënë pjesën më të madhe në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, por gjithashtu e shoqëruar me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lëndë shuarëse të gaztë dhe pluhur, mbi bazë të klasave të zjarrit.

**Për sistemin e shuarjes me ujë**(hidrantët), efikasiteti i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit varet në një shkallë të lartë nga mjaftueshmëria e kapacititetit të ujit dhe presionit të tij, të cilët duhet të janë të mjaftueshëm për të mbrojtur sipërfaqet specifike mbi bazë të sasisë së nevojshme të ujit, kohës së veprimit etj. Ndërsa për sistemin e shuarjes me mjete portative efikasiteti i tyre konsiston në vatra zjarri të lokalizuara.

Faktorët përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë :

- Natyra dhe përmasa e zjarrit;
- Madhësia e zonës që do të mbrohet;
- Mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit;
- Kërkesat dhe normat sipas CNVVF/CPAI UNI 9485 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

Për të siguruar funksionet dhe autonominë e sipërpermendur impianti aktiv i mbrojtjes kundër zjarrit është i përbërë nga :

- a) centrali teknik i përbërë nga rezerva ujore dhe grapi i presurizimit,
- b) rrjeti i shpërndarjes dhe hidrantët,
- c) pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),
- d) pajisjet e kontrollit të zjarrit dhe mospërhapjes së tymit.

### 7.4 Klasifikimi i klasave të zjarrit

Për të përdorur agjente shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit.



Në bazë të normave/standardeve bashkëkohore, pajisjet shuarëse të zjarrit janë klasifikuar në pesë klasa. Standarti europian për këta shuarsa dallon klasat e mëposhtme:

**Klasa A** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të ngurtë sikurse dërrasë, letër, plastik, tekstile,etj.

**Klasa B** - vlerëson zjarrë që e kanë origjinën prej materialeve të längshëm sikurse benzenë, benzole, naftë, alkol, vajra etj.

**Klasa C** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të gazta sikurse metan, propan , butan GPL etj.

**Klasa D** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve metalike si alumin, magnez, natrium, etc.

**Klasa E** - vlerëson zjarre nga pajisje elektrike që janë nën tension .

### **7.5 Sistemi i shuarjes me ujë - me hidrantë**

**Sistemi ishuarjes me uje** eshte sistemi kryesor i impiantit te shuarjes nga zjarri i përdorur ne objekt. Kjo zgjedhje eshte ne përputhje te plote me vetitë shuarës te ujit per **zjarre te klasës A** .

Sistemi i shuarjes me ujë është i përbërë nga centrali teknik dhe rrjeti i shpërndarjes.

**Centrali teknik** përbërëhet nga:

- rezerva ujore
- grapi i presurizimit,

**Rrjeti i shpërndarjes** përbëhet nga :

- rrjeti i shpërndarjes dhe kollonat

**Pajisjet fikëse** përbehen nga:

- hidrantët

### **7.6 Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative**

- pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),



## 7.7 Rezerva ujore

**Sasia e ujit** të depozituar për mbrojtjen kundër zjarrit është përcaktuar duke marrë në konsideratë llogaritjet e konsumit të ujit nga numri i njëkohshëm i hidrantëve në punë në përputhje me numrin e kollonave të rrjetit shpërndarës, numrit te hidrantëve njëkohësisht ne pune per cdo kollone pra, nga numuri total i hidrantëve njëkohësisht ne pune.

**Konsumi i ujit** të çdo hidranti **UNI 45** është **120 l/min** dhe per te gjithë hidrantët njëkohësisht ne pune parashikohet prurja që duhet të sigurojë grupi i presurizimit, ndersa koha në të cilën duhet të garantohet kjo prurje per funksionimin e te gjithe hidrantëve është parashikuar **60 min**. Nëpërmjet këtyre dy parametrave baze përcaktohet **Sasia e rezerves ujore** per mirëfunksionimin e sistemit te mbrojtës nga zjarri me hidrantë.

**Rezerva ujore** ne kete rast eshte menduar te perbehet nga depo uji e cila do te pozicionohet ne katin nentoke ne ambientin teknik ku kapaciteti eshte perllogaritur ne baze te kerkesave te nevojshme te sistemit sipas normave ne fuqi.

**Dhomat e depos** së ujit do të kompozohen si më poshtë:

- Tubacionet e furnizimit me ujë, në të cilat do të vendosen valvola ndërprerëse që lidhen me galexhantët mekanik që kontrollojnë nivelin e mbushjes;
- Tubacione e terheqjes(thithjes) se ujit nga depozitat ku do të instalohen valvola ndërprerëse me të gjithë aksesorët që kërkojnë centralet e pompave përkatëse;
- Tubi i shkarkimit (tropo pieno);
- Tubi i boshatisje që do të instalohen në pjesën e poshtme të rezervuarit. Ai duhet të jetë i pajisur me një valvul kontrolli;
- Tregues niveli, etj.

## 7.8 Grupi i presurizimit

**Grupi i presurizimit** është kompozuar në perputhje me kérkesat e projektit per te siguruar prurjen e nevojshme per furnizimin e te gjithë hidrantëve njëkohësisht ne pune. Pompa është me parametra dhe karakteristika teknike e destinuar për rrjetin e hidrantëve. Pompa është e kompozuar nga një elektropompë, e ushqyer nga rrjeti normal elektrik, një motopompe e cila do te jete back-up ne rastet e renies se zjarrit dhe ne munges te furnizimit me energji elektrike te pompes kryesore dhe nga pompa Jockey. Grupi i presurizimit i pajisur me panel kontrolli i cili komandon secilën pompë dhe pajisjet e tyre komandojnë në mënyrë të percaktur, nisjen, ndalimin e pompës duke realizuar njëkohësisht monitorimin dhe



sinjalizimet e nevojshëm duke përcaktuar kështu statusin dhe kushtet e stacionit të pompimit.

**Parametrat teknik** të grupit të presurizimit llogaritur mbi bazë të prurjes së kërkuar per cdo hidrant të barabartë me **120 l/min**, presionit në dalje në hidrantin në pozicionin hidraulik më të disfavorshëm të rrjetit të barabartë me **2 bar** dhe humbjeve të rrjetit mbi bazë të formulës Hazen -Williams.

Pompa e mësipërme është zgjedhur mbi bazë të produkteve të certifikuara të normave europiane dhe **Standardit EN 12845**.

## 7.9 Rrjeti shpërndarës

**Rrjeti i shpërndarjes** është i ndërtuar me tuba dhe rekorderi të cilat respektojnë normat dhe kushtet teknike për impiantin e mbrojtjen kundër zjarrit. Rrjeti i shpërndarjes është furnizuar nga një linjë kryesore që vjen nga grapi i presurizimit në zonen teknike, dhe shpërndahet vertikalisht në kollonat e hidraneve. Në godinë do të ngrihen kollonat që do të furnizojne me ujë hidrantët të pozicionuar nëpër kate, ne pozicione te përcaktuara per te mbuluar te gjithë sipërfaqen nga zjarri. Gjatë projektit është marrë parasysh që rrjeti i tubacioneve të ketë minimumin e numrit të përkuljeve dhe të kthesave të detyrueshme. Gjithashtu janë marrë parasysh zgjidhjet konstruktive të godinës. Tubat janë të pozicionuar dhe të siguruar për të minimizuar dëmtimet dhe vibrimet.

**Linjat e rrjetit** të shpërndarjes janë ndërtuar me tub çeliku të zi pa tegel (Manessman) me bashkim me saldim(ose fileto), me rakorderi (kurba, tee,) gjithashtu me bashkim me saldim (ose fileto), të trajtuar në sipërfaqe me pastrimin e ndryshkut dhe vajrave, të lyera me bojë antindryshk dhe bojë të kuqe RAL 3000 sipas normave. Fiksimi i tyre bëhet me fasheta sipas normave në distanca të përcaktuara, ne kalimet horizontale çdo 10D, në kalimet vertikale çdo 15D.

## 7.10 Hidrantët

**Hidrantët e zjarrit të tipit kasetë me ujë** janë përgjedhur si pajisje fikëse në sistemin e shuarjes së zjarrit për **klasën A**. Ata janë llogaritur të kenë në dispozicion të tërë sasinë e ujit të nevojshëm në rastin e shfaqjes së zjarrit. Kjo është bërë e mundur gjatë hartimit të projektit të instalimit të hidraneve në brendësi dhe jashtë godinës. Ata janë instaluar në çdo kat në brendësi të godinës dhe janë lehtësish të evidentueshme, praktikë për tu përdorur në rastet e shfaqjes së zjarrit.



**Hidrantet DN 45** janë të përbërë prej saraçineskës ndërprerëse, tubit të gomuar për kalimim e ujit me një gjatësi prej 30 m si dhe hundëza. Të gjitha këto pajisje janë të vendosura në boksin prej llamarine çeliku, të lyer me bojë të kuqe RAL 3000 të pjekur, i cili vendoset në brendësi të murit ose jashtë tij (sipas zgjidhjes në projekt) dhe në një lartësi 110 cm nga dyshemeja sipas normave. Ata janë të shoqëruar me kartelat e sinjalistikës përkatëse, me butonin e alarmit.

### 7.11 Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot

Pajisjet e lëvizshme të shuarjes së zjarrit

- Bombola portative me gaz CO<sub>2</sub>, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, E**.
- Bombola karrelato me pluhur, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, C, E**.

**Fikëse me CO<sub>2</sub>** përdoren për mbrojtjen në rast zjarri pikërisht për karakteristikat mbytëse të këtij gazi dhe variojnë nga 2 deri në 5 kg. Mbi flakën ky lloj shuarësi ushtron një efekt freskues dhe mbytës. Ky tip shuarësi përmbanë CO<sub>2</sub> në formë likuide dhe jo të gaztë të presurizuar. Në momentin e funksionimit një valvol lëshon CO<sub>2</sub> që ndodhet në fikës i cili arrin në një difuzor i cili e shpërndan në temperaturë -70 °C nën formën e një reje karbonike ose akulli të thatë. Cilësia kryesore e fikësve me CO<sub>2</sub> është se ky gaz nuk shkakton asnje veprim korroziv dhe nuk lë pasoja pas përdorimit, nuk ndot dhe në përgjithësi ruan objektet nga dëmtimi. Këto bombula me gaz CO<sub>2</sub> janë aplikuar në ambientet e brendshme të godinës së konviktit, të pozicionuara sipas projektit.

**Fikset me pluhur** janë pajisje që përdoren në rast zjarri, të cilët zakonisht janë të adoptuar për të gjitha tipet e zjarrit - kjo shpjegon edhe arsyen se përsë keto pajisje i gjemë pothuajse në çdo ambient. Pluhuri është një material solid i ngjashëm me pudrën. Për ta bërë sa më funksionale kapacitetin e tyre fikës supozohet që mesatarisht një fikë prej 6 kg pluhur është në gjëndje që të shuajë rreth 200 litra substancë likuide të djegshme, e cila mund të jetë benzinë ose alkol dhe është e aftë të fikë edhe zjarre me origjinë gazi. E meta e tyre e vetme që kufizon përdorimin e tyre është në efektet anësore të pas shuarjes së zjarrit. Përdorimi i fikësve me pluhur për të shuar zjarrin mbi një kompjuter apo kuadër elektrik apo cfarëdolloj aparature tjeter elektrike mund të shkaktojë dëme të pariprueshme të pajisjes elektrike. Këto bombula me pluhur janë aplikuar në ambientet teknike në kapacitete 6 kg dhe 50 kg karrelato për përdorim portativ, të pozicionuara sipas projektit.



## 7.12 Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave

Kanalet e ventilimit dhe të kondicionimit, grilat dhe materiali i kanaleve të ajrit, tubat hidraulik, kanalinat elektrike të cilat përshkojnë muret horizontalisht nga njëri ambient në tjetrin, ose përshkojnë soletat apo dyshemetë vertikalish ngjëri kat në tjetrin duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mbrojtjes kundra zjarrit. Per kete qellim nëpërmjet masave të mos përhapjes së zjarrit dhe tymrave, kontrollin dhe evakuimit të këtyre të fundit, janë vendosur dampera kundra zjarrit, dampera tymi, qafore vetshuarese, jastek vetshuares, stuko dhe materiale të tjera vetë shuarëse të cilat janë përcaktuar saktësisht në projektet e impianteve përkatëse.

## 7.13 Sinjalistika

Një element shumë i rëndësishëm është shoqërimi i të gjitha pajisjeve shuarëse, rrugëve të kalimit e të shpëtimit, me sinjalistikat përkatëse sipas normave me ndriçim normal dhe me ndriçim emergjencë. Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit janë parashikuar një numer tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si :

- Tabela paralajmëruese - janë tabelat që tregojnë ndalimin e ndezjes së zjarreve, ndalimit të përdorimit të ujit për shuarje etj.
- **Tabela treguese** - sic janë drejtimet e daljes nëpër korridore, nëpër shkalle, vendosja e hidranave dhe të bombolave etj.
- **Tabelat vepruese-sinjalizimi** nëpërmjet butonit të alarmit, ndërprerja e energjisë elektrike etj.



## 8 SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45

### 8.1 Gjendja Aktuale

Ne ambjentet e godines sistemi i monitorimit me kamera mungon. Duke qene se do te riorganizohen hapesirat e ambjenteve egzistuese, infrastruktura e re e rrjetit te internetit duhet te jete e pershtatshme konform ketyre ndryshimeve.

### 8.2 Pershtatja e Ambjentit

Per nje rritje te cilesise se sherbimeve eshte kerkuar te implementohet rrjeti kompjuterik sipas funksionit te percaktuar te ambienteve.

Gjithashtu eshte parashikuar vendosja e sistemit te monitorimit te kamerave ne te gjithe ambjentet qe shihet e nevojshme.

### 8.3 Sistemi TV

Ne kete sistem eshte parashikuar qe te kete TV ne cdo dhome shtrimi si dhe tek hollet dhe recepcioni. Sistemi TV do te jete vetem UHF me nje antene qendrore ne tarrace dhe me amplifikator qendror qe do te jete ne dhomen teknike. Shprendarja do te kryhet me ane te shperndaresave kalimtar dhe fundor me 4,6,8 dalje ku daljet qe nuk do te perdoren do te mbyllen me rezistenca fundore. Kablli I perdonur per sinjalin TV duhet te jete kabell koaksial 75ohm.

### 8.4 Sistemi CCTV

Sistemi CCTV do te kete funksion monitorimin dhe ruajtjen e pamjeve filmike per arsyte sigurie. Sistemi CCTV do te jete IP me kamera IP POE (Power Over Ethernet) te vendosura ne pikat e konsideruara te nevojshme te monitorohen si korridore, hyrje godine, hyrje ne ambjente kati, recepcion, holl etj. Gjithmone pa cenuar privatesine e personelit, nxenesve, ose personave te tjere. Ne keto ambjente duhen vendosur tabela paralajmeruese qe i behet e ditur qe keto ambjente survejohen me kamera.

Per te gjithe objektin do te vendoset nje NVR qe do te jete ne Rack ne katin 0 ku do te mblidhen te gjithe kabllot qe do te lidhen ne nje switch me 24 porta PoE 10/100 si dhe me 2 porta Uplink. Ne perzgjdhjen e switchit duhet pasur kujdes qe fuqia e portave individuale



te mbaj cdo kamer si dhe ne fuqi totale. Duhet pasur kujdes gjate instalimit qe linjat te mos i kalojne 100m sepse ka problem me PoE si dhe me transmetimin e te dhenave. Me NVR do te lidhet nje monitor qe ti ofroj mundesine personelit te autorizuar te menaxhoj dhe te kontrolloj kamerat ne cdo moment qe do i nevojite. Ne NVR do te instalohen harddisqe HDD per te ruajtur regjistrimet qe do te realizojne keto kamera.

Jane parashikuar per tu perdorur dy tipe kameresh ku per ambientet e brendshme do te jene kamera Dome per tu instaluar ne tavanin e varur ndersa per ne ambientet e jashtme kamera Bullet te cilet do te vendosen ne fasaden e objektit ne lartesi per te monitoruar ambientet hyrese ne objekt. Kamerat duhet te jene me minimumi 5Mpx me lente varifocale nga 2.4 - 12 mm, me regjistrim deri ne 25fps si dhe me infrared IR per te regjistruar naten ose kur ne ambjente eshte erresire.

#### Minimumi I kerkesave te NVR

- Furnizimi 100-240Vac
- Montimi rackmounted per tu montuar ne Rack
- Regjistrimi deri ne 12MP
- Kompresimi I regjistrimit H265+
- Mundesi lidhje deri 4 SATA konektor per HDD deri ne 8TB
- Kontroll regjistrimi smart me filtra sipas eventeve
- Dalje Video : 2 porta HDMI, VGA
- Dalje Audio : RCA
- Temperaturë pune : -10°C deri ne +55°C
- Kontakte te pastra si hyrje ose si dalje te konfigurueshem
- Mundesi lidhje me tastiere dhe maus per komandimin e saj
- Port USB per eksportimin e regjistimeve ne rast evenetes

#### Minimumi I kerkesave per te dy tipet e kamerave:

- Furnizimi : PoE
- Lente: 2.8 - 12mm
- Rezelucion : 720, 1080, HD, Full HD
- Tipi I Lentes : varifocale
- Te kene : IR LED deri ne 30m
- Regjistrimi ne ndricim te ulet : 0.03lux me ngjyra
- Detektim levizje dhe alarmi



- Temperature pune : -20°C deri ne +60°C
- Kompresimin e videos : H265, H265+, MJPEG
- Numri I fps : deri ne 25fps
- Te jene : OnVif
- Te supertoje : microSD
- Shkalla mbrojtjes : IP66, IK10
- Certifikimi CE

*PERGATIUR NGA:*

**BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k**



## RAPORTI TEKNIK



### **OBJEKTI:**

### ***PROJEKTI PER TRANSFORMIMIN E INFRASTRUKTURES AKOMODUESE NE KAMPUSIN RAJONAL TE ARSIMIT PROFESIONAL, BASHKIA DIBER***

POROSITES:

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

PROJEKTUES:

BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k

**2024**



## PERMBAJTJA

<b>1 INFORMACION I PERGJITHSHEM</b> .....	6
<b>1.1 Pershkrimi i per gjithshem</b> .....	6
<b>1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm</b> .....	7
<b>1.1.2 Objektiva Specifike</b> .....	8
<b>1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale</b> .....	9
<b>1.2.2 Strategjia e ndërhyrjes</b> .....	14
<b>1.2.3 Punimet civile</b> .....	14
<b>1.2.4 Gjendja Faktike</b> .....	15
<b>2 ARKITEKTURA</b> .....	16
<b>2.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	16
<b>2.2 Pershtatja</b> .....	16
<b>2.3 Organizimi funksional</b> .....	17
<b>2.4 Koncepti i design në fasadë dhe materialet</b> .....	19
<b>3 KONSTRUKSIONI</b> .....	23
<b>3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit</b> .....	23
<b>4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE</b> .....	24
<b>4.1 Gjendja Ekzistuese</b> .....	24
<b>4.2 Pershtatja</b> .....	24
<b>4.3 Rezerva ujore</b> .....	25
<b>4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitar</b> .....	25
<b>4.4.1 Grupi i presurizimit</b> .....	25
<b>4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar</b> .....	26
<b>4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitar</b> .....	26
<b>4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitar</b> .....	26
<b>4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijshem</b> .....	28



4.5 Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura.....	28
4.5.1 Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare.....	29
4.5.2 Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit .....	29
4.5.3 Kalimet horizontale, pusetat primare.....	29
4.5.4 Rrjeti i jashtëm i shkarkimit .....	30
4.5.5 Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujerave te ndotura.....	30
4.5.6 Tubacionet e shkarkimit te ujrave te ndotura.....	31
4.5.7 Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrave te ndotura .....	32
4.5.8 Tubat e ajrimit .....	32
4.6 Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut .....	33
4.6.1 Rrjeti i kullimit të ujrave te tarracave.....	33
4.6.2 Kolonat e shkarkimit të ujrave të shiut.....	34
4.6.3 Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrave sipërfaqësor .....	34
4.6.4 Sistemimi i ujerave te shiut .....	34
5 ELEKTRIKET .....	36
5.1 Gjendja Ekzistuese .....	36
5.2 Pershatja.....	36
5.3 Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjise dhe shfrytezimit: .....	37
5.4 Furnizimi me energji elektrike.....	38
5.5 Sistemi i shperndarjes .....	38
5.6 Fuqia .....	38
5.7 Ndricimi .....	39
5.8 Sistemi detektimit te zjarrit.....	40
5.9 Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit.....	41
5.10 Normat Ligjet dhe rregullat .....	42
6 IMPIANTI I NGROHJES QENDRORE I AMBIENTIT .....	43
6.1 Gjendja Ekzistuese .....	43



6.2	Pershtatja e Ambjentit.....	43
6.3	Të Përgjithshme.....	43
6.4	Parametrat Kryesor te Projektit .....	44
6.5	Centrali Termik .....	44
6.6	Qarku Hidraulik.....	47
6.7	Elementet e terminalit .....	48
6.8	Inplanti Elektrik .....	48
6.9	Kolaudimi .....	48
6.10	Instruksione per Funksionimin dhe Mirembajtjen .....	50
7	<b>MBROJTJA KUNDER ZJARRIT .....</b>	51
7.1	Gjendja Aktuale .....	52
7.2	Pershtatja e Ambienteve .....	52
7.3	Kritere të përgjithshme projektuese.....	53
7.4	Klasifikimi i klasave të zjarrit .....	53
7.5	Sistemi i shuarjes me ujë - me hidrantë .....	54
7.6	Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative.....	54
7.7	Rezerva ujore.....	55
7.8	Grupi i presurizimit.....	55
7.9	Rrjeti shpërndarës .....	56
7.10	Hidrantët .....	56
7.11	Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot .....	57
7.12	Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave .....	58
7.13	Sinjalistika.....	58
8	<b>SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45 .....</b>	59
8.1	Gjendja Aktuale .....	59
8.2	Pershtatja e Ambjentit.....	59
8.3	Sistemi TV .....	59



8.4 Sistemi CCTV..... 59



## 1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

**Emertimi i Projektit:** "Projekti Per Transformimin e Infrastruktures Akomoduese ne Kampusin Rajonal te Arsimit Profesional, Diber".

**Vendodhja:** Peshkopi, Bashkia Diber

### 1.1 Pershkrimi i per gjithshem

Konvikti eshte i perbere ne dy objekte:

1. Objekti 2 kat i cili sherben si konvikt per djemte
2. Objekti 3 kat i cili sherben si konvikt per vajzat

Konvikti i djemve ka nje siperfaqe totale rreth 2000 m<sup>2</sup> , 1000 m<sup>2</sup> kati perdhe dhe 1000 m<sup>2</sup> kati i pare. Konvikti i vajzave ka nje siperfaqe totale rreth 1290 m<sup>2</sup> , nga ku 430 m<sup>2</sup> kati perdhe, 430 m<sup>2</sup> kati i pare dhe po 430 m<sup>2</sup> kati i dyte.

Te dyja konviktet kane nje siperfaqe totale ndertimi rreth 3290m<sup>2</sup>.

Gjendja e konviktit ne teresi paraqitet shume e amortizuar, ka prezence lageshtire jashte dhe brenda tij si dhe ne ambjentet e perbashketa si dhe ne dhomat e studenteve. Tualetet qe jane ne godine jane te amortizuara, pajisje hidrosanitare te thyera, rubineta te demtuar apo dushe jane jashte funksionit.



### 1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objekt i detyres sone te projektimit eshte projekt ideja perfundimtare per rikonstruksionin e kesaj godine trekatëshe nepermjet vleresimit Tekniko- Ekonomik te objektit dhe evidentimin e nderhyrjeve te nevojshme per krijimin e ambjenteve me standarte bashkekohore akomoduese. Sipas planit te rikonstruksionit te godines, me financim nga buxheti i shtetit, eshte parashikuar nje rikonstruksion i ambienteve duke e kthyer ne ambjente te pershatshme me nje funksionim normal dhe dinjitoz dhe me standardet me te mira nderkombetare per kete tip godine.

Shërbimet që përfshin ky projekt janë:

- Riorganizimi funksional i godinës ekzistuese me qëllim optimizimin e shfrytëzimit të hapësirave të brendshme
- Përmirësimi i infrastrukturës Akomoduese ne Kampusin Rajonal te Arsimit Profesional
- Rikonstruksion dhe rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen



Përzgjedhja e projekteve dhe e impianteve mekanike eshte bazuar në aplikimin dhe projektimin e sistemeve përkatëse me një efikasitet maksimal për të realizuar zgjidhje bashkohore teknike mbi bazë të normave dhe kushteve teknike europiane, me vlera minimale të kostove të investimit mbi bazë të fondeve në dispozicion, si dhe në respekt të kërkesave te parashtruara te termave te referencës ne detyrën e projektimit.

Në vijim, në mënyrë të përbledhur përshkruajmë kriteret të cilat janë marrë parasysh gjatë projekt idese si referencë esenciale për kualifikimin e zgjidhjeve impiantistike mekanike:

- Respektim i normave teknike
- Komfort sherbimi,
- Besueshmëri funksionale,
- Inspektueshmëri,
- Higjenë dhe siguri,
- Parcializim përdorimi,
- Kosto te ulet energjistik perdonimi,
- Kosto të ulët të investimit fillestar,
- Kosto të ulët të mirëmbajtjes,
- Standartizim të komponentëve impiantistikë,
- Respektim maksimal të kushteve ekologjike dhe mjedisore.

Në përgjithësi mund të themi që projektet mekanike janë mbështetur konform normave respektive europiane.

Ne hartimin e projekteve te impianteve mekanike, jemi mbështetur gjithashtu ne baze te Kategorizimit te këtij objekti, mbi baze te Strukturës te parashikuara ne Detyrën e Projektimit, mbi baze te Konstatimeve dhe vlerësimeve te gjendjes egzistuese te impianteve Mekanike dhe mbi baze te Propozimeve te zgjidhjeve Arkitektonike dhe Konstruktive.

### **1.1.2 Objektiva Specifike**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi dhe rinovimi i godinës ekzistuese të konviktit Vlore.

Me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e kushteve akomoduese, struktura ekzistuese do t'i nënshistrohet:

- rikonstrukcionit total



Sa më sipër, do të bëhet studimi dhe vlerësimi i ndërtesës ekzistuese si dhe hartimi i projekteve arkitektonike dhe inxhinierike; përllogaritja e kostove; raportet teknike.

### 1.2.1 Foto te Gjendjes Aktuale

Me poshte po japim disa foto te gjendjes aktuale te cilat jane realizuar gjate verifikimeve ne objekt.





**F&M**  
ingegneria


**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE







### 1.2.2 Strategja e ndërhyrjes

Bazuar në Detyrën e Projektimit ku sqarohen në vija të përgjithshme nevojat e konviktit, si dhe referuar Standardeve të Projektimit të objekteve akomoduese, është hartuar një projekt i cili përbledh në vetvete gjithë elementët e nevojshëm që bëjnë të mundur përdorimin dhe menaxhimin sa më eficient të objektit.

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivave, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tërësor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinnovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin i kushteve akomoduese

### 1.2.3 Punimet civile

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tërësor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardë e projektimit dhe ndërtimit të jenë konform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines nuk do te ndryshojne fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines, por thjesht një rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambienteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion total i catise
- System i ri elektrik, mekanik, hidraulik, etj



#### **1.2.4 Gjendja Faktike**

Gjendja e per gjithshme e objektit, shfaqet e amortizuar ne kohe. Vihet re presenza e vazhdueshme e lageshtise, mungon totalisht instalimet e sistemit MKZ, Instalimet e sistemeve te ngrohjes me kaldaje paraqiten te amortizuara dhe te vjeteruara me kohen po ashtu edhe instalimet elektrike dhe hidraulike etj.

#### **Ndërhyrje.**

Pas studimit që i është bërë detyrës së projektimit, kemi konkluduar se hapat kryesore që nevojiten të ndërmerrin për ndërhyrje, në aspektin e përmirësimit dhe shfrytezimit të hapësirave janë:

- 1. Te permiresohen ndjeshem kushtet e sherbimit ne ambjentet e Godines akomoduese;**
- 2. Te rinovohen te gjitha sistemet teknike te godines si Instalimet Elektrike, Instalimet Hidraulike, HVAC, MNZ, etj sipas standarteve europiane per taktyer ne nje objekt bashkekohor dhe te denje per funksionin qe ka;**
- 3. Te gjitha funksionet qe kryhen ne kete godine do te mbulohen perseri ne te njejten gjurme;**
- 4. Ndërhyrje në sistemimet e jashtme të objektit, etj**



## 2 ARKITEKTURA

### 2.1 Gjendja Ekzistuese

Konviki i djemve dhe i vajzave ne Diber, aktualisht ambientet shfrytezohen si konvikt për djemtë dhe vajzat. Ai ka nje sipërfaqe totale gjurme prej rreth 1430 m<sup>2</sup>.

Konviki eshte i perbere ne dy objekte:

1. Objekti 2 kat i cili sherben si konvikt per djemte
2. Objekti 3 kat i cili sherben si konvikt per vajzat

Konviki i djemve ka nje siperfaqe totale rreth 2000 m<sup>2</sup> , 1000 m<sup>2</sup> kati perdhe dhe 1000 m<sup>2</sup> kati i pare. Konviki i vajzave ka nje siperfaqe totale rreth 1290 m<sup>2</sup> , nga ku 430 m<sup>2</sup> kati perdhe, 430 m<sup>2</sup> kati i pare dhe po 430 m<sup>2</sup> kati i dyte.

Te dyja konviktet kane nje siperfaqe totale ndertimi rreth 3290m<sup>2</sup>.

**Rifiniturat**\_Rifiniturat e brendshme dhe të jashtmë të godinës shfaqen në nivel të lartë amortizimi të ardhura këto jo vetëm për shkak të amortizimit fizik natyror që pësojnë strukturat dhe materialet por dhe për shkak të projektimeve të meparshme në nivele jo-optimale si në nivel projektues ashtu dhe zbatues në përdorimin e materialeve dhe instalimeve teknike dhe detajeve konstruktive. Sa më sipër, bazuar në inspektimin në vend problemet me evidente janë:

- Kushte jo të mira të mbështjellës së ndërtesës (fasadës). Përvec amortizimit evident ajo shfaq dhe nivel te lartë lagështie.
- Mungesë izolimi termik si në muret perimetral të cilat janë mure tulle që nuk janë pajisur me shtresa termike, ashtu dhe në vetrata të cilat nuk kanë veti termike dhe krijujnë që humbjet e energjisë te jenë të larta.
- Gjithashtu përreth godinës terreni është i pasistemuar dhe nuk kanë një funksion të mirëfilltë me qëllim shfrytezimin e tyre si hapësira creative.
- Shtrimet e dyshemeve janë bërë me pllaka gres porcelanat te cilat janë amortizuara me kalimin e kohes.
- Instalimet hidraulike, elektrike, mekanike paraqiten të amortizuara.
- Amortizim i suvasë në zona të caktuara; amortizimi I dyerive, dritareve etj.

### 2.2 Pershtatja

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivëve, janë renditur më poshtë:



- Rikonstruksion tèresor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemimeve të jashtme; rinnovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e ambjenteve akomoduese. Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tèresor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardë e projektimit dhe ndërtimit të janë konform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni i ambienteve do të jetë një ndërhyrje nepermjet te cilit ambientet e godines nuk do te ndryshojne fuksionalitetin e tyre, pra nuk do te kete një rikonceptim te godines, por thjesht një rikonstruksion total te saj dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e objektit akomodues.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim i vetratave të jashtme
- Ndërrim i dyerve të brendshme
- Rehabilitim i pjeses konstruktive
- Ndërtim muresh aty ku del nevoja per ndarje hapesirash
- Nderrim i shtresave të dyshemese
- Ndërrim i shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim i pajisjeve hidrosanitare
- Realizim i tavaneve të varur
- Lyerje të ambienteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion total i catise
- Përmirësimi i sistemimeve të jashtme
- System I ri elektrik, mekanik, hidraulik, HVAC etj


### 2.3 Organizimi funksional

Zgjidhja e organizimit funksional bazohet në Detyrën e Projektimit të përcaktuar si dhe në Standarde të ndryshme të projektimit. Është bërë një studim i gjërë i tyre me qëllim arritjen e plotësimit të nevojave si për nxenesit dhe stafin.


Me qëllim arritjen e objektivit për një funksionalitet të mirë si në ndarjet e hapësirave ashtu dhe në lidhjet mes tyre, ndërhyrja bazohet në elementin kryesore qe eshte ndërhyja minimale në muraturën ekzistuese dhe riorganizim i hapësirave.



Kati përdhe – Planimetria e propozuar




Kati i Pare – Planimetria e propozuar





Kati I DYTE – Planimetria e propozuar



#### 2.4 Koncepti i design në fasadë dhe materialet

Në lidhje me konceptin e fasadës është propozuar një rikonceptim duke ruajtur ritmin e dritareve ekzistuese dhe realizimin e kornizave dekorative ne hyrjet e objekteve. I gjithë perimetri I fasadave do të vishet me system kapotë me qëllim termoizolimin dhe rritjen e eficiencës së energjisë. Edhe dritaret dhe vetrata do të jenë prej duroalumini me veti të larta termike.

Me qëllim evitimin e një monotonie të vazhduar nga fillimi e deri në fund i fasades, janë propozuar korniza dekorative ne ne hyrjet e objekteve, kontrast i ngjyres ne ballkonet e konviktit te vajzave si dhe grafiti kryesisht ne faqet ballore te objekteve.

Ngjyrat e fasadave i propozojmë neutrale, në tonalitetet të ndryshme të bezhes ndërkohë që kornizat e dyerive hyrese ne objekt do te kene ngjyre bezhe te erret duke krijuar ne kete menyre një design qe bën që të përftojmë një fasadë dinamike dhe njëkohësisht bëjmë të



mundur që fasada, sikurse dhe pjesa e brendshme, të vijnë në nivelet e arkitekturës bashkëkohore.

Lidhur me materialet që do të përdoren, muret perimetrale do tëjenë të sistemit 'kapot'. Mbulimi i objektit do të jetë me cati.





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





**F&M**  
ingegneria

**MAU**  
ARCHITECTURE





### 3 KONSTRUKSIONI

#### 3.1 Përshkrim i përgjithshëm i objektit

Objektit në fjalë përfshin një godinë civile ku tre kat mbi toke, në elementet strukturorë të së cilës nuk do të ketë ndërhyrje.

Struktura e objektit eshte e nderthurur me konstruksion b/a te tipit tra - kollon dhe mure mbajtes.

Themeli i strukturës është themel i vazhduar dhe plinta b/a.

Ne te gjitha nderhyrjet (prishje dhe ndertim muresh, etj) qe parashikohen te behen ne kete objekt jane marre parasysh te gjitha kerkesat e kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit ne fuqi.

Pas verifikimit vizual, ne objekt nuk verehen demtime te struktires mbajtese te tij dhe per kete arsyе nuk eshte pare e nevojshme te nderhyet apo te paraqiten plane/detaje te nderhyrjes..

Gjithsesi, gjate fazes se pergatitjes se projektit te zbatimit te objektit te behen investigime me te thelluara te struktires mbajtese te tij ne menyre qe te kihet nje panorama me e qarte ne lidhje me nevojen per marrjen e masave perfocuese te saj.



## 4 RRJETI I UJESJELLESIT DHE I KANALIZIMEVE

### 4.1 Gjendja Ekzistuese

Gjendja aktuale e sistemit te ujesellesit dhe te kanalizimeve paraqitet mjaft i amortizuar. Sipas verifikimit ne terren te gjendjes aktuale eshte vene re dukshem demtimi i tualeteve ne dysheme, amortizim i sistemit te furnizimit me uje dhe te shkarkimit te ujerave te ndotura duke ulur ne kete menyre per funksionalitetin e tyre.

Gjithashtu ka demtime te konsiderueshme ne rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujrale te shiut. Vlen per tu theksuar demtimi i ulluqeve i cili ka sjelle edhe demtimin e fasades nga depertimi i lageshtires ne periudhe dimri.

### 4.2 Pershtatja

Ne projektimin e rrjetit te ujesellesit dhe te kanalizimeve eshte marre ne konsiderate rrjeti ekzistues i godines. Projekti hidroteknik i eshte permbajtur kerkesave te autoritetit. Pas vizitave te vazhdueshme ne objekt nga ana e projektuesve jane pare opsione te ndryshme zgjidhjesh dhe me pas eshte arritur ne nje zgjidhje perfundimtare te sistemit hidroteknik.

Do te nderhyet ne rrjetin e ujesellesit dhe ate te shkarkimit te ujrale te ndotura ku eshte menduar te ndertohet me materiale bashkekohore dhe ne perputhje me standartet ne fuqi. Rikonstuksioni do te perfshi instalimet hidroteknike (sistemin e furnizimit me uje dhe shkarkimin e ujerave te ndotura) brenda godines. Per rrjetin e jashtem te kanalizimeve ne projekt do te perfshihet pjesa nga dalja e kolones kryesore te shkarkimeve deri te bashkimi te puseta me e afert. Lidhur me pusetat do te behet rikonstruksion I shkarkimeve dhe mbulimi i pusetave do te behet me kapake prej gize te gatshem.

Materialet qe do perdoren per rrjetin e ujesellesit jane perzgjedhur per te perballuar prurjet dhe presionet llogaritese.

Cdo pajisje do te kompletohet me rubineta filter ne hyrje te ujit ngrohte dhe atij te ftohte. Tubat e furnizimit me uje do te jene PP-R per presion 16Atm dhe PEX-AL. Ndersa tubat e shkarkimeve do te projektohen me material te cilesise se pare dhe me gomine ne zgjatim, po keshtu me gomine dhe te gjitha rakorderite. Eshte percaktuar pika e shkarkimit te ujerave te perdorura jashtë objektit dhe lidhjen me rrjetin ekzistues K.U.Z.

Impianti i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë dhe nevojat për ujë teknik për pajisjet mekanike të impianteve të ndryshme. Nevojat e përgjithshme për ujë pavarësisht përdorimit dhe përpunimit të tij, sigurohen nga centrali teknik i cili përbahet nga rezerva e ujit dhe nga impiantet përkatëse



të pompimit dhe të shpërndarjes. Përvec kësaj në rezervën e ujit për përdorim sanitari sigurohet edhe rezerva e ujit për nevojat e impiantit të mbrojtjes nga zjarri.

#### **4.3 Rezerva ujore**

**Furnizimi me ujë për nevojat hidrosanitare** parashikon nevojat e ujit të ftohtë dhe nevojat për ujë te ngrohtë. Rezerva e përgjithshme e ujit për nevojat hidrosanitare, sipas normave parashikohet te sigurohen per nevoja te konsumit 24 ore, pavaresisht furnizimit te vazhdueshëm me uje nga rrjeti i qytetit .

**Furnizimi me ujë për nevoja teknike** parashikon nevojat për furnizimin e të gjithë paisjeve sanitare me uje te ngrohte, gjithashtu për nevojat e impiantit të ngrohje/ftohje te kondicionimit.

**Në total rezerva e kërkuar e ujit për të tre përdorimet** e mësipërme është rezerva ujore per përdorim sanitari per 24 orë.

#### **4.4 Sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë sanitari**

**Sistemi i furnizimit me ujë hidrosanitar** përbëhet nga :

- a) grapi i presurizimit
- b) rrjeti i shpërndarjes

##### **4.4.1 Grupi i presurizimit**

**Grupi** është i përbërë nga pompat kryesore elektrike e ushqyer si nga rrjeti normal elektrik dhe nga rrjeti i emergjencës dhe aksesorët impiantistike përkatës, për të garantuar prurjen dhe presionin e rrjetit të konsumatorëve. Pompat janë të kontrolluara nga një kuadër elektrik te pavarur, me lexim të lehtë të instrumentave të sinjalizimit. Pompat janë pajisur më kolektorët e thithjes dhe dërgimit, që janë të galvanizuar me veshje shtrese epoxidi. Ato kanë në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvola ndërprerëse, valvol moskthimi, si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollolli, si presostatët e presionit etj. Grupi i presurizimit është konform normave të standartizuara europiane.



#### 4.4.2 Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar

Rrjeti i shpërndarjes është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i presurizimit deri në konsumatorë nëpërmjet një rrjeti të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit në dhomen teknike, nëpërmjet kalimit te tyre gjate koridorit dhe furnizon kollonat kryesore të shpërndarje në godinë, nga të cilat dalin degëzimet magjistrale për çdo kat. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi për një sektorë të caktuar të pajisura me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjera. Sistemi i tubave të ujit sanitari plotëson të gjitha kërkesat e normave dhe standardeve të përcaktuara, në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Furnizimi ne cdo tualet eshte parashikuar te behet me sistem shpërndarje me kolektorë. Kështu nepermjet këtij sistemi sigurojmë funksion me te mire te furnizimit me uje te paisjeve sanitare, si dhe lehtësi dhe shpejtësi ne riparimin e defekteve / ose mirëmbajtjen e tyre.

#### 4.4.3 Sistemi i furnizimit me uje të grohtë sanitar

Sistemi i ujit te ngrohte do te behet me bolier 15 liter dhe 80 liter dhe perbehet nga prodhuesi i energjise termike, tubat e shperndarjes dhe pajisjet perkatese te dhenies se energjise termike.

Me kerkese te supervizorit mund te perdoren tuba PPR dhe PEX-AL qe jane konform standartave te mesiperme per cilesine dhe testimin e tyre per presionin dhe rezistencen ndaj temperaturave te larta.

Tubat per furnizimin me uje te ngrohte duhet te sigurojnë rezistence termike ndaj temperaturave te larta, deri ne 100 grade celsius, korrozionit, agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshta dhe te shpejte, jetegjatesi dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

#### 4.4.4 Dimensionimi i rrjetit te furnizimit me uje sanitari

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit te ftohte/ngrohte sanitari ne objekt eshte realizuar duke marre ne konsiderate skemen e shperndarjes, prurjen nominale per çdo aparat hidrosanitar, prurjen totale nominale, njekohshmerine e perdonimit te pajisjeve hidrosanitare, presionin e punës, humbjet gjatesore dhe lokale te presionit si dhe shpejtesine maksimale te rekomanduar te qarkullimit te ujit.



Vete nevojat per uje sanitar jane llogaritur bazuar ne normen europiane EN-806-3 e cila merr ne konsiderate prurjen totale maksimale te kerkuar (Qta dhe Qtb) bazuar ne numrin e aparateve hidrosanitare dhe prurjen nominale per çdo aparat hidro/sanitar. Per aparatet ne te cilen parashikohet uji i ngrohte dhe i ftohte eshte konsideruar prurja e nevojshme e nje fluksi te vetem.

Prurja e projektit Gpr bazuar ne normen EN 806-3 eshte llogaritur e diferençuar bazuar ne tipologjine e objektit dhe pikerisht:

Gta (l/sec)	1.1	1.5	2	2.6	3.2	3.6	4.1	4.5	5.1	6.1	7.2	8.1	9	10.1	11.2	12.2	15.2
Gpr	0.5	0.7	0.8	0.9	1	1.1	1.2	1.2	1.3	1.4	1.5	1.6	1.7	1.8	1.9	2	2.2

Tubat qe do te perdoren per furnizimin me uje te ftohte do te jene PPR, PN 16bar dhe PEX-AL .

Diametrat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te pijshem dhe shpejtesise se levizjes. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret ne intervallet 0,8-1,4 m/sek. Gjatesia e tubave eshte 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem te tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj, duhet te jepen te stampuara ne çdo tub. Tubat e furnizimit me uje duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e ndertesese, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe kerkojne uje te pijshem. Ato instalohen brenda ne mur. Ne rast se gjatesia e shtrirjes se tyre eshte e madhe duhet te vendosen kompesatore te tipit me brryl te thjeshte ose tip omega. Bazuar ne prurjen e projektit, diametri i linjave te furnizimit me uje eshte llogaritur mbi bazen e formules:  $Qpr = 0,785 \times D^2 \times V$

ku  $V$  = eshte shpejtesia e lejuar e levizjes se ujit ne tubacione.

Kjo shpejtesi, per tubacionet e furnizimit me uje sanitari eshte pranuar:

Diametri tubacionit	DN 25	DN32	DN50	DN63
Shpejtesia max (m/sec)	1,1	1,3	1,9	2,1



#### 4.4.5 Rakorderite per tubat e ujit te pijshem

Per sistemin e furnizimit me uje te nderteses, meqenese do te perdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderite perkatese duhet te jene PPR te cilat plotesojne kerkesat e cilesise sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kerkesat per cilesine dhe testimin).

Rakorderite qe perdoren ne keto linja jane:

- Brrylat te thjeshte me 45 grade dhe 90 grade
- Brryla me fileto metalike te tipit femer dhe mashkull;
- Tridegeshat te thjeshte dhe me fileto;
- Katerdegesha (Kryqe)
- Bashkues te thjeshte
- Bashkues me fileto metalike tip femer dhe tip mashkull;
- Reduksionet e ndryshme;
- Rakorderi tip hollandez; etj

Rakorderite qe do te perdoren per furnizimin me uje duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

Diametri dhe spesori duhet t'i pershtaten tubave perkatese dhe te jene sipas te dhenave dhe kushteve teknike. Spesori i rakorderive duhet te jete i tille qe te perballoje 1,5 here te presionit te punes se tubave.

#### 4.5 Sistemi i shkarkimit te ujrave te ndotura

**Impianti i shkarkimit të ujërave të zeza** shërben përmblledhjen e shkarkimeve të godines. Ky rrjet është një rrjet i veçantë nga rrjetet e tjera të shkarkimeve si rrjeti i shkarkimeve te ujrave te shiut dhe te impiantit te kondicionimit.

Impianti i shkarkimit të ujërave të zeza do të jetë i përbëre nga :

- a) rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të ambienteve sanitare,
- b) kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit,
- c) kalimet horizontale, pusetat primare me pompat e ngritjes,
- d) rrjeti i jashtëm i ujrave të zeza



#### **4.5.1 Rrjeti i brendshëm i shkarkimeve të nyjeve sanitare**

**Rrjeti i brendshëm** i shkarkimit të nyjeve sanitare është i përbërë nga tubacione plastik horizontale të cilat mbledhin të gjitha shkarkimet e pajisjeve për tu shkarkuar ne kolonën vertikale të shkarkimit. Diametri dhe gjatësia e tubave është e tillë që të sigurojnë rrjedhjen normale të ujrale të zeza në kolonat e shkarkimit.

Për shkarkimet e ujërave të zeza janë përdorur tuba dhe rakorderi sipas normave dhe standardeve. Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave mekanike dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### **4.5.2 Kolonat vertikale të shkarkimit dhe balancimit**

**Kolonat vertikale** të shkarkimit dhe balancimit gjithashtu shërbejnë për mbledhjen e shkarkimeve të nyjeve sanitare. Ato shoqërohen së bashku me kolonat e balancimit të cilat bëjnë të mundur balancimi e ajrit gjatë shkarkimit të ujrale në kolonat kryesore. Kolonat e shkarkimit kanë dalje në pjesën e sipërme të tyre në tarracë dhe/ose ne fasadat e godinës, ndërsa në fundin e tyre ato bashkohen në kolektorët deri në derdhjen në pusetat primare te rrjetit te jashtem.

Si kolonat e shkarkimit ashtu edhe magjistralet në të cilën janë parashikuar diametrat e tubacioneve dhe pjerrësitë e tyre rigorozisht sipas normave të projektimit. Lidhja e tyre bëhet me anë të bragave  $45^\circ$  në mënyre që shkarkimi të bëhet sa më i lehtësuar duke lejuar qarkullimin e ajrit nëpër tubin e shkarkimit të nyjës sanitare gjë e cila mund të minimizojë qarkullimin e ajrit dhe të rrisë nivelin e zhurmave gjate shkarkimit. Këto kolona të brendshme janë të gjitha të lidhura me kollonen për shfryrjen dhe ballancimin e presioneve të gjithe rrjetit, pasi mblidhen, dalin jashtë godinës arrijnë në rrjetin e pusetave.

Këto tuba e rekorderi (pjese bashkuese) kanë karakteristika te tilla si: sigurojnë mosrrjedhje, reduktim të lartë të transmetimit të zhurmave, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, janë rezistent ndaj korrozionit, rezistent të lartë ndaj agjentëve kimike, kanë peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### **4.5.3 Kalimet horizontale, pusetat primare.**

**Kolektorët dhe kalimet horizontal** shkarkojnë në pusetat primare të rrjetit e jashtëm.



Meqenëse shkarkimet e godinës deri në katin nëntokë rezultojnë në kuotën e rrjetit të jashtëm të ujrave të zeza nuk është e nevojshme që të përdoren pusetat. Shkarkimet e tyre behen me gravitet me rrjedhje te lire.

**Pusetat primare** mbledhin ujrat ne rrjetin pranë godinave dhe me pas rrjeti i tyre lidhet dhe shkarkon ne rrjetin urban te zonës ose te qytetit.

#### 4.5.4 Rrjeti i jashtëm i shkarkimit

**Rrjeti i jashtëm** i grumbullimit te ujërave të zeza eshte parashikuar i përbërë nga pusetat primare të tipit mbledhëse me konstruksion betoni të papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize me permasë Ø60 si dhe tubacionet të dimensionuara sipas normave teknike të projektimit. Pusetat e ujërave të zeza janë në forme katrorë me thellësi jo më pak se 90 cm. Përmasat janë duke filluar nga 60x60 cm dhe dimensionohen ne baze te kërkeseve te projektit. Tubacionet e rrjetit të jashtëm të shkarkimeve rrjeti i jashtëm i shkarkimeve janë tuba polietilen i rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të zeza të vendosura në çdo pikë ndërprerjeje ose kontrolli të rrjetit të jashtëm të shkarkimit. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesa e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### 4.5.5 Dimensionimi i tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura

Sistemi i shkarkimeve te ujrave te ndotura behet me gravitet. Sistemi eshte dimensionuar ne menyre te tille qe ujrat e shkarkuara te mos okupojne te gjithe seksionin e tubacioneve te shkarkimit. Sasia e ujrave te shkarkuara (ne njesi shkarkimi US) eshte llogaritur duke konsideruar aparatet hidrosanitare te kategorise 3. Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve te sistemit te shkarkimit te ujrave te ndotura eshte bere duke marre ne konsiderate:

- skemen e shperndarjes dhe shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S;
- fluksion nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- shpejtesise se qarkullimit dhe pjerresise se tyre etj.

Per shkarkimet e ujrave do te perdoren tuba plastike PP3 qe plotesojne te gjitha kërkesa e cilesise sipas standardit ISO 4427 dhe prEN 12201. Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte. Permasat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujut te ndotur, shpejtesise se levizjes dhe shkalles



se mbushjes se tyre. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes duhet te jete 0,5 - 0,8 e seksionit te tubit.

Per objektin tone per kanalizimin e ujerave te brendshme do te perdoren tubat PP3 me diametra DN50, DN75, DN110 dhe DN125.

Tubacionet e shkarkimit te ujerave te ndotura qe do te dalin nga godina do te perdoren te tipit HDPE i brinjezuar SN4 DN 125. Dalja e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te ndotura nga godina do te behet duke u lidhur me puseten me te afert.

#### **4.5.6 Tubacionet e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per shkarkimin te ujrave te ndotura jane perdorur tuba prej PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normativa UNI 7613.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Diametri i tubave eshte percaktuar ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosura.

Kollonat vertikale te shkarkimit do te pajiset me pika kontrolli. Instaluesi duhet te vendose nje numer te xhuntove ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit te tubacioneve.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh me ane te tubave te dergimit. Tubat e dergimit do te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Per te pakesuar numrin e kollonave duhet qe pajisjet sanitare te grupohen dhe te vendosen njeri mbi tjetrin nga kati ne nderkat te nderteses. Diametri i kollonave te shkarkimit merret i njeje per te gjithe lartesine e nderteses dhe ne asnje menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Nuk lejohet perdorimi i tubave te shkarkimit me diameter me te vogel se 50 mm. Bashkimet e tubave te shkarkimit duhet te behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Provat hidraulike behen me presion prove 25% me te larte se presioni i punes. Ato behen per te pare qendrueshmerine e rrjetit, si dhe rrjedhjet e mundshme qe mund te ndodhin ne tabacione.



#### **4.5.7 Rakorderite per tubat e shkarkimit te ujrave te ndotura**

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do te perdoren rakorderite perkatese me material PP3 te densitetit te larte sipas karakteristikave te percaktura nga normatives UNI 8452.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrade te ndotura që lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

Provati e shkarkimit do te realizohen ne perputhje me normen UNI 7615.

Permasat (diametri) e tyre do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, llojut te pajisjeve sanitare, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrave te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0,5-0,8 e sekcionit te tubit. Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dheneve. Te dhena mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi. Rakorderite e bashkimit te tubave duhet te montohen ne te gjithe vendet ku behet bashkimi me tubat e dergimit te ujrade te ndotura. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit, duhet te behet me tridegeshe te pjerreta ose brryla te thjeshte nen nje kend 45 ose 60 grade. Rakorderite e bashkimit duhet te jene tuba PP3 me te njejtat karakteristika teknike te dhena me siper. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur. Diametri i rakorderive duhet te jete i njejtë me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnjë menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrade te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre. Bashkimet e rakorderive me tubat e shkarkimit, behen me mastik te pershtatshem per tuba PP3 i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

#### **4.5.8 Tubat e ajrimit**

Tubat e ajrimit jane zgjatim ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit dhe duhet te nxirren 70 - 100 cm me lart se pjesa e siperme e çatise ose tarraces se nderteses. Ato duhet te sherbejne per ajrimin e rrjetit te brendshem dhe te jashtem te kanalizimeve. Ky ajrim eshte i domosdoshem sepse me ane te tij behet e mundur largimi i gazrave te krijuara ne kollonat e shkarkimit si dhe i avujve te ndryshem qe jane te demshem per jeten e banoreve.



Gjithashtu, Tubat e ajrimit do te sherbejne per te bashkuar kollonat e kanalizimeve me atmosferen per te menjanuar nderprerjen e punes se sifoneve ne pajisjet hidrosanitare. Tubat e ajrimit duhet te kene diametrin e brendshem njelloj me diamterin e kollones se shkarkimit. Diametri i tubit te ajrimit duhet te jete DN110 mm. Materialet qe perdoren per keto tuba duhet te jene rezistent ndaj korrozionit, agjenteve atmosferike, gazrave te ndryshem qe dalin nga kollonat e shkarkimit. Ne maje te tubave te ajrimit duhet te vendoset nje kapuç, i cili pengon hyrjen ne tub te ujrade te shiut dhe debores si dhe permireson ajrimin e kollones se shkarkimit. Nje grup aparatesh mund te kene dy tuba ajrimi. Tubat e ajrimit duhet te montohen me kujdes ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit ne menyre qe te mos shkeputen ose te demtohen nga ererat e forta qe mund te fryjne. Ato montohen ne pozicion vertikal. Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

#### **4.6 Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut**

**Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut** është ndërtuar i veçante nga rrjetet e tjera të shkarkimeve dhe shërbën për të mbledhur ujrat siperfaqesor të shiut nga tarracat si dhe nga ujrat sipërfaqësor të sheshit.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të shiut do të përbëhet nga :

- a) rrjeti i kullimit të tarracave.
- b) kolonat vertikale të shiut (kolektorët e shkarkimit të shiut)
- c) rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrade sipërfaqësor .

##### **4.6.1 Rrjeti i kullimit të ujrade te tarracave**

Rrjeti i kullimit te ujërave të tarracës eshte parashikuar me pileta shiu, kollonat si dhe kolektorët që mbledhin ujrat e shiut nga tarracat dhe shkarkojnë drejt rrjetit të jashtëm të ujrade të shiut. Për shkak të konfigurimit të godinës në relacion me kuotën 0.00 të sheshit dhe rrjetit egzistues të jashtëm të mbledhjes së ujrade të shiut rezulton që të gjitha kollonat e godinës mbasi zbresin poshtë dyshemesë së katit përdhe mund të shkarkojnë lirshëm në rrjetin e jashtëm.



Te gjitha kollonat e shkarkimit plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas normave të projektimit, duke filluar nga piletat, kolonat, deri tek kalimet horizontale dhe kolektorët që përfundojne në rrjetet respektive.

#### **4.6.2 Kolonat e shkarkimit të ujrave të shiut**

**Kolonat vertikale e shkarkimit të ujërave të shiut** shërbejnë për të shkarkuar ujin e shiut nga piletat ose ullukët deri në nivelin e kolektorëve të ujërave të shiut ose deri në rrjetin e jashtëm të shkarkimeve të ujërave të shiut. Dimensioni i tyre është bërë duke marrë parasysh kapacitetin e ujit në rastin e periudhave të shirave. Gjatë projektimit, janë marrë parasysh kushtet hidro-metrologjike dhe sasitë e reshjeve, në zonën ne studim. Mbi bazë të këtyre të dhënave, çdo kollonë mbledh ujrat e jo më shumë se 150 m<sup>2</sup> sipërfaqe tarrace dhe secila prej kollonave është parashikuar me diametër jo me të vogel se 110 mm. Kollonat janë parashikuar të ndërtohen me material metalike , me të gjitha lidhjet me bashkim nëpërmjet të cilave sigurohet funksionim normal i shkarkimeve, mosrrjedhje të ujrave, qëndrueshmëri në kohë të tyre, janë rezistent ndaj korrozionit, janë rezistent ndaj ngarkesave materiale dhe temperaturës se larte, minimizimin e zhurmave gjatë shkarkimit si dhe eleminimin e kondensave sidomos në përiudhën e dimrit, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalimi.

#### **4.6.3 Rrjeti i jashtëm i mbledhjes së ujrave sipërfaqësor**

Rrjeti i jashtëm i shkarkimit të ujërave të shiut pasi mbledh të gjithë shkarkimet nga kolektorët e shkarkimit të ujërave të shiut shkarkon në rrjetin e qytetit. Për grumbullimin e ujërave të shiut janë parashikuar puseta të tipit mbledhëse me konstruksion betoni te papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize grile me përmasa 60x40 cm. Të çarat me kapakun prej grile janë nga 25 deri 35 mm për te ndaluar plehrat si dhe për te mundësuar kullimin e ujërave. Pusetat e ujërave të shiut janë në forme katrore me thellësi jo me pak se 90-100 cm me përmasa 40x40 cm. Tubacionet e rrjetit të jashtëm janë tuba polietilen të rrudhosur të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të shiut. Tubat polietilen të rrudhosur plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë të certifikuar sipas standardeve europiane.

#### **4.6.4 Sistemimi i ujerave te shiut**

Largimi i ujerave atmosferike (d.m.th. i ujerave te shiut e te debores se shkrirë) eshte menduar te kryhet me ane te nje sistemi ujerash ne drejtim te kasetave te shkarkimit te



ujerave te shiut. Ne teresi sistemi i largimit te ujerave atmosferike perbehet nga: ulluqe qe mbledhin ujerat ne tarrace, prej hinkave ujembledhese, kolonave te shkarkimit dhe pusetave te kontrollit.

Ulluqet duhet te sigurojne largimin e plote e te shpejte te ujerave te shiut e te debores si dhe reren, pluhurin qe mund te bien mbi tarrace.

Lidhja e hinkave me muret e fasades duhet te behet e tille qe te mos lejoje ne asnje menyre lagien e mureve te objektit. Uji eshte menduar te mblidhet ne ulluk dhe nepermjet hinkave te lidhet me kolonat e shkarkimit. Nje hinke mund te mbledhe ujerat nga nje siperfaqe prej 250-350 m<sup>2</sup>.

Referuar kushteve te projektimit rezulton se per objektin, hinkat dhe kolonat e shkarkimit (kolonat vertikale) do te vendosen ne skajet e objektit dhe ne qender si dhe ne drejtimin gjatesor te tij.

Ne kete menyre behet nje largim i shpejte dhe i panderprere te ujerave te ulluqeve e te kunetave te mbuleses se objektit si dhe per te mbajtur papastertite e ndryshme qe mund te bllokojne tubat. Tubat duhet te kene diameter jo me te vogel se ai i vete hinkes. Kunetat do te jene te mbuluara me zgare metalike.

Ujerat e shiut mbidhen ne nje pike dhe me pas me nje pjerresi prej 2 % ato largohen ne drejtim te kunetes kryesore te drenazhimit.



## 5 ELEKTRIKET

I gjithe sistemi elektrik duhet te jete i tille qe te stakohet ne nje pike te vetme ne katin perkates, e cila mund te arrihet lehte dhe te kete shenjat dalluese perkatese. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqise duhet te jete e afishuar ne panelin e stakimit.

Ndriçimi i emergjences duhet te futet automatikisht ne pune dhe te kete nje kohe pune te pakten 1 ore ne rast se stakohet tensioni.

Tipologja impiantistike qe aplikohet eshte e tille qe siguron qendrueshmeri te sistemit, parametra normale te kushteve te punes si dhe eficence ne kursimin e energjise.

Projekti parashikon furnizimin me energji elektrike dhe instalimin e sistemeve per ambjentet e objektit per te 3 katet. Llogaritjet elektrike jane realizuar ne baze te fuqive te pajisjeve mekanike te dhena nga projektuesi i sistemeve mekanike, fuqite e makinerive dhe pajisjeve te dhena nga invesitori si pjese perberese e procesit te prodhimit si dhe eshte parashikuar fuqia per ambientet teknike dhe te sherbimeveve.

### 5.1 Gjendja Ekzistuese

Objekti ka kabine Elektrike e cila vleresohet persa i perket kapacitetit te tij ne lidhje me kerkesat e fuqise se sistemit te ngrohjes dhe paisjeve te tjera qe vendosen. Dhe ne varesi te gjendjes se tyre (kapacitetit) dhe ne varesi te fuqise se instaluar te nevojshme te percaktuar, percaktohet dhe varianti me ekonomik per ushqimin e tyre me energji elektrike

### 5.2 Pershtatja

Ne keto ambjente mendohet te implementohet ngrohje qendrore dhe projektuesi duhet te marre ne konsiderate te gjitha kerkesat elektrike per nje funksionim normal.

Per sa i perket paisjeve te tjera, secila paisje , ka skemen elektrike perkatese ku percaktohet dhe fuqia e nevojshme. Ne varesi te skemes, fuqise dhe pozicionit ku do vendosen paisjet, jane percaktuar gjatesite, tipet dhe llojet e kabllove qe do te sherbejne per funksionim normal te ketyre paisjeve. Gjithashtu ne baze te vleresimit te sistemet elektrik ekzistues dhe ne baze te nevojave qe paraqesin keto aparatura, behet e mundur perzgjedhja e variantit me ekonomik.

Gjithashtu ndricimi ekzistues ne keto ambjente nuk eshte i pershtatshemEshte bere vleresimi nga projektuesit per gjendjen ekzistuese dhe eshte peshtatur me ndricim me intensitet te mjaftueshem, ekonomik dhe cilesor (sugjerojme ndricimin Led).



### 5.3 Te dhenat në lidhje me shperndarjen e energjise dhe shfrytezimit:

Sistemi i Tokezimit:

- Sistemi TN-S

Tensioni nominal Punes ( $U_e$ ) :

- 400 V (F/F)
- 230 V (F/N)

Tensioni nominal Izolimit ( $U_i$ )

- $\geq 690$  V

Tensioni nominal i impulseve ( $U_{imp}$ ) qe durojne pajisjet e tensionit te ulet :

- 24 kV

Tensioni testues i pajisjeve te tensionit te ulet:

- 1 min. 50 Hz 3500 V

Frekuenca :

- 50 Hz

Sherbimi nominal :

- I panderprere

Renja e tensionit midis burimit dhe ngarkeses

- Maksimumi 4% ne AC (nga klemat e daljes se transformatorit te ngarkesa me e larget)

Madhesia e kabllit te neutrit :

- ne sekcion te njejtë me ate te fazes per seksione deri ne 16 mm<sup>2</sup>.
- Sa ½ e sekzionit te fazes per seksione me te medha se 16 mm<sup>2</sup>.
- ne sekcion te njejtë me ate te fazes ne rast furnizimi te pajisjeve qe shkaktoje harmonika (PC, servera, motora).

Kufizimet e Zhurmes:

- Ne perputhje me ligjet dhe normat lokale



#### 5.4 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do te realizohet nga kabina ekzistuese qe eshte afer objektit. Ne panelin kryesor do te kryhet edhe komutimi i furnizimit rrjet-gjenerator dhe nga ky panel ne panelin e kuadrit kryesor do te vi linja me gjenerator nga ku e gjithe godina do te jetë e furnizuar me gjenerator, pervec pajisjeve HVAC te cilat furnizohen direkt nga rrjeti..

#### 5.5 Sistemi i shperndarjes

Nderlidhja e kateve realizohet me ane te shaftit vertikal qe do te realizohet ne dhomen teknike. Furnizimi nga panelet ne ngarkesen fundore realizohet me tub fleksibel plastik te tipit dhe dimensioneve te ndryshme. Gjate fazes se zbatimit duhet pasur kujdes qe te behet nje kordinim i sakte per hapsirat e nevojshme per pozicionin perfundimtar te saj. Gjate instalimit duhen perdorur te gjithe materialet e duhura.

#### 5.6 Fuqia

Percjellesat dhe kabllot plotesojne kerkesa te larta per tipin e izolimit, mbeshtjelljes, dhe percjellesve te specifikuar. Kabllot e ushqimit te tensionit te ulet per sistemin e shperndarjes 400/230V duhet te jene konform me sistemet EN dhe TNC/S. Tipi izolimit duhet te jetë rezistent ndaj lageshtires dhe nxehesise, i pershtatshem per temperature pune maksimale deri ne 70 grade celcius. Kabllot duhet te jene nje cope pa lidhje mes tyre pervec rasteve kur distancat jane me te medha se gjatesia maksimale e kabllit.

Te gjithe percjellesit te perdorur ne instalimet elektrike jane prej bakri.

Percjellesat dhe Kabllot qe do te perdoren gjate instalimeve elektrike do te jene te GENERAL CAVI ne konforme te standardeve CEI, IEC, CEI UNEL.

Sekcionet minimale te percjellesve: te gjitha prizat 2.5mm<sup>2</sup>/ instalimet e brendshme te ndriçimit 1.5mm<sup>2</sup>, 400V/230V,

Kodi me ngjyra:

- Faze: E zeze,gri, kafe (kabllot)
- Faze: E zeze (telat)
- Neutri: Blu e lehte
- Tokezimi mbrojtës: Verdhe/jeshile (shirita)

Te gjithe kabllot do te etiketohen sipas skemave te paneleve te shperndarjes me numrin e qarqeve te tyre. Nese kabllot ose tubat jane instaluar per nje perdonim te mevonshem ose per te kursyer hapesiren kjo duhet treguar ne etiketim. I njejti informacion do te shenohet ne te dyja anet e kabllove dhe kutive.



Etikimi realizoheted tek kuadrat dhe tek panelet per cdo automat per te treguar se kujt destinacioni ose linje i perket ai. Kjo behet per te lehtesuar punen personelit te mirembajtjes ne manovrimin e tyre dhe per te pikasur lehte avarite e mundshme.

### 5.7 Ndricimi

Ndricimi i ambienteve eshte projektuar qe te plotesoje kerkesat fotometrike te ambienteve sipas funksionit te tyre. Ndricimi do te realizohet ne pjesen me te madhe te objektit me ndricues 60x60 LED 4000K te cilet plotesojne kushtet tekniko-ekonomike lm/W dhe me llojet e ndricueseve te propozuar ne projekt. Keto ndricues do te jene inkaso per montim ne tavan te varur me pllaka 60x60. Ne tualete do te jene spote rrrethor inkaso LED 23cm. Ne tualete e perbashketa komandimi i ndricimit do te realizohet me ane te detektoreve te levizjeve ne ambjente.

Ne instalimin e ndricimit te brendshem duhet pasur parasysh ruajtja e uniformitetit ne nivelin mbi 0.4.

#### Ndricues LED 60x60 Inkaso

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit : 3400lm,
- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Montimi : inkaso
- Shkalla e mbrojtjes : IP40, IK02
- Karkasa: metalike
- Mbulesa optike : pexiglas opal
- Temperaturë pune: nga -10°C deri +40°C
- CRI : 80+
- Eficencia: >90lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

#### Spot Inkaso 13W

- Furnizimi: 230V / 50Hz me ushqyes
- Fluksi ndricimit 1100lm



- Ngrohtesia e ngjyres : 4000K
- Eficenca : >80lm/w
- Certifikimi : CE
- Ngjyra: e bardhe

Ndricimi antipanik do te jete i shperndare ne korridore per te bere nje mbulim per ndricim te nevojshem gjate momenteve qe nuk ka energji ne objekt . Ndricuesit do te jene LED me nje autonomi minimale prej 3 oresh.

Ndricimi Exit eshte vendosur ne rruget e kalimit per te treguar rrugen me te shkurter te daljes dhe ne bashkveprim me sistemin e zjarrit qe ne rast evakuimi te tregoje daljet nga portat e emergjences. Keto ndricues do te kompozohen me etiketat perkatese qe tregojne rrujen e kalimit ne rast evakuimi si dhe tek dyert dalese do te jene mbi dyer me etiketen EXIT. Ndricuesit Exit duhet te jene LED me autonomi deri ne tre ore.

#### Ndricuesit e Emergjencave

- Ndricues LED
- Bateri NiCd
- Autonomi 3h
- Koha karikimit 12h
- Certifikimi : CE
- Shkalla mbrojtjes IP42
- Me tregues gjendje karikimi llamp LED jeshil-kuq

#### **5.8 Sistemi detektimit te zjarrit**

Sistemi i detektimit te zjarrit duhet te jete ne perputhje me kerkesat e standartit EN 54-13, standarte vendase ose standarte te tjera ekuivalente. Sistemi duhet te kryeje keto funksione: detektimin automatik te zjarrit, procesimin dhe ruajtjen e informacioneve te marra nga sensoret, sinjalizimin ne menyre efektive akustike dhe vizuale, mundesine e dhenies se alarmit ne menyre manuale nga pika te aksesueshme ne rrujen e evakuimit dhe detektim dhe sinjalizim i shpejte i defekteve te vete sistemit.

Sistemi i zjarrit do te jete i adresueshem dhe i ndare ne tre loop-e me sistem bus per marrjen e te dhenave dhe furnizimin nepermjet tij te sensoreve. Furnizimi i pajisjeve me rele eshte parashikuar te realizohet me vete me ane te ushqyeseve vetjak. Loop-et jane ndare ne tre zona ku cdo kat do te jete nje zone.



Sensoret e detektimit do te jene per detektim tymi per sensoret qe do te instalohen poshte tavanit te varur si dhe sensore nxehesie per ato qe do te instalohen brenda tavanit te varur. Per sensoret qe do jene brenda tavanit te varur duhet te vendosen sinjalizues LED ne drejtim te tyre poshte tavanit qe te tregojne ne menyre vizuale nqs kane vepruar ato sensore apo jo.

Butonat e dhenies se alarmit te zjarrit jane vendosur ne rruget e kalimit te evakuimit ne bashkeveprim me sinjalistiken e ndricimit exit, dhe duke respektuar largesite maksimale 45 m qe nje person duhet te kaloje qe te arrije nje pike thirrje te kerkuara nga normat.

Sirenat e brendshme me sinjalistike akustike dhe vizuale vendosen ne menyre te tille qe niveli i kerkuar i tingullit te jete me i madh se 65 dB dhe te pakten 5 dB mbi nivelin e tingullit te ambientit.

Paneli i detektimit i zjarrit do te jete i vendosur ne dhomen teknike ne katin 0 duhet te jete I pajsur me nje monitor LED ku te afishoje te gjithe eventet si dhe te lehtesoje sa me shume perdorimin e tij per personelin mirembajtes.

Per sistemin e detektimit te zjarrit te referohen vizatimet e projektit.

#### Centrali I kundrazjarrit

- I adresueshem
- Montim ne mur
- Kompletuar me display LED me ngjyra
- Me menu interaktive me mundesi perzgjedhje ne disa gjuhe (anglisht, italisht etj)
- Modular me mundesi zgjerimi modulesh minimumi me 3 module LSN per 3 LOOP-e
- I pajisur me modul kontrolli baterish per karikimin dhe per te kontrollu gjendjen e tyre
- Certifikimi VDS
- Database per regjistrimin deri ne 10000 evenete
- Port Ethernet per nderlidhje me kompjuter, BMS etj

#### 5.9 Sistemi Tokezimit dhe Rrufepritesit

Sistemi i mbrojtjes ndaj shkarkimeve atmosferike do te realizohet me tokezim natyral duke shrytezuar zbritjet vertikale qe do te mbyllen me nje perimetral gjate gjithe objektit per te realizuar shkarkimin e rrimes si rezultat nga goditjet e rrufeve. Ndertohet nje sistem perimetral me percjelles te zhveshur bakri qe do jete ne nje thellesi minimale 0.5m me qellim



zvogelimin e tensioni te hapit. Ne impiantin e tokes duhet te lidhen armaturat metalike te nderteses, tubacionet metalike te hyrjes per ujin, gazin, etj... Duke qene se sistemi i furnizimit me energji elektrike eshte 10/ 20 kV, tokezimi i mbrojtjes do te jete i njeje me tokezimin e punes. Pra buloni i nulit te trafos do te lidhet me percjellesin e tokes . Nese nuk realizohet vlefta e rezistences se tokes  $R \leq 4 \Omega$ , me numrin e elektrodave te paraqitura ne projekt, atehere duhet te realizohet tokezim artificial, duke perpunuar vendin ku do te behet tokezimi. Sistemi i rrufepritesit ne tarrace do te ndertohet me shtiza rrufepritesit te projektuar per te mbuluar zonen e godines referuar vizatimit perkates. Shtizat e rrufepritesit do te ngrihen nga tarraca 1.5m ne menyre qe te kemi nje mbulim sa me te gjere. Duhet pasur parasysh qe te tokezohen te gjithe paisjet dhe elementet metalik qe ndodhen ne tarrace (paisjet HVAC) per ti mbrojtur nga goditjet direkte ose indirekte.

### **5.10    Normat Ligjet dhe rregullat**

Karakteristikat e pajisjeve, komponenteve dhe materialet e nevojshme për të përfunduar punimet, duhet te jenë në përputhje me karakteristikat e treguara ne kete dokument, duke respektuar ligjet, rregulloret dhe normativat (CEE, UNI, EN, ISO, INAIL, CEI).

Të gjitha pajisjet, komponentët, materialet duhet te jene te reja dhe me cilësine më të mirë në treg, te produhuara dhe përpunuara nga një profesionist i përshtatshem. Te jenë të destinuara per sherbim dhe karakteristikat e performancës se kerkuar të jene te larta.

Të gjitha materialet dhe furnizimet të jene te pajisura mundësisht me shenjën e cilësisë në përputhje me UNI EN ISO 9001 dhe / ose produkte të certifikuara nga organizata, dhe , ndonëse të dobishme, kanë CE shënuar sipas Direktivave te KE 392/89, të ndryshuar, dhe të jenë në përputhje me dispozitat e dekretit legjislativ Nr 81/2008 në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të vendosura nga Direktiva.



## 6 IMPIANTI I NGROHJES QENDRORE I AMBIENTIT

Godina në praktikë përbën një ndërtesë që klasifikohet e tipit Ndërtesë Publike dhe është vlerësuar sipas disa faktorëve specifike që lidhen me funksionimin e saj.

Për sa i përket Klimatizimit (Ngrohjes dhe Ftohjes) së kësaj ndërtese, elementët teknike të vlerësimit janë:

- (I) Çfarë ofron Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar
- (II) Vlerësimi i ngarkesave termike
- (III) Skema e zgjedhur

### 6.1 Gjendja Ekzistuese

Ne ambientet aktuale te godines nuk ka sistem qendror ngrohje.

### 6.2 Pershtatja e Ambjentit

Ne keto ambjete te cilat do riorganizohen duhet te sigurohen kushtet e nevojshme per ngrohje ftohje te ambjentit. Pra projektuesi ka vleresuar gjendjen aktuale dhe ka percaktuar masat e nevojshme per te siguruar një funksion normal te ketyre ambjenteve pershtatur me funksionin qe do kene. Eshte menduar sistem ngrohje ftohje qendrore per gjithe ambientet.

### 6.3 Të Përgjithshme

IMPIANTI I NGROHJES QENDRORE qe do te realizohet do te kete te gjitha karakteristikat e një impianti modern ku harmonizohen ne menyre te perkryer standartet maksimale per një funksionim sipas kerkesave me kosto minimale perdorimi, harxhimi e mirembajtje. Kjo eshte bere e mundur duke zgjedhur teknologjitë më të përparuara si ne tipin e pajisjeve ashtu edhe ne sistemin e komandimit .

Punimet qe do te kryhen, ne menyre te per gjithesuar permblidhen ne ndertimin e Centralit Termik, realizimin e rrjetit te ri te tubacioneve dhe radiatoreve per ngrohjen e kopshteve dhe cerdheve, dhe realizimin e një sistemi komandimi te centralit termik me ane te panelit, i cili do te mundesoje funksionimin dhe monitorimin e parametrave te impiantit dhe te pajisjeve te Centralit Termik.

Per sa i perket karakteristikave teknike te impiantit qe parashikohet te realizohet, pavec normave qe jane te detyrueshme nga ligjshmeria ne fuqi, jane patur parasysh normat teknike ekzistuese.



#### 6.4 Parametrat Kryesor te Projektit

Diferenca e temperaturave, tipologja e strukturave ekzistuese, gjeometria e nderteses dhe ekspozimi i saj percaktojne ngarkesen termike dhe nevojat energjitike te nderteses ne tërësi. Perpunumi i te dhenave, llogaritjet dhe elaborimi i rezultateve jane kryer duke perdorur "software" profesionale ne fushen e termoteknikes.

Duke ju referuar kritereve te përdorimit dhe te funksionimit të impiantit dhe per te garantuar njekohesisht komfortin me te mire ambiental i jemi referuar parametrave termohigrometrike te meposhtem:

a - Temperatura e ambientit të jashtëm:	-1°C ( bulb i thatë )
b - Temperatura e ambienteve të brendshme :	+20°C ( bulb i thatë )
c - Nderrimi i ajrit ne nje ore:	
c1 - Ambientet e ndryshme :	0,5-1 vëll / ore (>20 m <sup>3</sup> /ore/person )
c2 - Sherbimet higjenike :	2.0 vëll / ore
d - Karakteristikat e vektorit termik:	
d1 - Tipi i vektorit termik :	Ujë i ngrohtë
d2 - Temperatura e dërgimit ne radiatorë:	85°C
d3 - Mënyra e qarkullimit :	E detyruar

#### 6.5 Centrali Termik

Ne lokalin e kaldajes do te vendosen tubacionet kryesorë te shperndarjes, pompat e qarkullimit dhe kuadri elektrik. Te gjitha lidhjet do te realizohen ne menyre te tille qe te lejojne nderprerjen e çdo makine e linje, kontrollin e vibracioneve si dhe kontrollin e parametrave hidraulike e termike gjate funksionimit.

Me termin Çentral Termik kemi konsideruar te gjithe kompleksin e komponenteve te qe do te instalohen, i cili shërben per te ngrohur dhe qarkulluar ujin qe transporton energjine termike te prodhuar nga gjeneruesi i nxehtesise që, me tej, per thjeshtesi do ta quajme kaldaje.



Per te relizuar nje shperndarje dhe nje qarkullim me te mire te ujtit neper radiatoret ekzistues, impianti ne teresi do te realizohet me “ Ene zgjerimi te mbyllur ”.

Kaldaja do te kete fuqi te dobishme sipas llogaritjeve per cdo godine, rendiment te larte dhe do te jetë e tipit me pellet.

Per kaldajen do te realizohet nje kanal prej llamarine te zinkuar veshur me “lesh xhami” me spesor 25 mm te aluminuar në një nga faqet, i cili do te mbledhë te gjitha produktet e djegjes drejt oxhakut.

Per te garantuar stabilitetin e ambienteve dhe te personave ne raste anomalie, secila nga kaldajat do te jetë e pajisur me këto KOMPONENTE TE SIGURISE :

- Valvola e sigurimit me veprim mekanik, e cila ka funksion te mbroje komponentet e impiantit kur presioni rritet tej nje vlere te caktuar,
- Termostati i bllokimit me veprim elektromekanik, i cili nderpret furnizimin me energji elektrike te motorit te bruciatorit ne rastet kur temperatura rritet tej nje vlere te caktuar,
- Presostati i bllokimit me veprim elektromekanik, i cili nderpret furnizimin me lende djegese
- Valvola e nderprerjes se lendes djegese me veprim elektromekanik e cila ka per qëllim nderprerjen e fluksit të lëndës djegëse kur temperatura rritet pertej nje vlere te paracaktuar, e cila është e fiksuar ne fabrike gjate fazes se proves se valvoles.

Per kontrollin e temperaturës dhe presionit, parashikohet montimi termometrave dhe manometrave.

Impianti do te jete i pajisur me termostat per rregullimin e temperatures, ndares ajri me valvol per shkarkim automatik, sistem automatik te ushqimit me uje, 1 enë zgjerimi te mbyllur me membrane per te garantuar bymimin e ujit gjate rritjes se temperatures pa rritje te presionit.



Llogaritja e kapacitetit te enes se zgjerimit te mbyllur me membranë:

Duke patur parasysh nje temperature maksimale te ujit ne dalje nga kaldaja prej 80°C dhe vleren e zgjedhur te tarimit te valvoles se sigurimit te barabarte me 3.5 bar , vellimi i nevojshem i enës se zgjerimit te mbyllur llogaritet sipas relacionit :

$$C \times e$$

$$Vëllimi = \frac{Pc + 1}{1 - \frac{|Pe/v|}{PV + 1 + |Pe/v|}}$$

ku:

0.0327 ështe koeficienti i bymimit te ujit nga 10°C në 90°C.

C Sasia e pergjithshme e ujit në impiant 1770.0 litra

Pi Disniveli kaldaje - pika me e larte e imp. ( p. hidrost. ) 10.0 metra

Pc Presioni fillestar (= presionin e enes se zgjerimit) 1.80 Kg/cm<sup>2</sup>

P Presioni i punes ( me i vogli kaldaje / ene zgjerimi.) 5.00 Kg/cm<sup>2</sup>

PV Presioni i valvoles se sigurimit ( tarimi ) 3.50 Kg/cm<sup>2</sup>

|Pe/v| Disniveli ene zgjerimi - valvola (+/-) + 0.8 metri 0.08 Kg/cm<sup>2</sup>

Zgjidhet nje ene zgjerimi e mbyllur e tipit me membrane me kapacitet 200 litra.

Llogaritja e karakteristikave te valvoles se sigurimit:

Karakteristikat e valvoles se sigurimit zgjidhen sipas relacionit te me poshtem:



Q

W = \_\_\_\_\_

500

ku:

Q - Fuqia e dobishme e kaldajes kkal/ore

W - Sasia minimale që duhet te shkarkoje valvola e sigurimit

Valvola e sigurimit, e cila duhet instaluar në një distance jo me te madhe se 1 meter nga kaldaja

zgjidhet me karakteristikat e meposhtme:

Sasia uje - shkarkuese e valvoles: 984.23 kg/ore

Diametri i brendshem i vrimes se shkarkimit: 25 mm

Presioni i taruar 3.5 bar

Mbipresioni i shkarkimit: 10% 0.35 bar

Presioni nominal i shkarkimit: 3.85 bar

## 6.6 Qarku Hidraulik

Nga kolektoret kryesore te shperndarjes derivojne qarqet hidraulikë qe ushqejne zonat e nderteses. Me termin "qark hidraulik" kemi konsideruar teresine e tubacioneve brenda lokalit te kaldaiave te lyera me boje ( ne rastin e tubave te "zi" ), te termoizoluara dhe te fiksuar; valvolave dhe saraçineskave; pompave e instrumentave mates. Qarkullimi i ujit te ngrohte te prodhuar nga kaldaja do te realizohet me ane te çiftit te elektromompave nga te cilat njera eshte rezerve.



Rjeti i tubacioneve eshte llogaritur duke i imponuar vektorit termik nje shpejtesi gjithmone me te vogel se 1.5 m/s. Karakteristikat e elektropompave jane percaktuar duke patur parasysh humbjet e presionit te koncentruara dhe te shperndara per gjate rruges qe pershkojne tubacionet e ushqimit te elementeve terminale, te cilat konsiderohen me sinjifikativë.

### **6.7 Elementet e terminalit**

Me kete term kemi konsideruar komponentin fundor, ashtu siç furnizohet nga prodhuesi, i cili transmeton ne ambient energjine termike te prodhuar ne çentralin termik dhe te transportuar nga qarku hidraulik. Ne rastin tone elementet terminale do te jene radiatoret prej elementesh alumini.

Ne funksion te nevojave termike qe ka çdo lokal , eshte llogaritur kapaciteti i njesise terminale duke konsideruar nje difference temperature midis hyrjes dhe daljes prej 20°C dhe temperaturë ne hyrje 85°C.

Secili radiator do te jetë i pajisur me valvolen me rregullim termostatik, detentorin dhe valvolën e shfryrjes se ajrit. Fuqia termike e emetuar ne ambient nga secili radiator i referohet çertifikates se karakteristikave teknike te radiatorit, te leshuar nga organizmat perkates te vendit ku eshte prodhuar radiatori.

### **6.8 Inpianti Elektrik**

Impianti elektrik i sistemit te ngrohjes perfshin Panelin Elektrik sipas skemes se perqatitur nga prodhuesi. Nga paneli derivojne kavot elektrike me seksion te pershtatshem ne tubacione PVC, dhe ushqejne me energji elektrike furnizuesin automatik, elektropompat si dhe linjat elektrike te impiantit te komandimit qe lidhen me sondat e valvolen tredegeshe manjetike.

### **6.9 Kolaudimi**

Kolaudimi i cili duhet parashikuar ne akord te plete me investitorin dhe drejtuesin e punimeve te emeruar nga investitori, duhet te perfshi te grupe operacionesh:



**1 - Verifikimi cilesor dhe sasior nepermjet te cilit qartesohet që materialet ne fazen e furnizimit i pergjigjen nga pikpamja sasiore dhe cilesore pershkimeve te projektit, dhe detyrimeve te kontrates.**

**2 - Provat paraprake** te cilat perefshijne proven hidraulike ne te ftohte dhe proven e bymimit termik ne te nxehte. Prova hidraulike, e cila kryhet para termoizolimit dhe mbylljes se kanaleve te kalimit te tubacioneve, konsiston ne mbushjen me uje te tubacioneve dhe mbajtjen nen nje presion 2 here me te madh se presioni normal i funksionimit te impiantit per ne periudhe prej 12 oresh. Vlera e presionit ne rastin e impiantit ne fjale eshte 3.0 bar, e cila duhet te ruhet per periudhen e mesiperme pa kerkuar asnjelloj nderhyrje. Rezultati konsiderohet pozitiv kur nuk verifikohen humbje apo variacione permanente te vleres se presionit.

Prova e bymimit termik ne te nxehte kryhet ne temperaturen maksimale te funksionimit te impiantit dhe mbahet ne nje temperature te tille gjate gjithe kohes qe nevojitet per inspektimin e tubacioneve, te radiatoreve dhe te enes se zgjerimit. Pas renies se temperatures ne nje vlore sa 2/3 e vleres se proves, rikryhet prova ne temperaturen maksimale te funksionimit. Rezultati i proves konsiderohet pozitiv kur bymimet dhe tkurrjet nuk shkaktojne deformime, rrjedhje dhe nuk verifikohen deformime te nje natyre apo intensiteti te cilat, duke u perseritur, mund te shkaktojne dëme per impiantin apo ambientin.

**3 - Kolaudimi perfundimtar** dhe efikasiteti i funksionimit te tij dhe te pjeseve qe e perbejne duhet kryer pas mbarimit te punimeve dhe ne kushte klimatike te pershtatshme.

Ne perfundim te çdo prove apo kolaudimi duhet perpiluar nje proces verbal i cili pershkruan operacionet e kryera dhe rezultatin e arritur.



## 6.10 Instruksione per Funksionimin dhe Mirembajtjen

Montuesi i impiantit me mbarimin e punimeve eshte i detyruar te furnizoje prane zyres apo organeve teknike te investitorit dokumentacionin e meposhtem:

Kontrate ku te marre persiper garancine 1 vjecare te impiantit ne teresi.

Certifikatat e garancise se leshuara nga ndermarrjet prodhuese te pajisjeve .

Manuale te perdorimit, funksionimit dhe mirembajtjes se impiantit ne teresi dhe komponenteve te veçante te tij.

Skemat funksionale hidraulike dhe elektrike ( ne rast se nuk ndryshojne jane ato te projektit).

Listen e ndermarrjeve prodhuese apo tregetuese te komponenteve te impiantit si dhe te dhena per kontaktimin sa me te shpejte te tyre.



## 7 MBROJTJA KUNDER ZJARRIT

Ky sistem, eshte shume i rendesishem per ndertesen ne teresi dhe duhet te jete i nderlidhur me permasimet strukturale / arkitektonike, me sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit dhe evakuimin e personave.

Ata do te perzgjidhen ne funksion te zgjidhjes arkitektonike, duke siguruar zbatimin e normave per mbrojtjen kundra zjarrit, ne te dy rastet, ne aspektin pasiv te sistemit kundra zjarrit ( i lidhur me karakteristikat e nderteses) dhe ne aspektin aktiv te sistemit kundra zjarrit ( i lidhur me instalimet elektrike dhe mekanike te mbrojtjes kundra zjarrit) i cili eshte objekt i instalimeve mekanike.

Qëllimi i këtij impianti është të mbrojë personelin dhe nxenesit duke siguruar nëpërmjet **masave pasive dhe aktive** evakuimin dhe shpëtimin e tyre.

**Masat pasive** perbejne tërësinë e masave arkitektonike dhe konstruktive duke zgjidhur dhe përcaktuar drejt rrugët e shpëtimit në korridore, shkallë, daljet e emergjences, shkallë të brendshme të mbrojtura, si për personelin dhe nxenesit, evakuimin e tyre, sigurimin e kompartimenteve të mbrojtura nga zjarri dhe tymrat nëpërmjet strukturave ndërtimore si mure, tavane, dysheme dyer etj, me rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj zjarrit (REI), sipas normave etj. Rrugët e evakumit dhe shpëtimit janë të plotësuara me sinjalistikën përkatëse sipas normave.

**Masat aktive** përbëjnë qëllimin e projekteve mekanike dhe konsiston në ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit me qëllim mbrojtjen e personave te akomoduar, personelit si dhe mbrojtjen e strukturave dhe vetë godinës.

Për këtë qëllim janë projektuar sistemet e shuarjes së zjarrit me uje nëpërmjet sistemeve me hidrantë, me sistemet e shuarjes me gaz ose pluhur me pajisje dhe bombula portative në përputhje me kategoritë e zjarrit si dhe masa të tjera që kompletojnë impiantet e tjera elektromekanike, të cilat shërbejnë për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe të tymrave si dhe evakuimin e këtyre të fundit. Kështu në projektet mekanike janë parashikuar masa specifike si vendosja e damperave të zjarrit dhe të tymit në kanalet e ajrit të kondicionimit në kalimet vertikale dhe horizontale të tyre etj.



Implanti i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në përputhje me standarde dhe normat lokale, si dhe normave italiane CNVVF/CPAI UNI 9485, etj, si dhe "Prevenzione Incendi Ospedali" D.M 18 Septembre 2002.

## 7.1 Gjendja Aktuale

Ne ambientet e kesaj godine nuk ka sistem hidrantesh te mbrojtjes kundra zjarrit por vetem portative me pluhur.

## 7.2 Pershtatja e Ambienteve

Projektuesi ka vleresuar sistemin aktual te mbrojtjes kundra zjarrit dhe ka percaktuar me ane te projektit te gjitha masat e nevojshme qe duhen marre ne menyre qe ky sistem te jetet funksional.

Per kete qellim, per sistemin mekanik te mbrojtjes kundra zjarrit ( me uje), para se gjithash duhet te sigurohet: depozitim i ujit ( sasia e ujit e cila llogaritet per te gjithe ndertesen) dhe ambienti mekanik i ndertesen, sigurohet rrjeti i kolonave per mbrojtjen kundra zjarrit me hidrante, per te siguruar funksionimin e perkohshem te hidrantave me pak te favorshem ne varesi te gjykimit te projektuesit, me 120 l / per ore, me presion shkarkimi 2 bar, bazuar ne skemen dalese te sigurise per evakuimin, shkallevje dhe hidrantet e jashtme.

Pompat projektohen ne menyre te atille te fillojne punen ne menyre automatike, per te siguruar ne rastin e nje zjarri rrjedhen e presionin e ujit.

Rrjeti i brendshem dhe i jashtem i tubave per furnizimin me uje realizohet nga materiale te pershtatshem, te perzgjedhura me gjykimin e projektuesit sipas normave dhe standardeve teknike.

Sigurohet mundesa e lidhjes ndermjet sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit me autopompe per lidhjen me Zjarrefikeset.

Projekti permban elementet e meposhtem:

- **Skema ku tregohen :**

Sistemet dhe pajisjet e diktim -sinjalizimit te zjarreve

Mjetet dhe paisjet e shuarjes se zjarrit

Skemen e evakuimit te detyruar te punonjesve ne rast zjarri



### 7.3 Kriteri të përgjithshme projektuese

**Implanti i mbrojtjes nga zjarri** është konceptuar që të ndërtohet në përputhje me kërkesat dhe normat për përdorimin e teknikave dhe pajisjeve shuarëse që do të aplikohen mbi bazë të specifikave dhe klasave të zjarreve të mundshme ne objekt.

**Në analizë të zjarreve** të mundshme rezulton se sistemi i shuarjes me ujë nëpërmjet hidrantëve zënë pjesën më të madhe në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, por gjithashtu e shoqëruar me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lëndë shuarëse të gaztë dhe pluhur, mbi bazë të klasave të zjarrit.

Për **sistemin e shuarjes me ujë**(hidrantët), efikasiteti i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit varet në një shkallë të lartë nga mjaftueshmëria e kapacitetit të ujit dhe presionit të tij, të cilët duhet të jenë të mjaftueshëm për të mbrojtur sipërfaqet specifike mbi bazë të sasisë së nevojshme të ujit, kohës së veprimit etj. Ndërsa për sistemin e shuarjes me mjete portative efikasiteti i tyre konsiston në vatra zjarri të lokalizuara.

Faktorët përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë :

- Natyra dhe përmasa e zjarrit;
- Madhësia e zonës që do të mbrohet;
- Mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit;
- Kërkesat dhe normat sipas CNVVF/CPAI UNI 9485 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

Për të siguruar funksionet dhe autonominë e sipërpermendur impianti aktiv i mbrojtjes kundër zjarrit është i përbërë nga :

- a) centrali teknik i përbërë nga rezerva ujore dhe grapi i presurizimit,
- b) rrjeti i shpërndarjes dhe hidrantët,
- c) pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),
- d) pajisjet e kontrollit të zjarrit dhe mospërhapjes së tymit.

### 7.4 Klasifikimi i klasave të zjarrit

Për të përdorur agjente shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit.



Në bazë të normave/standardeve bashkëkohore, pajisjet shuarëse të zjarrit janë klasifikuar në pesë klasa. Standarti europian për këta shuarsa dallon klasat e mëposhtme:

**Klaza A** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të ngurtë sikurse dërrasë, letër, plastik, tekstile,etj.

**Klaza B** - vlerëson zjarrë që e kanë origjinën prej materialeve të längshëm sikurse benzenë, benzole, naftë, alkol, vajra etj.

**Klaza C** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve të gazta sikurse metan, propan , butan GPL etj.

**Klaza D** - vlerëson zjarre që e kanë origjinën prej materialeve metalike si alumin, magnez, sodium, etc.

**Klaza E** - vlerëson zjarre nga pajisje elektrike që janë nën tension .

### **7.5 Sistemi i shuarjes me ujë - me hidrantë**

**Sistemi ishuarjes me uje** eshte sistemi kryesor i impiantit te shuarjes nga zjarri i përdorur ne objekt. Kjo zgjedhje eshte ne përputhje te plote me vetitë shuarës te ujit per **zjarre te klasës A** .

Sistemi i shuarjes me ujë është i përbërë nga centrali teknik dhe rrjeti i shpërndarjes.

**Centrali teknik** përbërëhet nga:

- rezerva ujore
- grapi i presurizimit,

**Rrjeti i shpërndarjes** përbëhet nga :

- rrjeti i shpërndarjes dhe kollonat

**Pajisjet fikëse** përbehen nga:

- hidrantët

### **7.6 Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative**

- pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),



## 7.7 Rezerva ujore

**Sasia e ujit** të depozituar për mbrojtjen kundër zjarrit është përcaktuar duke marrë në konsideratë llogaritjet e konsumit të ujit nga numri i njëkohshëm i hidrantëve në punë në përputhje me numrin e kollonave të rrjetit shpërndarës, numrit te hidrantëve njëkohësisht ne pune per cdo kollone pra, nga numri total i hidrantëve njëkohësisht ne pune.

**Konsumi i ujit** të çdo hidranti **UNI 45** është **120 l/min** dhe per te gjithë hidrantët njëkohësisht ne pune parashikohet prurja që duhet të sigurojë grupi i presurizimit, ndersa koha në të cilën duhet të garantohet kjo prurje per funksionimin e te gjithe hidrantëve është parashikuar **60 min**. Nëpërmjet këtyre dy parametrave baze përcaktohet **Sasia e rezerves ujore** per mirëfunksionimin e sistemit te mbrojtës nga zjarri me hidrantë.

**Rezerva ujore** ne kete rast eshte menduar te perbehet nga depo uji e cila do te pozicionohet ne katin nentoke ne ambientin teknik ku kapaciteti eshte perllogaritur ne baze te kerkesave te nevojshme te sistemit sipas normave ne fuqi.

**Dhomat e depos** së ujit do të kompozohen si më poshtë:

- Tubacionet e furnizimit me ujë, në të cilat do të vendosen valvola ndërprerëse që lidhen me galexhantët mekanik që kontrollojnë nivelin e mbushjes;
- Tubacione e terheqjes(thithjes) se ujit nga depozitat ku do të instalohen valvola ndërprerëse me të gjithë aksesorët që kërkojnë centralet e pompave përkatëse;
- Tubi i shkarkimit (tropo pieno);
- Tubi i boshatisje që do të instalohen në pjesën e poshtme të rezervuarit. Ai duhet të jetë i pajisur me një valvul kontrolli;
- Tregues niveli, etj.

## 7.8 Grupi i presurizimit

**Grupi i presurizimit** është kompozuar në perputhje me kérkesat e projektit per te siguruar prurjen e nevojshme per furnizimin e te gjithë hidrantëve njëkohësisht ne pune. Pompa është me parametra dhe karakteristika teknike e destinuar përrjetin e hidrantëve. Pompa është e kompozuar nga një elektropompë, e ushqyer nga rrjeti normal elektrik, një motopompe e cila do te jete back-up ne rastet e renies se zjarrit dhe ne munges te furnizimit me energji elektrike te pompes kryesore dhe nga pompa Jockey. Grupi i presurizimit i pajisur me panel kontrolli i cili komandon secilën pompë dhe pajisjet e tyre komandojnë në mënyrë të percaktur, nisjen, ndalimin e pompës duke realizuar njëkohësisht monitorimin dhe



sinjalizimet e nevojshëm duke përcaktuar kështu statusin dhe kushtet e stacionit të pompimit.

**Parametrat teknik** të grupit të presurizimit llogaritur mbi bazë të prurjes së kërkuar per cdo hidrant të barabartë me **120 l/min**, presionit në dalje në hidrantin në pozicionin hidraulik më të disfavorshëm të rrjetit të barabartë me **2 bar** dhe humbjeve të rrjetit mbi bazë të formulës Hazen -Williams.

Pompa e mësipërme është zgjedhur mbi bazë të produkteve të certifikuara të normave europiane dhe **Standardit EN 12845**.

## 7.9 Rrjeti shpërndarës

**Rrjeti i shpërndarjes** është i ndërtuar me tuba dhe rekorderi të cilat respektojnë normat dhe kushtet teknike për impiantin e mbrojtjen kundër zjarrit. Rrjeti i shpërndarjes është furnizuar nga një linjë kryesore që vjen nga grapi i presurizimit në zonen teknike, dhe shpërndahet vertikalisht në kollonat e hidraneve. Në godinë do të ngrihen kollonat që do të furnizojne me ujë hidrantët të pozicionuar nëpër kate, ne pozicione te përcaktuara per te mbuluar te gjithë sipërfaqen nga zjarri. Gjatë projektit është marrë parasysh që rrjeti i tubacioneve të ketë minimumin e numrit të përkuljeve dhe të kthesave të detyrueshme. Gjithashtu janë marrë parasysh zgjidhjet konstruktive të godinës. Tubat janë të pozicionuar dhe të siguruar për të minimizuar dëmtimet dhe vibrimet.

**Linjat e rrjetit** të shpërndarjes janë ndërtuar me tub çeliku të zi pa tegel (Manessman) me bashkim me saldim(ose fileto), me rakorderi (kurba, tee,) gjithashtu me bashkim me saldim (ose fileto), të trajtuar në sipërfaqe me pastrimin e ndryshkut dhe vajrave, të lyera me bojë antindryshk dhe bojë të kuqe RAL 3000 sipas normave. Fiksimi i tyre bëhet me fasheta sipas normave në distanca të përcaktuara, ne kalimet horizontale çdo 10D, në kalimet vertikale çdo 15D.

## 7.10 Hidrantët

**Hidrantët e zjarrit të tipit kasetë me ujë** janë përgjedhur si pajisje fikëse në sistemin e shuarjes së zjarrit për **klasën A**. Ata janë llogaritur të kenë në dispozicion të tërë sasinë e ujit të nevojshëm në rastin e shfaqjes së zjarrit. Kjo është bërë e mundur gjatë hartimit të projektit të instalimit të hidraneve në brendësi dhe jashtë godinës. Ata janë instaluar në çdo kat në brendësi të godinës dhe janë lehtësish të evidentueshme, praktikë për tu përdorur në rastet e shfaqjes së zjarrit.



**Hidrantet DN 45** janë të përbërë prej saraçineskës ndërprerëse, tubit të gomuar për kalimim e ujit me një gjatësi prej 30 m si dhe hundëza. Të gjitha këto pajisje janë të vendosura në boksin prej llamarine çeliku, të lyer me bojë të kuqe RAL 3000 të pjekur, i cili vendoset në brendësi të murit ose jashtë tij (sipas zgjidhjes në projekt) dhe në një lartësi 110 cm nga dyshemeja sipas normave. Ata janë të shoqëruar me kartelat e sinjalistikës përkatëse, me butonin e alarmit.

### 7.11 Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot

Pajisjet e lëvizshme të shuarjes së zjarrit

- Bombola portative me gaz CO<sub>2</sub>, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, E**.
- Bombola karrelato me pluhur, për përdorim në **zjarret e klasave A, B, C, E**.

**Fikëse me CO<sub>2</sub>** përdoren për mbrojtjen në rast zjarri pikërisht për karakteristikat mbytëse të këtij gazi dhe variojnë nga 2 deri në 5 kg. Mbi flakën ky lloj shuarësi ushtron një efekt freskues dhe mbytës. Ky tip shuarësi përmbanë CO<sub>2</sub> në formë likuide dhe jo të gaztë të presurizuar. Në momentin e funksionimit një valvol lëshon CO<sub>2</sub> që ndodhet në fikës i cili arrin në një difuzor i cili e shpërndan në temperaturë -70 °C nën formën e një reje karbonike ose akulli të thatë. Cilësia kryesore e fikësve me CO<sub>2</sub> është se ky gaz nuk shkakton asnje veprim korroziv dhe nuk lë pasoja pas përdorimit, nuk ndot dhe në përgjithësi ruan objektet nga dëmtimi. Këto bombula me gaz CO<sub>2</sub> janë aplikuar në ambientet e brendshme të godinës së konviktit, të pozicionuara sipas projektit.

**Fikset me pluhur** janë pajisje që përdoren në rast zjarri, të cilët zakonisht janë të adoptuar për të gjitha tipet e zjarrit - kjo shpjegon edhe arsyen se përsë keto pajisje i gjemë pothuajse në çdo ambient. Pluhuri është një material solid i ngjashëm me pudrën. Për ta bërë sa më funksionale kapacitetin e tyre fikës supozohet që mesatarisht një fikë prej 6 kg pluhur është në gjëndje që të shuajë rreth 200 litra substancë likuide të djegshme, e cila mund të jetë benzinë ose alkoll dhe është e aftë të fikë edhe zjarre me origjinë gazi. E meta e tyre e vetme që kufizon përdorimin e tyre është në efektet anësore të pas shuarjes së zjarrit. Përdorimi i fikësve me pluhur për të shuar zjarrin mbi një kompjuter apo kuadër elektrik apo cfarëdolloj aparature tjeter elektrike mund të shkaktojë dëme të pariprueshme të pajisjes elektrike. Këto bombula me pluhur janë aplikuar në ambientet teknike në kapacitete 6 kg dhe 50 kg karrelato për përdorim portativ, të pozicionuara sipas projektit.



### 7.12 Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave

Kanalet e ventilimit dhe të kondicionimit, grilat dhe materiali i kanaleve të ajrit, tubat hidraulik, kanalinat elektrike të cilat përshkojnë muret horizontalisht nga njëri ambient në tjetrin, ose përshkojnë soletat apo dyshemetë vertikalish ngjëri kat në tjetrin duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mbrojtjes kundra zjarrit. Per kete qellim nëpërmjet masave të mos përhapjes së zjarrit dhe tymrave, kontrollin dhe evakuimit të këtyre të fundit, janë vendosur dampera kundra zjarrit, dampera tymi, qafore vetshuaresh, jastek vetshuaresh, stuko dhe materiale të tjera vetë shuarëse të cilat janë përcaktuar saktësisht në projektet e impianteve përkatëse.

### 7.13 Sinjalistika

Një element shumë i rëndësishëm është shoqërimi i të gjitha pajisjeve shuarëse, rrugëve të kalimit e të shpëtimit, me sinjalistikat përkatëse sipas normave me ndriçim normal dhe me ndriçim emergjencë. Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit janë parashikuar një numer tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si :

- Tabela paralajmëruese - janë tabelat që tregojnë ndalimin e ndezjes së zjarreve, ndalimit të përdorimit të ujit për shuarje etj.
- **Tabela treguese** - sic janë drejtimet e daljes nëpër korridore, nëpër shkalle, vendosja e hidranteve dhe të bombolave etj.
- **Tabelat vepruese-sinjalizimi** nëpërmjet butonit të alarmit, ndërprerja e energjisë elektrike etj.



## 8 SISTEMI I MONITORIMIT TE KAMERAVE, RJ45

### 8.1 Gjendja Aktuale

Ne ambjentet e godines sistemi i monitorimit me kamera mungon. Duke qene se do te riorganizohen hapesirat e ambjenteve egzistuese, infrastruktura e re e rrjetit te internetit duhet te jete e pershtatshme konform ketyre ndryshimeve.

### 8.2 Pershtatja e Ambjentit

Per nje rritje te cilesise se sherbimeve eshte kerkuar te implementohet rrjeti kompjuterik sipas funksionit te percaktuar te ambienteve.

Gjithashtu eshte parashikuar vendosja e sistemit te monitorimit te kamerave ne te gjithe ambjentet qe shihet e nevojshme.

### 8.3 Sistemi TV

Ne kete sistem eshte parashikuar qe te kete TV ne cdo dhome shtrimi si dhe tek hollet dhe recepsioni. Sistemi TV do te jete vetem UHF me nje antene qendrore ne tarrace dhe me amplifikator qendror qe do te jete ne dhomen teknike. Shprendarja do te kryhet me ane te shperndaresave kalimtar dhe fundor me 4,6,8 dalje ku daljet qe nuk do te perdoren do te mbyllen me rezistenca fundore. Kablli I perdonur per sinjalin TV duhet te jete kabell koaksial 75ohm.

### 8.4 Sistemi CCTV

Sistemi CCTV do te kete funksion monitorimin dhe ruajtjen e pamjeve filmike per arsy sigurie. Sistemi CCTV do te jete IP me kamera IP POE (Power Over Ethernet) te vendosura ne pikat e konsideruara te nevojshme te monitorohen si korridore, hyrje godine, hyrje ne ambjente kati, recepcion, holl etj. Gjithmone pa cenuar privatesine e personelit, nxenesve, ose personave te tjere. Ne keto ambjente duhen vendosur tabela paralajmeruese qe i behet e ditur qe keto ambjente survejohen me kamera.

Per te gjithe objektin do te vendoset nje NVR qe do te jete ne Rack ne katin 0 ku do te mblidhen te gjithe kabllot qe do te lidhen ne nje switch me 24 porta PoE 10/100 si dhe me 2 porta Uplink. Ne perzgjdhjen e switchit duhet pasur kujdes qe fuqia e portave individuale



te mbaj cdo kamer si dhe ne fuqi totale. Duhet pasur kujdes gjate instalimit qe linjat te mos i kalojne 100m sepse ka problem me PoE si dhe me transmetimin e te dhenave. Me NVR do te lidhet nje monitor qe ti ofroj mundesine personelit te autorizuar te menaxhoj dhe te kontrolloj kamerat ne cdo moment qe do i nevojite. Ne NVR do te instalohen harddisqe HDD per te ruajtur regjistrimet qe do te realizojne keto kamera.

Jane parashikuar per tu perdorur dy tipe kameresh ku per ambjentet e brendshme do te jene kamera Dome per tu instaluar ne tavanin e varur ndersa per ne ambjentet e jashtme kamera Bullet te cilet do te vendosen ne fasaden e objektit ne lartesi per te monitoruar ambjentet hyrese ne objekt. Kamerat duhet te jene me minimumi 5Mpx me lente varifocale nga 2.4 - 12 mm, me regjistrim deri ne 25fps si dhe me infrared IR per te regjistruar naten ose kur ne ambjente eshte erresire.

#### Minimumi I kerkesave te NVR

- Furnizimi 100-240Vac
- Montimi rackmounted per tu montuar ne Rack
- Regjistrimi deri ne 12MP
- Kompresimi I regjistrimit H265+
- Mundesi lidhje deri 4 SATA konektor per HDD deri ne 8TB
- Kontroll regjistrimi smart me filtra sipas eventeve
- Dalje Video : 2 porta HDMI, VGA
- Dalje Audio : RCA
- Temperaturë pune : -10°C deri ne +55°C
- Kontakte te pastra si hyrje ose si dalje te konfigurueshem
- Mundesi lidhje me tastiere dhe maus per komandimin e saj
- Port USB per eksportimin e regjistrimeve ne rast evenetes

#### Minimumi I kerkesave per te dy tipet e kamerave:

- Furnizimi : PoE
- Lente: 2.8 - 12mm
- Rezelucion : 720, 1080, HD, Full HD
- Tipi I Lentes : varifocale
- Te kene : IR LED deri ne 30m
- Regjistrimi ne ndricim te ulet : 0.03lux me ngjyra
- Detektim levizje dhe alarmi



- Temperature pune : -20°C deri ne +60°C
- Kompresimin e videos : H265, H265+, MJPEG
- Numri I fps : deri ne 25fps
- Te jene : OnVif
- Te supertoje : microSD
- Shkalla mbrojtjes : IP66, IK10
- Certifikimi CE

*PERGATIUR NGA:*

**BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k &  
"F&M INGEGNERIA" S.p.A & "MAU" sh.p.k**